

**KOÇO DANAJ**

**Totalitarizmi, demokracia dhe  
marrëdhëniet ndërkombëtare**

Marrë nga ueb faqja  
[www.lajme.net](http://www.lajme.net)

**Botuar më 1996**

***Nuk jam anti asgjëje, jam vetëm profrancez dhe ajo që i dëshiroj Francës është e drejta e saj për të kontestuar. Po qe se nuk kontestoj, unë nuk jam aleat, por protektorat.  
De Gol, pjesë nga biseda e zhvilluar me presidentin amerikan Nikson në Francë në vitin 1968.***

## Hyrje

Periudha pas viteve '90-të, veçanërisht për Evropën, përbën një periudhë cilësisht të re. Qysh nga viti 1917, kur në Rusi triumfoi revolucioni socialist e deri në vitin 1989, kur socializmi u shpërbë dhe u përmbys, Evropa ka qenë arenë e luftës midis dy sistemeve të kundërta. Veçanërisht pas krijimit të kampit socialist pas Luftës së Dytë Botërore, kjo ndeshje mori përmasa të gjera dhe të shumanshme. Për rrjedhim, edhe marrëdhëniet ndërkombëtare të kësaj periudhe në mënyrë të natyrshme do të pasqyronin këtë ndeshje gjigantësh, siç ishin dy kampet. Rrjedhojë e kontradiktave të ashpra midis dy sistemeve ka qenë dhe lindja e zgjidhja e konflikteve të ndryshme në gjirin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Veçojmë këtu konfliktin amerikano-vietnamez dhe atë sovjet-afgan. Këto konflikte gjithmonë janë zgjidhur më anë të dhunës. Për 50 vjet bota jetoi me frikën e luftës bërthamore. Kriza kubane e çoi botën buzë greminës së kasaphanes përgjithshme. Në krye të dy kampeve qëndronin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik. Veçori e periudhës së kontradiktave midis tyre është fakti se ata për 50 vjet nuk u ndeshën asnjëherë ballë për ballë, por gjithmonë në periferi. Ishin vendet e vogla ato që u bënë fusha eksperimentimi dhe ndeshjesh midis tyre. Vietnami, Afganistani, Angola, Kili, Iraku, Libani, Palestina etj. janë disa nga fushëbetejat ku të mëdhenjtë provuan për 50 vjet forcën dhe armët e tyre.

Përmbysja e socializmit dhe përpjekjet për krijimin e një tipi të ri marrëdhëniesh kanë ngjallur dhe vazhdojnë akoma të ngjallin tek miliona njerëz dhe popuj shpresa të mëdha për krijimin e një bote të re pa konflikte, mosmarrëveshje, ku të sundojë harmonia dhe konsensusi i përgjithshëm. Këto shpresa kanë qënë dhe janë të mëdha veçanërisht tek popujt dhe shtetet e vegjël dhe të pazhvilluar. Krahas kësaj, periudha e viteve 1990-1995 është ndeshur dhe me ngjarje e dukuri në marrëdhëniet ndërkombëtare, që janë shoqëruar

me zhgënjime tek miliona njerëz. Ka qenë dhe është propaganda ajo që deri tani e ka minimizuar domethënien dhe thelbin e këtyre ngjarjeve. Esenca e kësaj propagande, këto ngjarje, i ka paraqitur si pasoja të luftës së ftohtë, si mbeturina të të menduarit komunist, si kalimtare etj.

Mbi këtë bazë, qëllimi i këtij libri është një përpjekje modeste, për të sqaruar se:

Çfarë është frika e shteteve dhe popujve, vetëm pasojë e luftës së ftohtë apo bashkudhëtare e përhershme e marrëdhënieve ndërkombëtare? Çfarë është totalitarizmi, tipar i shteteve ish-socialiste apo një bashkudhëtar i përhershëm i marrëdhënieve ndërkombëtare? A ekziston pavarësia reale e popujve të vegjël apo ajo, njësoj si në të kaluarën, edhe sot ndëshkohet, nga të mëdhenjtë? A mund të ketë shanse krijimi i rendit të ri botëror apo ai nuk është gjë tjetër veçse një diksion kolosal i propagandës? Marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare po shkojnë përpara apo ndodhemi në një fazë kur ato kanë bërë një pakthetu të madhe etj.

## **A ka totalitarizëm në marrëdhëniet ndërkombëtare?**

Politologë, mendimtarë dhe analistë të shquar perëndimorë si Aron, Fonten, Lëfor, Fejto, Sartori, Arend, Brzezinski etj. e kanë analizuar gjerësisht konceptin e totalitarizmit. Ata i kanë trajtuar imtësisht lidhjet e përbashkëta dhe ndryshimet midis autoritarizmit, diktaturës dhe totalitarizmit. Në këtë analizë secili prej autorëve ka individualitetin dhe veçoritë e tij. Megjithatë, në përkufitimet që kanë dhënë, të gjithë bashkohen në një pikë: totalitarizmi nuk është gjë tjetër veçse dhunimi i lirisë së individit apo se totalitarizmi ndërtohet mbi rrënimin e të drejtave të njeriut. Thelbi i totalitarizmit është frika për të nesërmen, ndërsa tipari i tij themelor është teoria e NJESHIT.

Këto definicione, që kanë ardhur si rezultat i studimeve të gjera dhe të gjithanshme veçanërisht të zhvillimeve në vendet ish-socialiste,

me përparësi Bashkimin Sovjetik, natyrisht që përbëjnë një meritë të padiskutueshme të këtyre autorëve. Por, pa mohuar, kontributin e tyre të shumanshëm në këtë analizë, është e rëndësishme të evidentojmë se tek të gjithë këta autorë, vihen re dy mangësi shumë të rëndësishme. Këto mangësi, pavarësisht nga dëshira e autorëve të mësipërm apo e adhuruesve të tyre të shumtë në botë, në analizë të fundit, e komprometojnë objektivitetin e konkluzioneve apo pohimeve të tyre.

Cilat janë këto mangësi, si janë shfaqur dhe cili është shkaku i tyre? Cila është sfera e veprimit të totalitarizmit, në epokën e luftës së ftohtë dhe sot?

Së pari: së gjithë këta mendimtarë totalitarizmin, autoritarizmin, diktaturën, e kanë trajtuar gjerësisht si problem i të izoluar brenda një shteti apo brenda një grupi shtetesh, veçanërisht brenda shteteve socialiste. Sipas tyre, totalitarizmi, është fenomen që vepron vetëm brenda suazave të një shteti të tillë. Ai nuk haset në tipe të tjera shtetesh, por vetëm në shtetet socialiste, pra, ai, në analizë të fundit, nuk është gjë tjetër veçse pjellë e ideologjisë komuniste. Këtë mangësi e gjejmë të reflektuar në një mënyrë ose në një tjetër tek të gjithë; megjithatë, një pjesë prej tyre janë më të hapur. Kështu, për shembull, Sartori në mënyrë fare të hapur fashizmin italian dhe shtetin fashist nuk e konsideron aspak totalitar, megjithëse e pranon se ishte Musolini ai që e shpiku shprehjen "shtet totalitar". Ja pohimi i tij për këtë çështje: "Fjala "totalitarizëm" doli për herë të parë në vitin 1925 dhe, njësoj si autoritarizmi, është shpikur nga fashizmi. Për Musolinin, shprehja "shtet totalitar" tingëllonte si diçka e rëndësishme, që bën përshtypje. Etiketa "shtet totalitar" ishte mikluese për mendjemadhësinë dhe një mbështetje retorikën e tij. Megjithatë, këto shprehje për të ishin kryesisht retorikë. Në Itali fashizmi ishte një rast i qartë diktature autoritare, mjaft më shumë se një diktaturë e thjeshtë, por mjaft më pak se një shtet totalitar". (Sartori, Edhe njëherë për teorinë e demokracisë, vëllimi i parë faqe 206).

Ja dhe argumentet e Sartorit:

Argumenti i parë: "Asnjë italian që e ka përjetuar fashizmin nuk ka shkruar ndonjë libër shkencor që e konsideron seriozisht fashizmin si totalitarizëm" (Sartori, po aty faqe 206).

Argumenti i dytë: "Në fakt Musolini e mbylli konfliktin me Vatikanin (duke i dhënë kishës katolike një të drejtë ndërhyrjeje në punët e brendshme të Italisë, që regjimi liberal-demokratik e kishte konsideruar të papranueshme), ruajti monarkinë dhe kurrë nuk u përpoq seriozisht të infiltronte në ushtri (oficerët e karrierës të së cilës u qëndruan besnikë gjatë gjithë kohës së regjimit fashist simboleve të monarkisë). Në qoftë se një gjendje e tillë quhet totalitare, atëhere nuk ka kuptim të përdoret ky nocion" (Sartori, Mbi teorinë e Demokracisë, pjesa e parë, faqe 223).

Të tjerë kanë bërë përpjekje ta zgjerojnë veprimtarinë e shfaqjes dhe ndikimit të totalitarizmit. Një nga mendimtarët më të shquar të këtij shekulli, Klod Lëfor, pohon me të drejtë se "përkundër një mendimi të përhapur, totalitarizmi nuk del nga një ndryshim i mënyrës së prodhimit. Kjo mund të dëshmohet dhe me rastin e fashizmit gjerman apo italian që u gjend rehat me mbajtjen e një strukture kapitaliste, pavarësisht nga ndryshimet që mund të ketë pësuar ajo me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi" (Lëfor, Demokracia dhe totalitarizmi, faqe 32). Por vetëm kaq. Gjithë shtjellimi i mëtejshëm i tij, analiza që u bën ai dukurive të totalitarizmit, merr për bazë vetëm përvojën e ish-shteteve socialiste. Janë me qindra vepra të shkruara nga dhjetëra mendimtarë perëndimorë që sinonim të totalitarizmit dhe të shtetit totalitar kanë marrë vetëm socializmin. Megjithatë, në momente të caktuara, mendimtari dhe shkencëtari e ndjen subjektivitetin e analizës së tij, prandaj bën përpjekje të ngushëllojë dhe të qetësojë ndërgjegjen e tij shkencore. Sartori përpiqet ta justifikojë këtë mangësi duke pohuar se nazizmi dhe fashizmi nuk janë më, kanë ngordhur, ndërsa, komunizmi është akoma gjallë. Ja pohimi i tij për këtë çështje:

"Me daljen në skenë të brezave të rinj, dalëngadalë fashizmi së

bashku me nazizmin u bë rasti numër dy( kjo ishte e kuptueshme, të dy kishin ngordhur) dhe komunizmi (që përkundrazi ishte gjallë e shëndoshë) u bë përherë e më shumë rasti për të cilin debatohej, rasti që e bënte totalitarizmin objekt të debatueshëm" (Sartori, Mbi teorinë e demokracisë, pjesa e parë, faqe 206). Mbulesa, siç mund të shihet, është një cipë e hollë. Në këtë thënie të Sartorit më shumë kemi të bëjmë me justifikim se sa me analizë dhe argumente shkencorë. Kushdo që e njeh sadopak historinë e re dhe të sotme të Evropës, Amerikës, Azisë apo Afrikës, e di fare mirë se frankizmi apo salzarizmi në Evropë, shtetet totalitare në Azi dhe Amerikë Latinë, nuk kanë qenë komuniste, por kapitaliste. Totalitarizmi i këtyre vendeve, shkaqet që e kanë pjellë dhe mbajtur gjallë atë, nuk kanë tërhequr vëmendjen e mendimtarëve të shumtë në botën perëndimore. Klasat politike të shteteve që u përkasin mendimtarët e mësipërm, frankizmin, salzarizmin apo regjimet e tjera totalitare i kanë patur miq dhe aleatë. Prandaj, e shumta, rastet e tyre janë përdorur vetëm si emra apo mjete krahasimi me ish-shtetet socialiste, për të nxjerrë më në pah shkallën e lartë të totalitarizmit në këto vende.

Megjithëse Sartori bën një definicion shumë të rëndësishëm dhe të saktë kur flet për ndryshimin midis totalitarizmit dhe diktaturës, vëmendja e tij më e madhe i kushtohet totalitarizmit në vendet socialiste. Ja mendimi i tij në këtë çështje të madhe: "Vërtet një "diktator i thjeshtë" mund të veprojë më keq, me veprime më mizore, vrasje, tortura e akte të dhunës policore dhe karakteristika të ngjashme çnjerëzore, sesa një diktaturë totalitare" (Sartori, Edhe një herë mbi teorinë e demokracisë, pjesa e parë, faqe 214). Për shembull, diktatura ushtarake e Augusto Pinoçetit në Kili, në bazë të të dhënave dhe dëshmimeve të vetë analistëve perëndimorë, ka qenë shumë herë më mizore dhe gjakatare se në çdo shtet ish-socialist. Qindra e mijëra të vrarët dhe të zhdukurit nga ana e kësaj diktature, që kanë shërbyer si subjekte për dhjetëra romane, filma dhe emisione televizive ngjethëse, siç ka qenë për shembull filmi "Në Santiago bie

shi", "Shtëpia e shpirtrave" etj., nuk e kanë tërhequr vëmendjen e shumicës së mendimtarëve dhe politologëve perëndimorë. Sepse, sipas tyre, ajo ka qenë thjesht një diktaturë, ndërsa totalitarizmi është më i rrezikshëm.

Duket qartë se në botëkuptimin dhe veprat e tyre, më e rëndësishme ka qenë lufta midis socializmit dhe kapitalizmit sesa objektiviteti i analizës, dukuritë dhe fenomenet që lindin gjatë zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi dhe që nuk janë prurje ekskluzive e këtij apo atij sistemi. Nga shqyrtimet e mia bëjnë përjashtim vetëm Hannah Arendt dhe Zigmund Freud. Ata në veprat e tyre i kanë kushtuar trajtim të veçantë këtij problemi edhe brenda shteteve kapitaliste. I tillë ka qenë trajtimi që i kanë bërë natyrës dhe funksionimit të sistemeve fashiste dhe naziste. Me rëndësi për shtjellimin e mëtejshëm të problemit është definicioni që ka dhënë Hannah Arendt, për burimet e totalitarizmit. Ja pohimi i saj: "Filistini, i cili tërhiqet në jetën e vet private, i cili i kushtohet vetëm familjes së vet dhe përparimit të saj, i tillë ishte prodhimi i fundit tashmë i bastarduar i besimit borgjez në epërsinë e interesit privat... Njeriu i masës, të cilin e organizoi Himleri, për ta shtyrë të bëjë krime masive më të tmerrshmet në historinë e njerëzimit, u përngjante më shumë filistinëve sesa njeriut të turmës popullore. Ai s'ishte tjetër veç borgjezi, i cili, në rrënojat e botës së vet, brengosej para së gjithash për sigurinë e vet personale, që ishte i gatshëm të flijojë gjithçka: besimin, nderin, dinjitetin, para provokimit më të vogël" (Cituar sipas Lëfor, Demokracia dhe totalitarizmi, faqe 174). Për më tepër, Arendt, në veprat e saj, si burim të totalitarizmit, shikonte mënyrën e jetesës perëndimore.

Së dyti: Në këto trajtesa dhe analiza përcaktimet mbi totalitarizmin, autoritarizmin dhe diktaturën janë të shumta. Ato prekin të gjitha aspektet dhe elementet e jetës shoqërore dhe politike brenda shteteve socialiste. Shumë prej tyre kanë analizuar dhe dhënë përngjasimet dhe dallimet midis totalitarizmit, autoritarizmit dhe diktaturës etj. Por, kur lexon veprat e këtyre mendimtarëve mbi këtë çështje të



madhe të organizimit të shoqërisë, nuk mund të mos vësh re një veçori që të bën të ndalesh. Analiza e këtyre mendimtarëve për totalitarizmin dhe autoritarizmin është e cunguar, nuk është e plotë. Përse është e tillë? Kësaj analize i mungon, thënë figurativisht, gati gjysma e realitetit shoqëror dhe politik. Kjo mungesë është shfaqur si dje, në veprat e hartuara në kuadrin, atmosferën dhe psikologjinë e luftës së ftohtë, ashtu dhe sot, kur socializmi është përmbysur dhe po flitet shumë për teorinë e demokracisë dhe realitetin e saj evropian e botëror.

Cila është kjo mangësi kaq e rëndësishme, që është e barabartë me gati gjysmën e realitetit shoqëror dhe politik të botës së djeshme dhe të botës së sotme? E thjeshtëzuar, mangësia e analizës së këtyre mendimtarëve mund të përmbliidhet dhe të formulohet në pyetjet: Cila ka qënë dhe cila është sfera e manifestimit të totalitarizmit dhe autoritarizmit?

Totalitarizmi ka ekzistuar vetëm brënda një shteti, apo ai ka ekzistuar dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare?

Sot a ekziston totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kush janë bartësit e këtij totalitarizmi sot dhe cilat janë shkaqet e tij?

Totalitarizmi është pjellë e ideologjisë komuniste apo ka rrënjë më të thella?

A mund të eliminohet totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare apo ai ka ekzistuar dhe do të vazhdojë të ekzistojë sa kohë do të ekzistojnë marrëdhëniet ndërshtetërore?

Këto pyetje janë reale. Ato, si dje në epokën e luftës së ftohtë, ashtu dhe sot, pavarësisht nga ndryshimet e sipërfaqshme, kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë në realitetin evropian dhe botëror.

Megjithatë, për fat të keq, nuk gjejnë përgjigje të plotë dhe të argumentuar në veprat e mendimtarëve të shumtë me stimë botërore, që kanë pasur si objekt të tyre totalitarizmin dhe demokracinë. Ku qëndron thelbi i këtyre pyetjeve, të cilave u janë shmangur dhe vazhdojnë t'u shmangen shumë mendimtarë dhe analistë të shquar? E dyta, cilat kanë qënë dhe janë arsyet e kësaj shmangieje?

Rendet ekonomiko-shoqërorë venë e vinë, ato kanë zëvendësuar njeri-tjetrin, janë përsosur apo kanë degjeneruar, por në çdo rast marrëdhëniet ndërshtetërore kanë ekzistuar dhe ekzistojnë, ato janë shumëkohëshe. Këto marrëdhënie ndërshtetërore ekzistojnë dhe zhvillohen në kohën e sotme, midis shteteve të zhvilluara dhe të fuqishme, midis shteteve të zhvilluara dhe shteteve të pazhvilluara, midis shteteve të mëdhenj dhe shteteve të vegjël, midis shteteve të një kontinenti dhe shteteve të kontinenteve të tjera, midis shteteve kapitaliste të Evropës dhe shteteve ish-socialiste të Evropës Qendrore dhe Lindore që duan të ndërtojnë kapitalizmin etj. Fusha e këtyre marrëdhënieve ndërshtetërore është e larmishme, si dikur, në historinë e mesme, të re, ashtu dhe sot, në historinë bashkëkohore. Brenda saj janë marrëdhëniet e kورتezisë, marrëdhëniet kulturore e sportive, marrëdhëniet tregtare, marrëdhëniet politike e ushtarake, janë organizmat e shumtë dhe të panumërt ndërkombëtarë, të cilët, pas viteve '80-të e deri në kohën e sotme janë shtuar e po shtohen. Këto marrëdhënie, sa të zakonshme janë në kushte normale, aq peshë dhe intensitet marrin në kohë ndryshimesh globale. Kështu ka ndodhur pas Luftës së Parë Botërore, e cila pati si fund final të saj Lidhjen e Kombeve. Kështu ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur për herë të parë në kampin e aleatëve u ndodhën shtete me rende të ndryshme ekonomiko-shoqërorë etj. Kështu ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore, kur marrëdhëniet ndërkombëtare, pavarësisht nga mbulesat, në thelb kishin luftën midis dy blloqeve politike, ekonomike dhe ushtarake. Kështu ndodhi dhe po ndodh dhe pas viteve '90-të, kur ish-shtetet socialiste u rreshtuan në kampin e kapitalizmit. Kjo periudhë është karakterizuar dhe vazhdon të karakterizohet nga propaganda si një periudhë cilësisht e re, e panjohur më parë.

Mbas dështimit të socializmit u fol shumë dhe vazhdon akoma të flitet për një lloj të ri marrëdhëniesh ndërkombëtare. Si kudo dhe në këtë fushë predikohen me të madhe standardet demokratike në marrëdhëniet midis shteteve. Megjithatë, i parë në praktikën

konkrete dhe i zhveshur nga frazeologjia dhe stërhollimet gazetareske dhe televizive, natyra e këtyre marrëdhënieve ka ndryshuar shumë pak. Për më tepër, ky ndryshim nuk ka prekur thelbin, por vetëm fasadën e tyre. Le t'i konkretizojmë më tej pyetjet e shtruar më lart me shembuj nga përvoja e djeshme dhe e sotme e marrëdhënieve ndërkombëtare, midis shteteve apo grup-shteteve të ndryshme të Evropës dhe botës. Në vitin 1960, Shqipëria, për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë e saj, u shkëput nga kampi i atëhershëm socialist. Bashkimi Sovjetik, në shenjë hakmarrjeje, në fillim i preu ndihmat në grupë, për ta detyruar të nënshtrohej. Ndërsa më vonë kaloi në prerjen e marrëdhënieve diplomatike. Në vitin 1968, Çekosllovakia, përsëri për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë e saj, deshi të shkëputej nga kampi socialist. Por forcat e Traktatit të Varshavës më në krye sovjetikët ndërhyjnë me ushtritë e tyre dhe e pushtuan, duke dhunuar kështu të drejtën e një populli për të jetuar si të dojë vetë, duke ia imponuar mënyrën e organizimit shtetëror. Askush nga analistët perëndimorë nuk i konsideroi këto dy raste si dukuri të totalitarizmit.

Në vitin 1973, në Kili, me anë të zgjedhjeve, erdhën në fuqi forcat demokraike të kryesuar nga Salvador Aljende. Ishte populli kilian ai që zgjodhi vetë në mënyrë të lirë klasën e tij udhëheqëse. Por, pak kohë pas kësaj, Amerika, me anën e gjeneralit kilian Augusto Pinoçeti, me një dhunë dhe terror të egër, arriti ta përmbysë qeverinë e Aljendes, duke dhunuar lirinë e një populli të tërë. Dhe askush këtë nuk e konsideroi një veprim totalitarizmi. Për më tepër, deri në vitin 1995 Pinoçeti ishte akoma ministër i luftës.

Në vitin 1975 në Helsinki u mbledh ajo që u quajt Konferenca e Sigurimit Evropian. Në këtë konferencë, ku violina të para ishin Amerika dhe Bashkimi Sovjetik, u morën shumë vendime. Midis të tjerash kjo konferencë sanksionoi de facto ndarjen e Evropës në dy sfera influence, ashtu siç ishte vendosur nga Konferenca e Jaltës e shkurtit 1945. Njëkohësisht po de facto kjo konferencë pranoi si të ligjshme teorinë shoviniste të Leonid Brezhnjevrit mbi sovranitetin e

kufizuar në gjirin e shteteve socialiste. Shtatë vjet para kësaj konference, në mes të Evropës dhe fare hapur, u pushtua Çekosllovakia. Konferenca, me vendimet që mori, nuk bëri gjë tjetër veçse ligjëroi këtë pushtim. Këtë e kanë pohuar dhe shumë analistë perëndimorë. Ja pohimi i njerit prej tyre.

"Marrëveshja e Helsinkit ishte jashtëzakonisht e favorshme për rusët, sepse më në fund ne ligjëruam pushtimin stalinist të gjysmës së Evropës. Ne pranuan jo vetëm këtë, por dhe një paragraf tjetër, se nuk do të ndërhynim në ngjarjet që mund të ndodhnin në kampin rus. Ne u hapëm rusëve dritën jeshile për të bërë ç'të donin në atë zonë" (Jean Noel Lipkowski, cituar sipas Bota që vinte nga të ftohtit, faqe 218).

Ka dhe shume ngjarje, konflikte dhe mosmarrëveshje të tjera, por dhe kaq mjaftojnë për të shtruar pyetjen: A ishin akte totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare këto ngjarje, apo ishin akte demokratike? Aspirata e një populli për liri kombëtare dhe vetëvendosje është një aspiratë demokratike apo totalitare?

Literatura e shumtë, perëndimore dhe lindore, i ka trajtuar këto ngjarje kryesisht nga prizmi i kronikës. Ndërsa analistët e shumë vendeve ish-socialiste, duke bërë objekt ngjarjet që lidhen me ish-Bashkimin Sovjetik, u kanë dhënë dhe u japin këtyre ngjarjeve vetëm ngjyrë idologjike, duke i paraqitur si pjellë e komunizmit. Pavarësisht se çfarë mund të thuhet sot nga disa sociologë konformistë, veçanërisht nga shtetet ish-socialiste, ka dëshmi që vërtetojnë se këto kanë qenë akte totalitarizmi, qoftë kur janë kryer nga ish-kampi socialist me Bashkimin Sovjetik, qoftë kur janë kryer nga kampi kapitalist me Amerikën në krye.

Politikanë perëndimore dhe lindorë si rregull i kanë justifikuar këto qëndrime, në emër të asaj që quhej real-politikë, ose politika e ruajtjes së ekuilibrit të botës. Një nga politikanët më të mëdhenj të gjysmës së dytë të këtij shekulli, Henri Kizinger, e pohon fare lakuriq këtë të vërtetë, në takimin me ministrin e jashtëm çekosllovak Jiri Haček, pak kohë para pushtimit të Çekosllovakisë.

Haçeku, në takimin me Kizingerin, kërkoi mbështetjen euro-amerikane për shkëputjen nga Bashkimi Sovjetik. Ja përgjigjja e Kizingerit: "Sigurisht, ajo që po bëni ju është e mirë, por, nëse hyni në konflikt me miqtë tuaj sovjetikë, më vjen keq t'ju them se askush në Perëndim nuk do t'ju ndihmonte, pasi kjo ka të bëjë me ekuilibrin e forcave".

Pas Konferencës së Helsinkit, Bashkimi Sovjetik sulmoi dhe pushtoi Afganistanin, Amerika sulmoi dhe pushtoi Panamanë dhe Grenadën. Justifikimet që u dhanë nga këto dy shtete që ishin superfuqi botërore, kishin të bënin me gjoja ruajtjen e interesave të tyre strategjikë. Domethënë, për hir të interesave të një shteti që është i madh dhe i fuqishëm shtypet dhe dhunohet liria kombëtare e një shteti tjetër të vogël. Përsëri natyrshëm shtrohet pyetja: A ishin këto veprime marrëdhënie totalitare apo marrëdhënie demokratike? Dikush mund të ngrihet e të thotë, duke i justifikuar këto ngjarje, se atëherë ashtu ishte koha. Por le ta pranojmë për një çast këtë arsyetim. Në atë periudhe bota ishte e ndarë në dy blloqe, ekzistonin dy sisteme që ishin në luftë me njeri-tjetrin, prandaj po i quajmë veprime të tilla si të justifikuar. Le të kalojmë në periudhën e pas viteve '90-të, kur fillon një epokë e re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Socializmi është përmbysur në Bashkimin Sovjetik dhe në shtetet e tjera të Evropës. A kemi brenda kësaj periudhe në marrëdhëniet ndërkombëtare ngjarje të tilla që të kenë në themel totalitarizmin? Fatkeqësisht po. Pesë vjetët që kanë kaluar mjaftojnë për të parë se totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare vazhdon të ekzistojë akoma. Sartori pohon se dhunimi i lirisë është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me frikën, e cila është refleksi më i qartë i totalitarizmit dhe marrëdhënieve totalitare. Por as Sartori, as Brzezinski, Lëfori apo ndonjë tjetër, nuk kanë thënë se konkluzionet e tyre për totalitarizmin kanë vlerë vetëm kur flitet për individin e veçantë, për frikën dhe lirinë e tij. Në të kundërtën, ata të gjithë janë dakord se këto definicione janë të vlefshme dhe kur për objekt analize merret një popull apo një etni e caktuar.

Le të analizojmë fillimisht shembullin e Bosnjës dhe të popullit të saj. Masakra dhe tragjedia e popullit boshnjak është shumë e njohur. Natyrshëm shtrohet pyetja: A nuk ishte dhe a nuk është shembulli i Bosnjës një shembull tipik totalitarizmi në marrëdhënit ndërkombëtare? Për vite të tëra boshnjakët jetuan me frikë në zemër duke pritur se kur do të merren vesh fuqitë e mëdha, kur do të shkëputen ato nga zonat e influencës për t'i dhënë fund tragjedisë së tyre. Pra, një popull i tërë për pesë vjet u masakrua në mënyrën më barbare dhe priti të merreshin vesh Amerika, Rusia, Franca, Anglia, Gjermania, se cila do të ishte masa e lirisë së tij.

Pas shpërbërjes së Traktatit të Varshavës, shumë qeveri të vendeve ish-socialiste, në doktrinën e tyre mbrojtëse kanë deklaruar dhe vazhdojnë të deklarojnë me të madhe se asnjë shtet fqinj apo i largët prej tyre nuk konsiderohet armik. Në mënyrë më të plotë këtë e ka shprehur klasa politike e Shqipërisë dhe e Çekisë. Megjithatë, në mënyrë ironike dhe paradoksale, gati të gjitha këto shtete kanë bërë kërkesë të hyjnë në Paktin e Atlantikut Verior. Ajo që e shtyn klasën politike në këto vende të kërkojë mbrojtjen e një organizate ushtarake, pavarësisht se çfarë thonë politikanët të ndryshëm mbi paqen e përgjithshme, nuk është gjë tjetër veçse frika. Frika për mbrojtjen e sovranitetit, frika për ruajtjen e lirisë dhe pavarësisë së vendeve dhe shteteve të tyre.

Si po përballohet kjo frikë e tyre? Fuqitë e mëdha të Evropës dhe Amerika nuk nxitohen. Dhe këtu ka një arsye të madhe. Ato nuk duan t'i acarojnë marrëdhëniet me Rusinë. Me gjithë shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, me gjithë vështirësitë e mëdha të periudhës së ndërtimit të kapitalizmit, Rusia, veçanërisht në fushën ushtarake, përbën akoma një superfuqi të fuqishme. Është kjo arsyeja që për fuqitë e mëdha të Perëndimit marrëdhënie miqësore dhe korrekte me Rusinë janë shumë herë më të rëndësishme sesa lutjet e shumë shteteve të vogla ish-socialiste të Evropës Qendrore dhe Lindore. Prandaj ato gjetën një zgjidhje kompromisi. U kanë dhënë këtyre vendeve një eufemizëm që e kanë quajtur "partneriteti për paqe". E

shprehur më thjesht kjo do të thotë se në kohë paqeje këto shtete do të jenë partnerë të organizatës së Atlantikut Verior. Por është afër mendsh se frika e këtyre popujve është për kohë luftime dhe jo për kohë paqeje. Lidhur me këtë çështje, Fejto konstaton me të drejtë se "ishte një zhgënjim i madh për qeveritë postkomuniste të Evropës Qendrore, që shpresonin të kishin përparësi në përkujdesjen perëndimore dhe që dy vjet më vonë, pas përmbysjes së 1989-ës, konstatuan me dhimbje që marrëdhëniet me BRSS ose me atë që mbetej prej tij vazhdonin të ishin prioritare në përpunimin e politikave perëndimore" (Fejto, Fundi i demokracive popullore, faqe 428). Prandaj frika për lirinë kombëtare vazhdon të qendrojë varur si shpata e Damokleut mbi këto vende. Atëhere, a nuk është ky veprim një shembull totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare?

Në opinionin evropian është aq e njohur çështja kurde. Një popull prej 24 milionë vetësh jo vetëm që nuk ka shtetin e tij, pra, nuk është i lirë ta krijojë këtë shtet, por, duke qenë i copëtuar në katër shtete, i është nënshtruar dhe vazhdon t'i nënshtrohet një gjenocidi të egër. Ky gjenocid ka ekzistuar në periudhën e luftës së ftohtë dhe vazhdon të ekzistojë dhe sot, kur lufta e ftohtë ka përfunduar. Përballë kërkesës së një populli që kërkon lirinë e tij, veshi i bashkësisë ndërkombëtare është i shurdhët. Interpretimet dhe spekulimet me anën e ngjyrës që populli kurd kërkon lirinë e tij janë bajate. Lufta për liri kombëtare nuk ka ngjyrë politike, ajo nuk është as e kuqe, as e gjelbër, as e verdhë. Është thjesht liri. Të gjitha fuqitë perëndimore, në fillim të vitit 1995, në mënyrë të heshtur i dhanë të drejtë Turqisë ta shtypë rezistencën kurde duke dhunuar madje dhe kufijtë e një shteti sovran, siç është Iraku. Shumë politikanë: francezë, anglezë, gjermanë etj. e justifikuan këtë me pohimin se paskëshin marrë garanci nga Turqia që operacioni nuk do të zgjaste shumë dhe, për më tepër, nuk do të prekej popullsia e pafajshme. Ndërsa sekretari amerikan i shtetit Uoren Kristofer e bëri më të qartë këtë qëndrim duke pohuar se interesat strategjike të Amerikës e justifikojnë këtë përkrahje ndaj Turqisë. Kjo, në emër të moralit të politikës, na jep të

drejtën për të pyetur: justifikimi dhe përkrahja e dhunës së ushtruar në mënyrën më të egër ndaj lirisë së një populli në emër të interesave strategjike të kësaj apo asaj fuqie të madhe çfarë është: veprim totalitar apo veprim demokratik?

Në marrëdhëniet ndërkombëtare totalitarizmi dhe autoritarizmi asnjeherë, as në të kaluarën, por as sot, nuk janë shfaqur dhe nuk shfaqen hapur. Ato si rregull janë stolitur me një propagandë që në pamjen e parë është e pëlqyeshme, për shtresa të ndryshme njerëzish apo për popuj të vendeve të ndryshme. Dje, në periudhën e luftës së ftohtë, flitej për domosdoshmërinë e dy kampeve, socialist dhe kapitalist, për të qenë në paritet. Propaganda e të këtyre kampeve çdo veprim e justifikonte në emër të forcimit dhe të ruajtjes nga armiku i ndërsjelltë. Ndërsa sot totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare fshihet pas domosdoshmërisë së ruajtjes dhe konsolidimit të demokracisë, qoftë dhe kur bëhet fjalë për lirinë kombëtare të popujve të vegjël. Nën këtë koperturë ai ekziston në thelbin e tij dhe në realitetin aktual të marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare.

Në mënyrë më të plotë, në bashkësinë evropiane, totalitarizmi dhe autoritarizmi, i fshehur pas fasadave propagandistike, është shprehur në qëndrimin e mbajtur ndaj çështjes shqiptare. Në këtë çështje sloganet "ndarje ndërkombëtare e punës, hapësirë demokratike, paqe, stabilitet rajonal", kanë mbuluar dhe vazhdojnë të mbulojnë arbitraritetin e fuqive të mëdha.

Ndryshimi i sistemit socialist në Evropë dhe shpërbërja e Jugosllavisë, "së përkëdhelurës" së Evropës dhe Amerikës, çështjen shqiptare e nxori fare hapur, me gjithë tragjikën dhe padrejtësinë ndaj saj. Kur flasim për çështjen shqiptare, më së pari duhet të jemi të qartë se nuk kemi të bëjmë me një problem të ngjashëm siç është ai i çështjeve nacionale në Rumani, Hungari, Sllovaki, Kroaci etj. Në të gjitha këto shtete shumica dërrmuese e kombit është e organizuar në një shtet, ndërsa në shtete të tjera ndodhen pakica kombëtare. Për këto vende dhe shtete, si dhe për problemet që ato kanë, ka vlerë Komisioni i Parlamentit Evropian dhe komisioneri i tij për



minoritetet, hollandezi Van der Bruk. Në rastin e çështjes shqiptare problemi është më i mprehtë. Jashtë kufijve të shtetit shqiptar qendron gjysma e kombit. Nga ana tjetër, problemi i copëtimit të kombit shqiptar nuk është i ngjashëm as me historinë e trojeve të gjermanëve të Sudeteve apo të hungarezëve e polakëve, ndaj të cilëve Konferenca e Potsdamit e vitit 1945 mori vendim të deportoheshin për shkak të pjesëmarrjes së tyre në luftë në anën e nazi-fashizmit. Në të kundërtën, populli shqiptar jashtë kufijve të shtetit shqiptar nga konferenca e Potsdamit u konsiderua si popull që kishte marrë pjesë aktive përkrah koalicionit antifashist. Pra, nuk kemi të bëjmë në rastin e kombit shqiptar as me pakicë kombëtare, as me kolaboracionizëm me fashizmin. Kemi të bëjmë thjesht me një çështje shqiptare të pazgjidhur.

Cili është qendrimi i fuqive të mëdha evropiane dhe botërore ndaj çështjes shqiptare?. Si në të kaluarën, ashtu dhe sot, qendrimi i tyre në thelb është qendrim totalitar. Ashtu siç çon në totalitarizëm dhe autoritarizëm dhunimi i së drejtës së individit për të qenë i lirë, po ashtu çon në totalitarizëm dhunimi i së drejtës së një populli për të qenë i lirë të vetëvendosë për fatin e tij. Nëqoftëse dhunimi i lirisë së individit e çon shtetin në totalitarizëm, dhunimi i lirisë së një populli nga disa shtete njëherësh i çon këto shtete në një totalitarizëm shumë herë më të madh. Popujt përbehen nga individët. Por liria e një individi apo e një bashkësie individësh nuk do të thotë liri e një populli apo e një kombi, nuk do të thotë apriori liri kombëtare. Liria kombëtare kërkon si parakusht grumbullimin në një shtet të të gjithë pjesëtarëve të një kombi apo të shumicës së tyre. Në të kundërtën, nuk ka liri kombëtare.

Në qendrimin e fuqive të mëdha ndaj çështjes shqiptare vazhdon spekulimi me termat e "interesit strategjik", si paqja apo stabiliteti rajonal për të mos vazhduar me shpikjet e fundit të viteve 1993-1994, mbi hapësirat demokratike. Mbi bazën e realitetit të sotëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, në mënyrë të natyrshme lind pyetja: Cila është arsyeja që politologjia e sotme nuk e trajton totalitarizmin

ashtu siç e ka trajtuar dhe dje?

## **Pamja ideologjike e problemit:**

Gjatë periudhës 1990-1995 janë shkruar një sërë librash, që kanë për objekt të tyre marrëdhëniet ndërkombëtare të kësaj periudhe apo krahasimet me periudhën e kaluar. Në këto libra janë vënë në dukje konfliktet dhe konfrontimet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe relacionet globale. Megjithatë, nuk mund të mos vëmë në dukje se këto libra i përshkon njëfarë "objektivizmi" ndaj ngjarjeve dhe në mjaft raste qëndrimi pasiv i autorëve, krahas përpjekjeve për nxjerrjen e konkluzioneve teorike. Interesante është se shumica e autorëve të këtyre librave vazhdojnë të vuajnë nga e njëjta sëmundje e vjetër. Kur përpiqen të analizojnë shkaqet e këtyre konflikteve, disa prej tyre i bien shkurt, i gjejnë këto shkaqe jo në analizën reale të fenomeneve, por duke i trajtuar ato si pasoja të pashmangshme të sistemit socialist. As që bëhet fjalë që të përmendet edhe totalitarizmi në gjirin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Arsyet që në veprën shkencore të shumë mendimtarëve perëndimorë apo lindorë mungon ky aspekt i trajtimit të totalitarizmit, pra, aspekti i totalitarizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare, janë të shumta dhe komplekse. Një ndër këto arsye, për të mos thënë ajo më kryesorja, del dhe duket shumë qartë. Këtë arsye me shumë të drejtë Sartori e quan ideologjizim i problemit. Por, për fat të keq, as Sartori dhe as mendimtarë të tjerë nuk janë të zhveshur nga ideologjizimi. Në veprat e tyre ky ideologjizim nuk del hapur, si rregull ai nuk përmendet. Por vetë analiza e dukurive që ata lënë jashtë veprës së tyre të çon në një konkluzion të tillë. Klod Lëfor në kritikën që u bën mendimtarëve të së majtës në Francë e jep shkarazi, pa u thelluar në analizën e tij, shkakun e kësaj dukurie. Ai thotë se "koncepti i ri (i totalitarizmit - shënimi ynë) u pa si një koncept i së djathtës i farkuar në shërbim të një qëllimi reaksionar; lufta kundër totalitarizmit u paraqit si një diversion, qëllimi i të cilit ishte që të lihej në harresë

realiteti i imperializmit perëndimor dhe që të çarmatosej kritika e sistemit kapitalist"(Lëfor, Demokracia dhe totalitarizmi, faqe 91). Kritika e Leforit është e drejtë. Por duhet thënë njëkohësisht se sot, në pozitat e djeshme të së majtës, ka rënë mendimi politik i së djathtës mbi totalitarizmin. Për problemin që po trajtojmë, mbi bazën e ballafaqimit të nocioneve dhe të praktikës së marrëdhënieve ndërkombëtare të djeshme dhe të sotme, do të mjaftohemi të themi se:

Së pari: totalitarizmi nuk lidhet vetëm me natyrën e sistemit ekonomik-shoqëror, ai nuk është një bashkëngjitje ekskluzive e sistemit socialist dhe vetëm e tij (edhe sistemi kapitalist në faza të ndryshme të zhvillimit të tij ka prodhuar totalitarizëm).

Së dyti: totalitarizmi nuk ekziston vetëm në marrëdhëniet brenda një shteti; ai ekziston dhe shfaqet dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Aktualisht ai sot përbën një ndër tiparet kryesore të këtyre marrëdhënieve. Thelbin e totalitarizmit në marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare mund ta vërejmë më konkretisht në luftën që bëhet nga njëra anë midis fuqive të mëdha për të ruajtur status-quo-në e krijuar dhe në përpjekje e mjaft popujve dhe shteteve të vegjël për të relizuar të drejtat e tyre demokratike, që kërkojnë në mënyrë të natyrshme prishjen e kësaj gjendjeje.

Tashmë i kemi përmendur disa shembuj për të vërtetuar ekzistencën e totalitarizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare aktuale. Por ende nuk është aspekti më i rëndësishëm i problemit. Ai prek drejtpërdrejt thelbin e rendit të ri botëror që predikohet sot me të madhe. Për të me të drejtë Gabriel Partos thotë se "rendi i ri botëror çdo ditë e më shumë ka filluar t'i ngjajë çrregullimit të dikurshëm të botës" (Partos, Bota që erdhi nga të ftohtit, faqe 285). Prandaj çështja kërkon një analizë më të thellë dhe më të gjerë. Le të përpiqemi ta bëjmë atë, duke u mbështetur në përgjithësimin dhe analizën e atyre dukurive që ekzistojnë sot në botë dhe që janë burim i mbajtjes gjallë të dukurive të totalitarizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Vitet 1990-1995 edhe për mendimtarët dhe analistët perëndimorë

kanë qënë vitet e dehjes së përgjithshme. Përmbysja aq e papritur dhe aq paqësore e Bashkimit Sovjetik dhe e regjimit të vendeve të tjera socialiste i ka hapur rrugën jehonës marramendëse të krijimit të mbretërisë së demokracisë në gjithë botën. Totalitarizmi vdiq, rroftë demokracia - kjo është boshti i propagandës dhe shkrimeve të viteve 1990-1995. Dehja ishte e përgjithshme. Por, kur njeriu është i dehur, ai është i disponuar t'i shmanget arsytimit normal dhe për këtë shkak gjykon gabim ose në mënyrë spontane. Kështu po ndodh dhe me politologë dhe analistë të shumtë perëndimorë. Ndërsa e vërteta është ndryshe. Me ndryshimin e sistemit në Evropën Lindore u përmbys socializmi, por nuk u eliminuan totalitarizmi dhe marrëdhëniet totalitare apo autoritare. Periudha e deritanishme e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare jep shumë shembuj, shenja apo të dhëna që flasin se zhdukja e marrëdhënieve totalitare dhe autoritare është larg për t'u menduar. Veç shembujve të mësipërm, një analizë e hollësishme e mosmarrëveshjeve, konflikteve apo kundërshtive në gjirin e marrëdhënieve ndërkombëtare, në mënyrë të natyrshme të çon evidentimin e disa dukurive:

## **Marrëdhëniet midis vendeve ish-socialiste dhe vendeve të Evropës Perëndimore e Amerikës**

Periudha e dashurisë dhe përdëllimit të vendeve perëndimore ndaj popujve dhe vendeve ish-socialiste zgjati shumë pak. Tani ekzistojnë e ka zëvendësuar ftohtësia, llogaria, interesi i ndërsjellët, dhe më tej ironia, përbuzja dhe injorimi. Fejto e ka nuhatur një gjë të tillë, prandaj konstaton me të drejtë se "mahnitja e opinionit publik perëndimor përpara "revolucionit të kadifenjtë", mund të krahasohet me euforinë evropiane të viteve 1789: u përshëndetën Leh Valesa dhe Vaclav Haveli si Shën Gjergjë modernë që triumfuan mbi

"dragoin" komunist. Por shumë shpejt po ata që qanin nga gëzimi në vjeshtë të vitit 1989, nisën të ironizonin disa muaj më vonë "elektricitin e vogël të Gdanskut" ose "mbretin filozof" të Pragës, duke i treguar si të paaftë të kryenin funksionet e tyre të shefit të shtetit" (Fejto, Fundi i demokracive popullore, faqe 399).

Në vendet perëndimore qarkullojnë lloj-lloj librash dhe transmetohen gjithfarë emisionesh televizive, të cilat, në vend që ta pasqyrojnë me vërtetësi realitetin e vendeve ish-socialiste, fyejnë dhe nënçmojnë traditat dhe kulturën e tyre. Nga ana tjetër, vendin e "çeqeve të bardha", me të cilat u joshën masat në këto vende, e kanë zënë llogaritë e ftohta të zotëve të parave dhe çeqeve, apo e kanë zëvendësuar ndihmat humanitare dhe bamirëse. Në marrëdhëniet ndërshtetërore nuk mund të mos vihet re një dukuri që ka të bëjë me pozitën nënshtruese që u imponohet vendeve ish-socialiste. Ata po pranohen në atë që quhet "shtëpi evropiane" dhe botërore, po jo atje ku duan apo ku e kanë vendin realisht, po atje ku u thonë. Ndarja dhe rregulli që u predikohej këtyre vendeve nga Bashkimi Sovjetik në mënyrë komuniste ekziston akoma, veçse me një emër të ri: si ndarje demokratike.

Thelbi i problemit nuk ka ndryshuar, ka ndryshuar vetëm kostumi me të cilin është veshur ai. Me miliona qytetarë të këtyre vendeve, aktualisht me banim të përkohshëm në Evropën Perëndimore, e ndeshin përditë këtë qëndrim përbuzës. Realiteti i mësipërm nuk shfaqet hapur, por ai ekziston. Në vendet ish-socialiste këtë realitet e mban akoma të ndrydhur klasa politike që është në këto vende, e cila u formua me ndihmën e Perëndimit, si dhe niveli i prapambetur ekonomik që ekziston atje. Por këto janë pengesa që nuk do të vazhdojnë gjatë. Klasa politike e këtyre vendeve një ditë do dalë nga skena, ndërsa niveli ekonomik do të ngrihet. Në këto vende së afërmi do të dalë në skenën politike një klasë nacionaliste e fortë dhe agresive. Gjendja reale e pozitës së sotme të këtyre vendeve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të tyre do të përcaktojnë dhe rrugën e ardhjes në pushtet të klasës së re politike. Ajo do të vijë në pushtet

duke u mbështetur pikërisht mbi kozmopolitizmin dhe pozitën lypsare të klasës së sotme politike, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, duke u mbështetur mbi moralin e sotëm politik fyes dhe përbuzës, që është i bollshëm në literaturën, media-t dhe marrëdhëniet ndërkombëtare perëndimore.

## **Krijimi dhe përhapja e partive nacionaliste në vendet e Evropës**

Vitet pas përmbyesjes së socializmit si sistem botëror nuk kanë pasur rrjedhime të rëndësishme politike dhe sociale njësoj në të gjitha shtetet e Evropës. Në disa vende të Evropës Lindore dhe Qendrore përmbyesja e socializmit u shoqërua me lindjen e një nacionalizmi të egër, i cili, në vend që ta stabilizonte situatën e brendshme dhe të ndikonte për mirë në marrëdhëniet me vende të tjera, në të kundërtën, e ka acaruar atë më tej. Me të drejtë për këtë situatë G. Soros në një parashtrësë të tij thotë se sistemi politik në këto vende "ka për tendencë të zbërthehet në sisteme të veçanta, të mbyllura dhe të mbështetura në një ide tjetër, pikërisht në idenë e identitetit kombëtar ose etnik... Ata janë dhe më të ligj se komunistët e vjetër, të cilët në të vërtetë nuk besonin në dogmën e tyre".

Rrjedhim i këtij nacionalizmi janë mosmarrëveshjet dhe konfliktet shpesh të mbërritur deri në kufijtë e përgjakjes, që i kanë shoqëruar deri tani marrëdhëniet politike ndërshtetërore. Nacionalizmi rus, njësoj si ai serb, kroat apo sllovak, jo vetëm që nuk arriti ta stabilizojë situatën pas përmbyesjes së socializmit, por, në të kundërtën, e ka acaruar më keq atë. Rënia ekonomike e këtyre vendeve është një ndër faktorët kryesorë që ky nacionalizëm nuk është shfaqur me tërë forcën e tij. Ky element i rëndësishëm i situatës politike të disa prej vendeve ish-socialiste nuk është i rrezikshëm vetëm për marrëdhëniet ndërkombëtare të rajonit.

Potencialisht agresiviteti i tij është më i egër. Ai ka pasur ndikime edhe në vendet e Evropës Perëndimore. Situatat politike dhe sociale në këto vende janë shoqëruar me zhvillime të rëndësishme sociale dhe politike të papritura. Këto zhvillime janë pasqyrim i ecurisë normale të këtyre vendeve drejt përmirësimit dhe konsolidimit të rendit që ato kanë zgjedhur, i harmonizimit të interesave të shtetit dhe interesave të popullit. Por njëkohësisht këto zhvillime në mjaft raste janë diktuar nga ndryshimi i hartës së botës, veçanërisht të Evropës.

Deri në vitet 1989 ekzistenca e sistemit socialist problemet politike të këtyre vendeve konvergjonin në një pikë: të mbrohemi nga armiku i kuq. Mbi këtë bazë jeta sociale dhe politike, evolucioni i saj, gjithmonë e mbante parasysh rrezikun e komunizmit. Në përgjithësi këtij konvokimi i nënshtroheshin të gjithë. Në mjaft raste ky rrezik mbulonte dhe probleme të tjera, që ishin pasojë e dukurive të brendshme të shteteve kapitalistë. Por ndodhi ajo që nuk pritej. Me një shpejtësi marramendëse, armiku u eliminua. Jo me mjete dhune, siç parashihej, por shumë më thjesht: ai u konvertua në sistem kapitalist, u rreshtua në mënyrë fare paqësore në kampin e armiqve të tij të djeshëm. Evropa pas kësaj u ndodh në një situatë të re, të panjohur më parë. Kontinenti plak, që kishte shpërthyer dy luftëra botërore, me një vetëdije të mbushur me armiq të shumtë; Evropa që në funksion të përballimit të tyre kishte ndërtuar një industri nga më të fuqishmet ushtarake, politike dhe propagandistike, në mënyrë të beftë e pa veten e të rrethuar vetëm me miq. Ndodhi ajo që kishte parashikuar në vitin 1986 një nga këshilltarët kryesorë të Gorbaçovit, i cili pohoi në atë kohë se "ne do të bëjmë atë që nuk e ka bërë kush, do ta privojmë Perëndimin nga ekzistenca e armikut: do të bëhemi si ata".

Kjo situatë e re është ai faktor shtesë, për të mos thënë faktori kryesor, që ka filluar të ndikojë me forcë e në mënyrë të hapur në evolucionin e sotëm (ndoshta dhe të ardhshëm) social dhe politik të Perëndimit. Këto zhvillime të lejojnë të përafrohesh në disa

konkluzione mbi perspektivën e vetë ecurisë së mëtejshme të marrëdhënieve ndërkombëtare. Le të analizojmë disa prej tyre. Në mjaft vende të Evropës Perëndimore dështimi i socializmit ka filluar të shoqërohet me lindjen dhe fuqizimin e partive të ekstremit të djathtë, ose siç quhen ndryshe, të partive nacionaliste. Këto parti emrat natyrisht i kanë bashkëkohorë dhe në përputhje me legjislacionin e botës moderne. Por thelbi i tyre mbetet ai i traditës. Disa të dhëna të pjesshme janë të mjaftueshme për të treguar rritjen e këtij krahu në politikë. Në Francë partia e ekstremit të djathtë e Lë Penit, Fronti Nacional, ka arritur një sërë suksesesh dhe është bërë partia e tretë, me 15 për qind të votave. Në Austri Partia e Jozef Hajderit, që është parti e ekstremit të djathtë, në zgjedhjet e fundit arriti të marrë rreth 26 për qind të votave. Në Itali Partia e Finit Aleanca Nazionale, trashëgimtare nominale e partisë së Musolinit, është një nga forcat kryesore politike. Në Gjermani partitë e ekstremit të djathtë akoma janë të dobëta dhe të pafuqishme në jetën politike, si rezultat i stabilitetit ekonomik dhe politikës së zgjuar që ndiqet nga formacionet kryesore të vendit. Por, me gjithë seriozitetin politik të emërtesës aktuale, grupimet politike në Gjermani përsëri janë të shqetësuara nga prirjet e zhvillimit të ekstremit të djathtë. Tregues interesant për këtë ishte shqetësimi që lindi në skenën politike gjermane gjatë zgjedhjeve të vitit 1993 në landin e Esenit, ku partia republikane, që është parti e ekstremit të djathtë, arriti të marrë rreth 12 për qind të votave në zgjedhje. Të shqetësuara nga kjo, qoftë partia kristian-demokrate e Kolit, qoftë ajo Social-demokrate e Lafontenit, apo dhe Partia Liberale, diskutuan me alarm mbi ecurinë e mëtejshme të zhvillimeve politike. Duke ditur se në Gjermani qeveritë gjithmonë janë krijuar nga koalicioni midis njërës prej partive të mëdha me partinë e vogël liberale, si dhe duke ditur se partia liberale e Kinkelit është duke e humbur elektoratin, me të drejtë ekzistonte frika se mos këtë rol në të ardhmen mund ta luajë partia republikane. Aktualisht asnjëra prej këtyre partive nuk është në pushtet,



megjithatë, ato po vijnë gjithmonë duke u fuqizuar. Ekziston, sigurisht dhe kundër-arsyetimi se zhvillimet e Evropës apo Amerikës do ta frenojnë ekspansionin e këtyre partive, se Bashkimi Evropian do t'i hapë vend kozmopolitizmit, përkundër nacionalizmit. Megjithëse logjik, ky kundër-arsyetim siç duket nuk do t'i qendrojë kohës. Janë disa arsye që paralajmërojnë një prirje të kundërt. Së pari: ka dekada të tëra që në Evropën Perëndimore dhe Amerikë është predikuar kozmopolitizmi. Veçanërisht pas lëvizjeve të fuqishme të vitit 1968, që tronditën sistemet politike të vendeve perëndimore, kozmopolitizmi mori një përhapje të gjerë. Ai u bë kodi i mënyrës së (bashkë)jetesës së shtresave dhe racave shumëburimëshe njerëzore. Plotësimi i kënaqësive personale, liria individuale dhe qarkullimi i lirë në çdo kënd të botës, ky ishte kodi moral dhe qytetar i miliona dhe miliona njerëzve në Evropën Perëndimore. Depolitizimi dhe neveria ndaj nocioneve të tilla, si atdhe, nacionalizëm, pavarësi, përbënin kodin politik të njeriut kozmopolit dhe kozmopolitizmit si rrymë mendimi e mënyrë jetese. Faktori psikologjik që njeriu gjithmonë është i prirur ndaj asaj që nuk e ka, në mënyrë të natyrshme kozmopolitizmin e bëri filozofi sunduese. Por qysh nga vitet 1968 kanë kaluar afër tre dekada. Kategori të tëra njerëzish tani janë velur me një mënyrë të tillë jetese. Aktualisht në rend të ditës në shtete të ndryshme të Evropës po dalin ndjenjat nacionale dhe janë pikërisht këto shtesa që jo vetëm i mbajnë gjallë, por dhe i propagandojnë ato. Përsëri kemi të bëjmë me ndjenjën psikologjike të njeriut që kërkon atë që i mungon. Ky është një fenomen dhe dukuri objektive. Ideologjitë, për vetë karakterin universal dhe mbinacional, në momente të caktuara i lëshojnë vendin njëra-tjetrës, duke u tërhequr për t'u rinovuar dhe për të dalë pas disa kohësh në skenën politike më fasadë dhe kostum të ri. Ky fenomen ka ndodhur dhe ndodh me të gjitha ideologjitë. Për shembull, shumë parti të së djathtës sot në Evropë kanë emra joshës dhe pretendues, si parti popullore, parti demokratike etj. Po kështu, shumë parti ish-komuniste janë

ripagëzuar si parti socialiste, socialdemokrate, nacionaliste etj., duke qenë krejt në përshtatje me moralin politik bashkëkohës. Por të gjithë e kuptojnë se emrat nuk thonë gjithçka. Ato më së pari janë modë. Moda ndryshon sipas kohës dhe vendit, por moda nuk e shpreh thelbin e problemit.

Së dyti: në këto vende, edhe më parë, por më shumë pas dështimit të socializmit, ka një vërshim të madh të emigrantëve nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të cilët duan të sigurojnë mjete jetese. Në shumicën e tyre këta njerëz i ka çuar në Perëndim përpjekja për të siguruar jetesën. Shkrimtari i madh gjerman Stafan Haim pohon me të drejtë se situata politike dhe ekonomike do të detyrojë miliona të largohen nga shtëpitë e tyre. Do të ketë një marshim të paparë dhe askush nuk do të jetë në gjëndje t'i përmbajë në kufij. Edhe sikur të ndërtohet një mur tjetër, duke qenë të pakontrolluar ata do ta kapërcejnë. Kjo tashmë është një realitet. Kjo dukuri ka të paktën dy rrjedhime që shkojnë në favor të partive nacionaliste. Kjo masë njerëzish është e kënaqur dhe me pak të ardhura. Ajo gjithmonë krahasimin e bën me vendin nga ka ardhur. Prandaj dhe padronët janë më të interesuar të marrin në punë prej kësaj mase njerëzish që kënaqen me pak, sesa vendësit që kërkojnë mbi bazën e standartit real. Ky fenomen në mënyrë të natyrshme po i ftoh dhe do t'i ftohë akoma më shumë lidhjet e punonjësve të vendeve të fuqishme kapitaliste me këtë masë njerëzish të ardhur nga Lindja.

Rrjedhimi i dytë ka të bëjë me problemet që ka krijuar dhe vazhdojnë të krijohen në disa vende nga migracionet. Duke qenë në përgjithësi të pakontrolluar, mjaft prej tyre kanë krijuar probleme të mprehta në metropole, duke i dhënë shkas urrejtjes ndaj tyre dhe duke krijuar terren të përshtatshëm për fuqizimin e partive të ekstremit të djathtë, të cilat dalin si flamurtare të mbrojtjes së vlerave kombëtare, të pastërtisë së racës etj.

Së treti: në epokën e luftës së ftohtë pakënaqësitë që lindnin në shtesa të ndryshme njerëzish qeveritë e vendeve të Evropës

Perëndimore arrinin t'i shuanin duke përdorur me mjaft efikasitet "gogolin komunist". Qindra e qindra libra dhe emisione televizive që e paraqisnin komunizmin si gogol, në një masë të madhe bënë efektin e tyre tek masa e gjerë e këtyre vendeve. Përballë "të këqijave të tmerrshme" të komunizmit ato detyroheshin të praninin ç'u jepnin qeveritë e tyre edhe kur nuk ishin dakord me to. Por tani "ky gogol" nuk ekziston më. Pakënaqësitë vazhdojnë të ekzistojnë, ato duket se do të shtohen më shumë. Greva e zhvilluar në Francë në nëntor-dhjetor 1995 është një dëshmi e pakënaqësisë. Punëtorët dhe manifestuesit e Alzas-Lorenës, midis parullave të tyre, kishin dhe thirrjen: "Chirak, la prochain bombe nucleaire, c'est nous" (Shirak, bomba e ardhshme bërthamore jemi ne).

Në mungesë të rrezikut komunist do të duhet shpikur një rrezik tjetër për të neutralizuar këto pakënaqësi. Pra, ose do të duhet që qeveritë e këtyre vendeve të shkojnë më shumë nga e djathta, duke përvetësuar pjesë të programit të partive të këtij ekstremi, ose do të duhet të kalojnë në koalicione me këto parti për të zbutur pakënaqësitë e masave. Në çdo rast dhe sido që të ndodhë, kjo do të sjellë për pasojë acarimin dhe ftohjen e marrëdhënieve midis qeverive dhe popullit, si dhe do t'i japë më shumë hov e fuqizimit të nacionalizmit. Ngjarjet e zhvilluara në Francë në nëntor-dhjetor 1995 e treguan këtë prirje. Qeveria konservatore e Zhypesë, me miratimin e presidentit Shirak, aporvoi atë që u quajt "paketa e reformave Zhype". Në thelbin e saj kjo reformë synonte që të shkurtonte buxhetin aktual social të francezëve në funksion të perspektivës së zhvillimit dhe forcimit të Francës. Pakënaqësia e punonjësve francezë u shpreh me grevat e fuqishme që zgjatën 25 ditë. Megjithatë, qeveria nuk e tërhoqi planin e saj. Siç u shpreh Zhype në asamblenë franceze, arsyeja kryesore ishte se ky plan synonte të ruante dhe të forconte dhe më shumë pavarësinë dhe sovranitetin e Francës. Dhe për hir të kësaj ishte e nevojshme të bëheshin përkohësisht dhe sakrifica. Në këtë çështje, të gjitha partitë e së djathtës dhe të ekstremit të djathtë patën mendim të përbashkët. Ato të gjitha e mbështetën planin Zhype dhe qeverinë e

tij.

E njëjta dukuri mund të ndodhë dhe me partitë e krahut të majtë, të qendrës së majtë dhe të ekstremit të majtë. Përçarjet dhe marrëdhëniet e ftohta që ekzistojnë sot midis tyre, përballë konsolidimit dhe aleancave të së djathtës me ekstremin e djathtë, do t'i çojnë këto parti drejt kërkimit të rrugëve për sheshimin e mosmarrëveshjeve midis tyre. Ishte shumë sinjifikative për këtë platforma e përpunuar nga udhëheqja e partisë social-demokrate gjermane, pas ndërrimit të kreut të saj. Udhëheqësi i ri i kësaj partie Oskar Lafonten disa ditë pas zgjedhjes së tij hodhi idenë e veprimit për një koalicion të mundshëm me ish-partinë komuniste të Gjermanisë Lindore, të quajtur më vonë partia e socializmit demokratik. Nëqoftëse vitet 1995-1996 këto dukuri i kanë të kufizuara, në të ardhmen ato në mënyrë graduale do të zotërojnë skenën politike të vendeve evropiane dhe për pasojë skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Janë pikërisht këto fenomene dhe dukuri që në të ardhmen do ta ftohin dhe ashpërojnë dhe më shumë jetën sociale dhe politike të këtyre vendeve.

Së katërti: në disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore përmbysja e socializmit u përmbyll me veçori specifike në spektrin politik të tyre. Në disa vende erdhi në pushtet një klasë politike kozmopolite dhe lypsare. Ndërsa në disa të tjerë erdhi në pushtet një klasë politike nacionaliste. Kështu ndodhi në Sllovaki, në Serbi, Kroaci, Ukrainë etj. Këto parti me vështirësi u binden rregullave dhe lojës së marrëdhënieve të reja ndërkombëtare. Ato, qysh tani, megjithëse janë akoma prapa nivelit ekonomik të vendeve të Unionit Evropian, nuk duan ta pranojnë pozitën nënshtruese, duke u përpjekur që me aq sa munden të ndjekin një politikë vetëm në favor të vendeve të tyre.

**Ekzistenca e sferave dhe zonave të influencës; ndikimi i tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare.**

Periudha pas përmbysjes së socializmit në marrëdhëniet ndërkombëtare në pamje të parë ka krijuar idenë e krijimit të disa raporteve të reja, të panjohura në të kaluarën. Kështu, po u jepet përparësi organizmave ndërkombëtarë, qoftë në nivelin evropian, qoftë në nivelin botëror. Organizma të tillë, si Organizata e Kombeve të Bashkuara, Unioni Evropian, Këshilli i Evropës, Organizata e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian etj., në propagandën e sotme paraqiten si pararendëset e krijimit të strukturave të reja të ardhshme komunitare evropiane dhe botërore. Tani po flitet për triumfin e federalizmit dhe për epërsinë e bashkëjetesës së rajoneve shumëkombëshe. Që ka në këtë prirje një evolucion me kahje pozitive në krahasim me të kaluarën, kjo është e vërtetë. Por e vërteta, veçanërisht kur është e pjesshme, nuk mund ta mbulojë dot gjithë realitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Me gjithë dukuritë pozitive sot në realitetin e këtyre marrëdhënieve, vazhdon të ekzistojë akoma teoria e zonave të influencës. Kjo teori ka qenë e vjetër. Ajo mori përhapje të gjerë dhe konkrete në Luftën e Parë Botërore dhe veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore. Le ta konkretizojmë problemin.

Një nga armët më të fuqishme të propagandës së Perëndimit kundër socializmit ishte fakti i pakundërshtueshëm se Bashkim Sovjetik, nën maskën e internacionalizmit proletar, ishte shnëdrruar në një perandori që dhunonte lirinë dhe pavarësinë e popujve të ndryshëm të Lindjes. Në mënyrë të natyrshme shumë popuj të këtyre vendeve shembjen e socializmin duke e konsideruar këtë akt më shumë si mjet dhe mundësi për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Por a ndodhi vërtet kështu? T'u referohemi fakteve. Sot në Evropë realisht nuk kemi eliminim të sferave të zonave të influencës, siç propagandohet, por një rirregullim të raporteve të interesave midis fuqive të mëdha. E veçanta ka të bëjë me faktin që nëse në të kaluarën zonat e influencës realizoheshin me luftë midis fuqive të

mëdha, në kohën e sotme ato po realizohen në rrugë paqësore. Në rastin e konfliktit të armatosur, fuqitë e mëdha rrinë në rolin e arbitrit, ndonëse luftën e bëjnë me shtytjen e tyre shtetet që ato kanë nën influencë.

Ballkani i viteve 1990-1995 është prova e qartë e vërtetësisë së këtij konkluzioni. Por le të vijojmë më tej. Jugosllavia, sa kohë që ishte shtet federativ, më tepër se nën influencën e njërit apo tjetrit grupim, ishte e përkëdhelura e Perëndimit. Shpërbërja e saj dhe lindja e shteteve të rinj nxori në skenë, veç të tjerash, teorinë e zonave të influencës. Ishte në fillim Gjermania që përkrahu dhe mbrojti pavarësinë e Sllovenisë dhe Kroacisë. Marka gjermane, në vend të ushtrive perandorake, e ripushtoi këtë zonë të vjetër influence të bllokut austro-gjerman. Franca, Rusia dhe Anglia mbrojtën dhe përkrahën federatën serbo-malazeze, pikërisht zonën e vjetër të influencës së këtyre shteteve. Ndërsa një shtet i ri që u krijua, Maqedonia, u fut që në fillim nën influencën amerikane. Sesa i vërtetë është ky fakt, këtë e tregon më së miri lufta që u zhvillua në Bosnjë e Hercegovinë. Për tre vjet rresht, Rusia, Franca dhe Anglia, në formë të hapur apo të fshehur, mbrojtën dhe justifikuan qëndrimin e Serbisë. Blloku austro-gjerman mbrojti dhe përkrahu interesat e Kroacisë. Ndërsa në rolin e arbitrit qëndruan Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilave u duhej të krijonin hapësirën e tyre të ndikimit politik, por dhe të arrinin pajtimin e interesave të aleatëve të tyre, për t'i dhënë një zgjidhje masakrës së Bosnjës, e cila, me përmasat e saj tragjike, rrezikoi shumë rëndë predikimet e tyre për klimën e re të marrëdhënieve ndërkombëtare pas përmbyesjes së sociaaizmit. Një provë tjetër në favor të këtij përfundimi është përkrahja e sulmit kroat për rifitimin e Krajinës. Jehona e ofensivës kroate në shtypin dhe televizionin gjerman e austriak ishte e pakrahasueshme me jehonën që iu bë kësaj ngjarjeje nga shtypi dhe televizioni i Francës, Anglisë dhe Rusisë.

Ekzistencën e zonave të influencës dhe të rirregullimit të këtyre zonave mund ta shikojmë qartë po të studiojmë realitetin e

marrëdhëniet ndërkombëtare në Evropën Lindore dhe Qendrore. Në këto vende, deri dhe nën influencën sovjetike, sot shihet një ndërthurje tjetër interesash. Në këtë rirregullim siç duket më të fituar do të jenë gjermanët. Disa nga vendet e Evropës Qendrore në të kaluarën kanë qenë pjesë e perandorisë së Habsburgëve, si, për shembull, Çekia, Sllovakia, Hungaria etj. Austria sot nuk e luan dot rolin e fuqisë së madhe. Këtë rol ka filluar ta luajë shumë mirë Gjermania. Rikthimi i ekuacioneve të dikurshme gjeopolitike po ndodh dhe me shtetet baltike: Lituanië, Letonië, Estoninë.

## **Ekzistenca e NATO-s, shpresë për paqe apo mjet totalitarizmi?**

Në literaturën e sotme ka filluar të propagandohet shumë roli i NATO-s. Ajo po paraqitet si mbrojtëse e lirisë dhe sovranitetit të popujve të Evropës. Meqenëse të gjithë janë dakord dhe pohojnë se rreziku më i madh, ose, siç e quante Regani, "perandoria e së keqes", pra, komunizmi u zhduk, askush nuk mundet të japë një shpjegim pse duhet ky garant. Shumë prej vendeve ish-socialiste po bëjnë lutje pas lutjesh dhe lëshime pas lëshimesh që të hyjnë në këtë organizëm. Madje kjo organizatë ushtarake po trajtohet si mbrojtëse e demokracisë, qoftë dhe me dhunë. Pra, ajo po merr në propagandë rolin e pëllumbit të paqes me anë të raketave.

A është NATO shpresë për paqe apo mjet totalitarizmi? Njerëzit tashme e dinë mirë qëllimin e krijimit të NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Ato u krijuan për të mbrojtur me forcën e armëve sistemet ekonomike e politike që u përkisnin. Pra, që të dy traktatet u krijuan si institucione dhune. Me dështimin e socializmit Traktatit i Varshavës u shpërbë. Të gjitha shtetet ish-socialiste duan të futen tani në Paktin e Atlantikut Verior. Kjo dëshirë kaq e madhe për t'u futur në një

ombrellë për t'u mbrojtur tregon se ato kanë frikë. Është e natyrshme, kur njeriu ka frikë, kërkon mjete dhe rrugë për t'u mbrojtur. Kjo vlen dhe për shtetet. Por, nga ana tjetër, shtrohet problemi se nga kush kanë frikë, pasi tani nuk ekziston më sistemi socialist, si dhe pyetjen tjetër, nëse vërtet pandehin klasat politike të vendeve të vogla që fuqitë e mëdha të Evropës Perëndimore do të prishin marrëdhëniet me Rusinë apo qoftë dhe me Kinën për hir të tyre. Këtë nuk e besojnë as ata që e propagandojnë. Rusia, nga e cila kanë frikë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, aktualisht është edhe vetë një vend kapitalist. Mund të thuhet se, me gjithë përmbysjen dhe likuidimin e sistemit socialist (për shumë vende pjesëtare të këtij sistemi ekzistonte realisht frika nga hegjemonizmi sovjetik), ndryshimi në marrëdhëniet ndërkombëtare është fare i vogël. Sistemi u likuidua, por frika mbeti. Pra, nuk është më në fuqi socializmi, por ekziston akoma totalitarizmi.

Le të vazhdojmë arsyetimin me një krahasim tjetër: NATO dhe KSBE-ja: cili është roli i njërës dhe cili i tjetrës. Vetëm po të krahasojmë këto dy organizma me njeri-tjetrin, mund ta bëjmë më të qartë problemin dhe thelbin e tij. NATO, dihet nga të gjithë se është institucion që mbështetet mbi detyrimin e bindjes me çdo mjet, duke përfshirë dhe atë të forcës dhe dhunës. KSBE-ja nga ana tjetër është një institucion demokratik, që mbështetet mbi detyrimin për t'u bindur me anë të konsensusit, marrëveshjes, dialogut demokratik. Propaganda që i është bërë dhe vazhdon t'i bëhet KSBE-së ka qenë marramendëse. Kjo propagandë zë fill qysh nga Konferenca e Helsinkit e vitit 1974.

Veçanërisht pas përmbysjes së socializmit ajo është konsideruar si shtëpia e përbashkët evropiane, në të cilën mbretëron dhe duhet të mbretërojë harmonia dhe demokracia e kulluar. Shumë shtete ish-socialiste hyrjen në të e kanë konsideruar dhe vazhdojnë ta konsiderojnë si një fitore të madhe të demokracisë. Megjithatë janë të paktë ata që në realitet, kanë besim të rrinë nën hijen e kësaj çatie. Ajo është aq e dobët, saqë nuk mund të mbrojë njeri. Për shtetet që kanë probleme të mprehta apo që janë të vogla dhe të pazhvilluara, çatia e kësaj shtëpie është një iluzion mbulimi. Të qëndrosh nën këtë çati për



t'u mbrojtur nga rreziqet do të thotë, në mënyrë figurative, të pranosh të të zërë dhe breshri, dhe shiu e bora.

Rasti më flagrant i këtij cedimi të KSBE-së nga roli i vet është çështja boshnjake. Kur bie fjala për këtë çështje në prapaskenë të gjithë politikanët dhe analistët seriozë e pranojnë se kjo organizatë demokratike ka dështuar. Ajo është vetëm për kortezi, vetëm për vajtje e ardhje politikanësh dhe shtetarësh, për të thënë se janë marrëdhëniet demokratike ato që përbëjnë thelbin e marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare. Por praktikisht ajo ende është krejtësisht e paaftë të zgjidhë konflikte të mprehta. KSBE-ja kishte vëzhguesit e saj në Kosovë. Këta vëzhgues një ditë të bukur Serbia i ktheu mbrapsht. Ndërsa KSBE-ja nuk ishte në gjendje ta detyronte Serbinë t'i pranonte vëzhguesit e saj. Le të përmendim një rast, që është më flagrant. Samiti i KSBE-së në dhjetor të vitit 1994 u mbledh për të diskutuar dhe vendosur lidhur me ngjarjet në Bosnjë. Rezultati përfundimtar qe një dështim i plotë. Vetëm mosmarrëveshje, disa prej tyre shumë të egra. Nuk u arrit të aprovohej qoftë dhe formalisht një rezolutë. Të paktën OKB-ja është më ndryshe, ajo ua ka marrë dorën rezolutave. Pra, samiti dështoi, por nuk dështoi vetëm një samit. Shumë më tepër, dështoi dhe u diskreditua një organizëm që quhet demokratik, në një kohë historike që quhet demokratike

Pse ka dështuar KSBE-ja në misionin e saj si krijuese e moralit të bashkëjetesës, të njeriut të lirë të botës, të "shën Njeriut", siç thuhet? Cila është arsyeja, përse kërkohet që rolin që ka një institucion demokratik ta luajë një institucion ushtarak, përse kërkohet në një kohë demokratike mburoja e institucioneve militare, që mga vetë funksioni i tyre janë organizma të dhunës? Lordi Kerrington, që ka qenë për disa kohë sekretar i përgjithshëm i NATO-s, e jep shumë qartë pse-në e një dukurie të tillë. Ja pohimi i tij për këtë çështje kaq të madhe:

Të pëlqen apo jo, frika i bën njerëzit t'i hidhen njëri-tjetrit në krahë. Sapo ajo zhduket, zhduket dhe nevoja e bashkëpunimit të ngushtë. Vetëm një gjë nuk e ka thënë Kerringtoni, që frika është thelbi i

totalitarizmit. Këmbëngulja për të ruajtur dhe forcuar NATO-n ndoshta ka shkaqe më të thella sesa paraqiten. Në radhë të parë vetë anëtarët e NATO-s siç duket kanë frikë të jetojnë të ndarë nga njëri-tjetri, ata nuk i kanë besë njëri-tjetrit po të jenë veç e veç, ashtu siç nuk kanë besë dhe nga fuqitë e tjera të mëdha, si Rusia, Kina apo arabët. Prandaj domosdoshmëria e NATO-s i vë shtetet e saj anëtare para detyrimit të ndihmës ndaj njeri-tjetrit. Në radhë të dytë drejtuesit dhe krijuesit e NATO-s e kanë të qartë se bota dhe Evropa janë larg të qenit në harmoni dhe paqe. Historia atyre u ka mësuar një gjë të madhe: paqja gjithmonë ka nevojë për forcën. Bindja dhe marrëveshja ndërkombëtare kanë nevojë për frikën. Prandaj NATO-ja do të forcohet dhe përsoset akoma më shumë në të ardhmen.

## **Integralizmi musliman, totalitarizmi dhe marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare.**

Nacionalizmi nuk është një dukuri vetëm evropiane. Nuk është një dukuri që mori hov vetëm pas përmbysjes së socializmit. Në vendet ish-socialiste, që, me përjashtim të Shqipërisë, ndodheshin nën perandorinë sovjetike, ai është shfaqur kërcënueshëm në periudhën e pas viteve '90-të. Ai sot është një fenomen botëror, me uljet dhe ngritjet e tij në periudha dhe kohë të ndryshme. Uljet dhe ngritjet e tij janë të ndryshme në zona të ndryshme të globit. Sot një prej këtyre nacionalizmave më të përhapur në botë me tendencë rritjeje dhe përhapjeje të mëtejshme është nacionalizmi arab. Ky nacionalizëm në literaturën dhe propagandën e sotme evropiane dhe botërore njihet me emra shumë të përhapur, si "integralizëm islamik" apo "fondamentalizëm islamik".

Në veshjen e tij të jashtme, në parullat e tij, ky nacionalizëm në pamjen e parë të krijon përshtypjen e një lëvizjeje thjesht fetare. Në krijimin e kësaj përshtypjeje kanë ndikuar dy faktorë. Faktori i parë është vetë flamuri që kanë zgjedhur lëvizjet islamike, i cili është

identifikuar me muslimanizmin, fenë islame, zakonet dhe doket e saj. Dhe faktori i dytë është propaganda e fuqishme veçanërisht në Evropë, e cila në një masë shumë të madhe ka ndikuar që këto lëvizje të shikohen si lëvizje konfesionale. Propaganda e zhvilluar ndaj lëvizjeve islamike i ka paraqitur ato si zhvillime regresive, që kërkojnë kthimin e vendeve arabe dhjetëra dekada prapa. Njëkohësisht në opinionin e gjerë këto lëvizje paraqiten si mbulesë për veprime terroriste. Duhet thënë se në Evropë propaganda e zhvilluar ia ka arritur në përgjithësi qëllimit. Qendrimi masiv ndaj këtyre lëvizjeve përgjithësisht është negativ. Por kjo nuk i ka penguar lëvizjet islamike të përhapen gati në të gjitha vendet arabe, në formën e integralizmit musliman apo të fundamentalizmit. Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik ato kanë filluar të marrin hov edhe në republikat muslimane të ish-perandorisë sovjetike, që nuk janë të vogla as si territor, as si popullsi. Republika islamike e Iranit bën përpjekje të mëdha ta përcjellë evolucionin e këtyre vendeve sipas teorisë dhe praktikave të tij. Në përpjekje të minimizimit të influencës së Iranit, bashkësia evropiane mbështet ambicjen e Turqisë për të shtrirë influencën mbi këto vende ose pranon qeverisjen e tyre nga klasa politike të lidhura ngushtë me Rusinë, siç po ndodh në Kazakistan, Azerbaixhan, Gjeorgji etj.

Është e rëndësishme të sqarojmë se në momentin aktual të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare ka dalë problemi se çfarë i shqetëson më shumë vendet e mëdha evropiane dhe Amerikën: karakteri regresiv fetar i këtyre lëvizjeve apo nacionalizmi i tyre, tendenca e këtyre lëvizjeve për t'u shkëputur nga ndikimi i të tjerëve, tendenca për pavarësi të plotë, apo tendenca e kthimit të shoqërive civile të këtyre vendeve në shoqëri fetare? A ekziston, pra, vërtet një rrezik i kthimit të shteteve laike në shtete teokratike? Sqarimi i kësaj çështjeje do të na japë mundësi të gjykojmë më drejt mbi karakterin vërtet përparimtar të qendrimin të bashkësisë evropiane, nëse jo dhe të qëllimeve pragmatiste të saj.

Propaganda e zhvilluar deri tani të jep të kuptosh se bashkësinë

evropiane më shumë e shqetëson karakteri regresiv i ekspansionit të islamizmit dhe prandaj e ushqen opinionin me një qendrim negativ ndaj tij. Kjo propagandë ka të vërteta në çfarë thotë, por ajo nuk i shkon deri në fund problemit, dhe për këtë arsye nuk është plotësisht objektive. Një analiza më e thellë e problemit, ballafaqimi i politikës së vendeve të mëdha evropiane dhe botërore me realitetin konkret të marrëdhënieve me vendet arabe, të krijon një përfytyrim tjetër. Propagandën e bashkësisë evropiane e tërheqin kryesisht ato fakte dhe dukuri që shquajnë në gjirin e këtyre lëvizjeve për mbulesën fetare, që natyrisht në fundshekullin e 20-të tingëllon plotësisht anakronike. Ndërsa politikën e bashkësisë evropiane shumë pak e shqetëson fryma fetare nga burojnë këto lëvizje. Politika nuk bëhet as me priftërinj, as me hoxhallarë, por vetëm me interesa dhe përfitime. Më shumë se sa mbulesa fetare, politikën e bashkësisë evropiane, të Amerikës, Rusisë etj., e shqetëson karakteri nacionalist i tyre, fryma e pavarësisë që i karakterizon ato. Nafta është më e fuqishme se sheriatit dhe ligjet e tij. Në mesin e shteteve arabe janë shumë prej tyre që kanë marrëdhënie të ngushta me shtetet evropiane dhe Amerikën. Shtete të tilla janë: Egjipti, Kuvaiti, Emiratet Arabe, Arabia Saudite etj. Çfarë janë këto vende përsa i përket shkallës së emancipimit kulturor dhe shoqëror të tyre? Qoftë Arabia Saudite, qoftë Sulltanati i Omanit, qoftë Kuvaiti, nuk janë shtete tipike muslimane. Në këto vende feja islame është moral, besim, ligj, drejtësi dhe projekt diplomacie. Ligjet e shariatit janë të plotfuqishme. Islamizmi që zbatohet nga ana e klasës politike në Arabinë Saudite, për shembull, nuk ka asnjë ndryshim me programin fetar të lëvizjeve të ndryshme integraliste apo fundamentaliste muslimane. Megjithatë, kjo nuk i pengon këto vende të jenë ndër aleatët më të preferuar të fuqive të mëdha. Askush nuk i akuzon ato për tendenca islamizmi dhe fundamentalizmi islamik. Protektoratet nuk preken, në të kundërtën, ato mbrohen qoftë dhe me armë. Për më tepër kur një prej tyre, Kuvaiti, u pushtua nga Iraku, fuqitë e mëdha arritën deri atje sa e detyruan Irakun të tërhiqet me anën e forcës ushtarake.

Të njëjtin qendrim ka mbajtur deri dje dhe Bashkimi Sovjetik, që pretendonte se udhëhiqej nga një ideologji shumë e përparuar. Në botën arabe një nga miqtë e tij më të ngushtë ishte perandori i Etiopisë Haile Selasie i parë dhe Etiopia, një shtet thellësisht islamik. I tillë ishte dhe Iraku. Megjithëse qeveria irakiane në vitet '60-të bëri një masakër të egër mbi komunistët vendës, ajo përsëri ishte aleate dhe mike e Bashkimit Sovjetik.

Realiteti i djeshëm dhe i sotëm i qëndrimit të fuqive të mëdha ndaj vendeve arabe dhe qeverive të tyre e vë në pozitë shumë të vështirë propagandën që zhvillohet mbi karakterin regresiv të lëvizjeve islamike. Ai zbulon arsyen e vërtetë të qëndrimit alarmant ndaj këtyre lëvizjeve. Frika e politikës aktuale të fuqive të mëdha nuk është karakteri fetar i këtyre lëvizjeve, por karakteri nacionalist i tyre. Ligjet fetare të shariatit musliman nuk i zbaton më pak mbreti i Arabisë Saudite se presidenti i Iranit Rafsanxhani; nuk i zbaton më pak sulltani i Omanit se sa Gedafi i Libisë, nuk i zbaton më pak sheiku i Kuvaitit se sa Iraku. Meka, ku shkojnë çdo vit me qindra e mijëra njerëz për haxhillëk, nuk ndodhet as në Iran, as në Libi, por në tokën e aleatit më të ngushtë të vendeve perëndimore, në Arabinë Saudite.

Në zbatimin e fesë të gjithë të përmendurit më sipër janë njësoj. Megjithatë, disa janë aleatë dhe disa konsiderohen terroristë e fundamentalistë. Arsyja tashmë është e njohur. Të gjitha shtetet arabe që kanë marrëdhënie miqësore me fuqitë e mëdha konsiderohen të avancuar dhe të emancipuar. Të gjithë të tjerët, që nuk e pranojnë varësinë nga fuqitë e mëdha, por kërkojnë të jenë të pavarur, konsiderohen si fundamentaliste dhe terroriste. Është e qartë nga vjen kjo diferencë. Interesat nuk i prek feja, qoftë ajo muslimane, budiste apo e krishterë. Interesat i prek nacionalizmi, fryma e pavarësisë. Shumica e vendeve arabe kanë në fuqi qeveri që nuk janë dakord dhe u vene kufij lëvizjeve integraliste dhe fundamentaliste. Por fryma e re e paspërmbysjes së socializmit dhe përfitimet e saj duket se janë shfrytëzuar dhe po shfrytëzohen mirë nga lëvizjet integraliste. Shumë nga këto lëvizje po i përshtaten moralit të ri që po predikohet, frymës

demokratike, rregullave të lojës politike dhe pluralizmit. Ato në disa vende arabe po marrin pjesë në zgjedhje, duke bërë një një propagandë të madhe në popull, për të arritur të vinë në pushtet. Disa prej këtyre lëvizjeve po shfrytëzojnë me mençuri, vështirësitë që kanë qeveritë e vendeve arabe, pakënaqësinë e popullit ndaj tyre dhe pozitën e varësisë ndaj fuqive të mëdha. Aktualisht në shumë vende arabe levizjet integraliste ekzistojnë si një kombinim i luftës ilegale të armatosur me pjesëmarrjen në konkurrencen legale për pushtet, në zgjedhjet që zhvillohen.

Tipik është rasti i Turqisë, që konsiderohet aleatja më e ngushtë e fuqive perëndimore. Është i vetmi shtet musliman që është anetar i NATO-s. Në zgjedhjet e parakohshme të zhvilluara në Turqi në dhjetor 1995 forcë e parë politike në zgjedhje doli partia REFAH e Erbakanit, që është parti me thekse të dukshme fetare dhe nacionaliste. Megjithëse nuk e mori dot shumicën absolute, ajo i vuri në vështirësi të mëdha jo vetëm partitë e tjera në Turqi si partinë e Çilerit apo të Mesut Jilmazit, por dhe NATO-n, pasi Turqia është krahu jugor i saj. Lëvizjet integraliste kanë filluar të gjallërohen edhe në ish-republikat ish-sovjetike të Azisë Qendrore. Megjithëse deri tani ato nuk kanë arritur të marrin pushtetin, për shkak të epërsisë së neokomunisteve, duket se në të ardhmen do të përbëjnë një rrezik të madh potencial. Është interesant të theksohet se asnjë prej fuqive perëndimore nuk është shqetësuar dhe nuk ka treguar ndonjë rezerve për faktin që në shumicën e këtyre republikave në fuqi janë përsëri ata që kanë qenë deri dje, ish-komunistët. Kane heshtur, ndonëse realisht në disa prej tyre ligjet janë larg të qenit demokratike. Frika prej marrjes së pushtetit nga lëvizjet islamike i ka detyruar fuqitë e mëdha të mbyllin sytë para realitetit dhe të marrin si të vërtetë farsën e demokracisë që po vazhdon të luhet në këto vende.

Në mbështetje të këtyre lëvizjeve, të cilat nganjëherë marrin edhe karakter ekspansiv, është Irani, i cili, duke përfutur dhe nga afërsia gjeografike që ka me republikat jugore që dolën nga bashkësia e shteteve ish-sovjetike, po i nxit dhe përkrah këto lëvizje. Konkurrenti

më i përshtatshëm për neutralizimin e Iranit në këtë zonë është Turqia. Por ajo aktualisht ka dy probleme të brendshme. Njëri është problemi kurd, i cili nuk e lë Turqinë të hedhë shikimin përtej kufijve të saj. I dyti është vetë hovi që ka marrë lëvizja islamike në Turqi, duke arritur të dalë nder forcat e para politike në vend.

Duke e ndjerë rrezikun që paraqesin për bashkësinë evropiane dhe Amerikën lëvizjet islamiste, bashkësia ndërkombëtare nuk po qëndron vetëm në fushën e propagandës. Propaganda bëhet në Evropë dhe u shërben vetëm evropianëve. Në të kundërtën, ajo ka marrë dhe vazhdon të marrë masa të gjithanshme politike, ekonomike dhe ushtarake, që lëvizja integraliste të mos vijë në pushtet në vendet arabe. Shembulli i Iranit është shumë shqetësues. Në funksion të këtij qëllimi është ofensiva diplomatike dhe politike e Shteteve të Bashkuara në Lindjen e Mesme. Kjo ofensivë është shumë e zgjuar. Ajo nuk synon ndryshimin e karakterit të qeverive të vendeve arabe. Nuk shtrohet hapur alternativa: shtet islamik apo laik. Bota synon forcimin e miqësisë dhe aleancës me këto vende, me qëllim që të ruhet status-quo-ja dhe të shmangët rreziku që integralizmi të shnderrohet nga lëvizje në institucion politik, në faktor ndërkombëtar. Paqja palestinezo-izraelite, paqja jordanezo-izraelite, përpjekjet për paqen siriano-izraelite dhe tuniziano-izraelite etj., janë reflektime të politikës amerikane për të zhvleftësuar karakterin nacionalist të lëvizjeve islamike.

Grindjet në gjirin e shteteve arabe u japin hov këtyre lëvizjeve, u shtojnë influencën në popull. Ndërsa harmonia midis këtyre shteteve minimizon karakterin nacionalist të tyre, pa prekur dhe cënuar anen fetare. Në fund të fundit ajo hyn në liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo është një betejë e madhe. Në njëërën anë është nacionalizmi arab i veshur me petkun fetar, nga ana tjetër është kozmopolitizmi euro-amerikan i veshur me petkun laik.

\* \* \*

Këto zhvillime janë dukuri reale të botës së sotme. Emrat moderne që përdoren sot në vend të termave të vjetër nuk e zgjidhin problemin. Ato vetëm mund ta mbulojnë përkohësisht atë. Ndërsa kontradiktat janë reale, ka një ndryshim të madh me atë që predikohet. Këto dukuri e dëshmojnë se sa i pranishëm është totalitarizmi. Shpesh nevoja e përballimit të tyre dhe e vetë totalitarizmit shpjegohet si një domosdoshmëri për të ruajtur kontrollin, rregullin dhe harmoninë e botës. Aktualisht kjo nuk thuhet hapur nga askush. Vendet e fuqishme dhe të zhvilluara kapitaliste nuk kanë interes ta bëjnë një gjë të tillë. Në këto pozita kanë rënë dhe mendimtarët, analistët dhe politologët e këtyre vendeve. Ata akoma jetojnë me shijen e fitimitarit. Dhe është pikërisht kjo pozitë që nuk i lejon ata të arrijnë në konkluzione të drejta. Deri tani kishin pohuar se totalitarizmi është produkt i sistemit socialist. Mirëpo, me përmbysjen e këtij sistemi, totalitarizmi vazhdon të ekzistojë akoma veçanërisht në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pranimi i këtij realiteti konkret do të thotë plotësim dhe saktësim i tezave të mëparshme mbi burimet e totalitarizmit dhe gjetjen e rrugëve për eliminimin e tij. Kjo ka krijuar një vështirësi të madhe për mendimtarët e vendeve perëndimore. Tani problemi është brenda vetes. Deri dje, sa kohe që gjendej jashtë vetes, ishte më kollaj për të analizuar dhe sugjeruar. Mendimtari e ka më të vështirë të bëjë sugjerime dhe propozime apo analiza të sakta për zhvillime që i përjetojnë edhe subjektivisht. Prandaj, në mjaft raste, bëjnë sikur nuk i shikojnë ato, ose, dhe kur i shikojnë, i shpjegojnë në frymën e analizës së kaluarës apo i cilësojnë si dukuri sporadike. Por harrohet se në këto raste vendin e analizës shkencore e zë propaganda, ndërsa vendin e shkencëtarit dhe analistit e zë propagandisti. Ky problem vazhdon akoma të jetë larg vëmendjes, gati-gati një tabu,



e mbuluar me euforinë e triumfit të demokracisë, edhe në shumicën e vendeve ish-socialiste. Fryma kozmopolite, që është mbjellë në këto vende, ekzistenca e shumë partive politike të pakonsoliduara dhe prapambetja ekonomike në raport me Perëndimin, janë kompensuar me ekzagjerimin e lirisë dhe të drejtave të individit si banor dhe jo qytetar. Megjithatë, kjo situatë nuk mund ta fshehë mprehtësinë e problemit që shtrohet. Përmbysja e socializmit i dha një goditje totalitarizmit, por nuk e zhdukoi atë. Prandaj, nga sa u parashtrua më sipër, kemi të drejtë të konkludojmë:

Totalitarizmi, autokratizmi dhe autoritarizmi përbëjnë një tipar të rëndësishëm të marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare. Demokracia në marrëdhëniet ndërkombëtare midis shteteve është e varur nga interesat strategjike të fuqive të mëdha. Kur këto interesa çënohen, vendin e saj e zë totalitarizmi dhe autoritarizmi.

Dhe tani na duhet të sqarojmë një problem tjetër. A është i domosdoshëm totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare? Rendi i ri botëror, për të cilin po flitet shumë, si do të arrihet, me marrëdhënie demokratike? Apo, për ta krijuar atë, dhe deri sa të krijohet, ka nevojë që totalitarizmi të ekzistojë në marrëdhëniet ndërkombëtare? Për të sqaruar këtë pyetje do të marrim të analizojmë një nga dukuritë më të spikatura të totalitarizmit, të zbuluar me të drejtë nga analistët perëndimorë në veprimtarinë e ish-shteteve socialiste. Kjo është teoria e NJESHIT.

## **Teoria e NJESHIT në marrëdhëniet ndërkombëtare**

*Kombet janë angazhuar në një garë të përhershme, herë në dukje paqësore, herë në mënyrë të hapur, egërsisht...Kjo garë është pa kufij, pa afat, ashtu siç është pa mëshirë.*

*Raimond Aron*

Në kritikën që i bëjnë totalitarizmit mendimtarë të shumtë kanë

zbërthyer, veç të tjerash, dhe mekanizmin e veprimit të tij në ish-vendet ish-socialiste. Fryt i kësaj analize dhe përgjithësimi në veprat e Aronit, Sartorit, Lëforit, Brzezinski etj. është dhe ajo që quhet teoria e NJESHIT: një parti, një byro politike, një prijës. Sipas tyre, fjala dhe gjykimi i njëshit ishte e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë, pavarësisht se ekzistonin në këto vende dhe organizma të tjera, si asamblatë popullore, presidiumet e tyre etj. Me të drejtë ata vënë në dukje në veprat e tyre se organizmat e tjerë kanë qenë vetëm për të zbukurur dekorin e organizmit politik të ish-shteteve socialiste, që veten e tyre e quanin demokraci popullore. Megjithatë, socializmi u përmbys. Por shtrohet pyetja: sundimi i NJESHIT, që përbënte një nga tiparet kryesore të organizimit dhe veprimit të shoqërisë dhe të shtetit në këto vende, a u zhduk bashkë me sistemin, apo vazhdon të ekzistojë akoma? Nëqoftëse se ekziston akoma, cila është sfera e veprimit: në marrëdhëniet brendashtetërore apo marrëdhëniet ndërshtetërore? Për problemin që kemi marrë në shqyrtim na interesojnë më shumë marrëdhëniet ndërshtetërore. Prandaj për t'iu përgjigjur pyetjes së shtruar do të analizojmë dhe marrim në shqyrtim më shumë këto marrëdhënie, veçanërisht në vitet 1990-1995. Përse kemi zgjedhur këtë perudhë për objekt analize dhe shqyrtimi? Përcaktimi si objekt shqyrtimi i një periudhe kohore nuk ka ndonjë qëllim pragmatist. Në të kundërtën, periudha 1945-1990 është e mbushur me dukuri dhe fakte të shumta të pakrahasueshme me periudhën e zgjedhur dhe të vlefshme për të nxjerrë konkluzione. Por analiza dhe shqyrtimi i kësaj periudhe nuk mund t'i japë përgjigje të plotë dhe të saktë problemit që qendron përpara nesh, për një arsye shumë të thjeshtë. Në këtë rast konkluzionet rreth problemit që analizojmë, pavarësisht nga rrjedhimet e tyre, jo vetëm që do të qëndrojnë në kuadrin e historizmit, por dhe do të bashkoheshin në mënyrë të natyrshme në pohimin se "ashtu ishte koha".

Në të kundërtën, etapa 1990-1995, është një etapë cilësisht e re në marrëdhëniet ndërkombëtare, është një etapë që ende nuk është arkivuar, që të bëhet objekt i historizmit, ajo është aktuale, është koha

që jetojmë Për më tepër, kjo është një etapë e pastudiuar mirë dhe në thellësi për gati shumicën e fenomeneve të saj. Në mjaft raste këto dukuri me tepër shpjegohen më shumë nga propaganda sesa nga analiza shkencore, më tepër nga euforia sesa nga serioziteti, më tepër nga një pikëpamje e ngushtë se nga një mendim polifonik dhe nga debati shkencor. Në situatën e veçantë të kësaj periudhe kjo duket se është e natyrshme.

Me të drejtë Fejto në librin e tij "Fundi i demokracive popullore" ngjarjet e viteve 1989-1990 në vendet ish-socialiste i quan një "revolucion pa revolucionarë" Në fund të fundit ato ishin një fitore e madhe e kapitalizmit mbi socializmin. Dhe në cdo rast fitimtarët nuk gjykohen; ata vetë i pushton euforia dhe e nënvleftësojnë analizën e dukurive dhe fenomeneve që shoqërojnë periudhën e pasfitores. Le të kthehemi në analizën konkrete të problemit. Cilat janë tiparet e këtyre marrëdhënieve ndërkombëtare në këtë periudhë?. Dihet se përmbysja e socializmit u shoqërua me probleme nga më të ndryshmet, politike, shoqërore, ekonomike, etike etj. Këto probleme ishin dhe janë të pranishme jo vetëm në ish-vendet socialiste, por gati në mbarë botën. Në vendet ish-socialiste ato ishin dhe janë më shumë probleme brenda vetes, brenda shoqërisë që filloi të lëvizë drejt një mendimi tjetër, drejt një zgjedhjeje tjetër, drejt një kontrate sociale të re, të ndërtuar mbi shenjtërinë e pronës private, mbi institucionin e trashëgimit (testamentit), lavdinë e kapitalit dhe tregun e lirë të punës. Ndërsa për vendet kapitaliste këto probleme ishin dhe janë më shumë në marrëdhëniet ndërshtetërore, por jo pa rëndësi dhe brenda vetë atyre. Të gjitha këto ndryshime i ka ndjekur nga pas dhe vazhdon t'i ndjekë në mënyrë të ethshme një propagandë e fuqishme dhe e shumanshme. Makina e përbindshme e shtypit në këto vite e ka nënvizuar me forcë "demokratizmin e marrëdhënieve ndërkombëtare", si një nga arritjet më të mëdha të njerëzimit në prag të mijëvjeçarit të ri.

Sot është koncept mbizotërues se në Evropë e kudo në botë, përvec ndonjë Iraku apo, tek e shumta, Serbie, nuk ka më vende në armiqësi dhe në konflikte. Prej këtij koncepti ka rrjedhë hartimi i doktrinave të

reja ushtarake si "doktrina mbrojtëse" nga shumica e ish-vendeve socialiste. Në këto doktrina nënvizohet se nga këto shtete asnjë vend nuk konsiderohet armik. Sipas kësaj doktrine sot në botë ekzistojnë vetëm mosmarrëveshje dhe fërkime që mund të zgjidhen në rrugë dhe mënyrë demokratike, por gjithsesi nuk ekzistojnë ferkime armiqësore. Po kështu, një vend i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare po u jepet organizmave të shumtë ndërkombëtarë, duke filluar që nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Europës, Unioni Europian, për të mbaruar me Organizatën e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian. Propaganda e gjatë këtyre viteve këto organizma dhe të tjera si këto po i paraqet si forume ekskluzive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në marrëdhëniet ndërshtetërore. Tanimë në këto organizma e jashtë tyre nuk ekziston më konfrontimi idologjik i periudhës së luftës së ftohtë, kur bota ishte ndarë në dy blloqe. Tani ka vetëm një bllok, blloku kapitalist. Një dukuri i tillë vihet re më shumë në propagandën e shumë vendeve ish-socialiste, e cila pranimin në këtë apo atë organizëm ndërkombëtar e paraqet si një ndër ngjarjet më të rëndësishme, ashtu siç paraqet të tillë ndonjë rezolutë apo deklaratë të forumeve të këtyre organizatave ndaj atij apo këtij vëndi. Të njëjtën frymë ushqen dhe propaganda e shteteve të fuqishme ndaj këtyre organizatave në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Një tipar tjetër i propagandës së periudhës 1990-1995 është konkluzioni se demokratizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare eliminoi përbuzjen, përçmimin dhe nënvleftësimin e shteteve dhe popujve të vegjël, veçanërisht të atyre që ishin nën ndikimin e ish-BRSS-së. Prandaj vizitat e personaliteteve të ndryshëm politikë perëndimorë, fjalët e mira të disa personaliteteve të fuqive të mëdha ndaj vendeve të tjerë, për shembull, pranimi në Këshillin e Europës e të tjera si këto, paraqiten si një ndër faktorët kryesorë të partneritetit, barazisë, mbrojtjes dhe progresit të këtyre shteteve.

Sa janë reale këto tipare të propaganduara me zhurmë dhe bujë të madhe gjatë periudhës 1990-1995? Që në krye duhet pohuar se

propaganda është tjetër gjë dhe realiteti në shumë raste është tjetër gjë. Në tërësi qëllim kryesor i propagandës në çdo vend, i madh apo i vogël qoftë, është zbulimi i realitetit. Bile në shumë raste qëllimi i propagandës rezulton fshehja me mençuri e realitetit. Kjo është e vërtetë jo vetëm në propagandën brenda një vendi, për problemet e brendshme të tij, por aq më shumë në atë për marrëdhëniet ndërkombëtare, e cila qëllimin utilitar e ka thelbin kryesor të saj. Për më tepër që sot, si fitimtarët, ashtu dhe të mundurit, janë aleatë dhe pjesarë të një blloku të vetëm. Në mënyrën më të plotë dhe më të qartë thelbin e propagandës së sotme na e jep Fransua Fejto në librin e tij, Fundi i Demokracive Popullore. Duke trajtuar propagandën lidhur me ngjarjet në Rumani, ai nënvizon se: "Gropat e kufomave të Timishoarës, po gjithashtu gjithë ekzagjerimet e fakteve fantaziste mbi numurin e "martirëve", të revolucionit rumun me total më se 100000 mijë persona kanë hyrë në histori si një rast i jashtëzakonshëm i manipulimit të informacionit si një grackë, kurth, në të cilin mediat perëndimore gjithmonë në kërkim të një scoop-i ranë nga injoranca apo nga mëndjelehtësia" (Fejto, Fundi i Demokracive Popullore, faqe 321).

Marrëdhëniet ndërkombëtare të periudhës 1990-1995 vërtet ndryshojnë nga marrëdhëniet ndërkombëtare të periudhës së luftës së ftohtë, kur përballë njeri-tjetrit qëndronin dy blloqe armiqësorë, të armatosur deri në dhëmbë. Të dy këta blloqe, të udhëhequr dhe kryesuar nga Amerika dhe ish-Bashkimi Sovjetik, luftonin për supremaci dhe zona influence, luftonin për dobësimin e njeri-tjetrit, me të gjitha mjetet, pa përjashtuar këtu mjetet e dhunës së armatosur. Në mënyrë të natyrshme edhe marrëdhëniet ndërkombëtare do ta pasqyronin këtë luftë të tyre dhe në mjaft raste do të ishin të acaruar, duke qënë gjithmonë të shoqëruara me konflikte lokale, me vatra lokale lufte, prapa së cilave direkt apo indirekt kanë qendruar dy superfuqitë. Por kjo dukuri i përket së kaluarës. Aktualisht kemi vetëm një bllok, veçanërisht në Evropë. Armiqtë tani janë bërë miq, megjithëse njerëzit janë po ata që deri në vitin 1990 bënë plane lufte

kundër njeri-tjetrit dhe për të vrarë njeri-tjetrin. Dhe kjo është një veçori e rëndësishme e marrëdhënieve ndërkombëtare, një premisë për marrëdhënie ndërkombëtare demokratike dhe njerëzore. Por ajo është dhe një reminiscencë për të përsëritur në formë të zbutur marrëdhëniet e vjetra ndërkombëtare. Mirëpo kjo veçori dhe premisë njëkohësisht duhet parë se çfarë vlere reale ka, është vetëm në sipërfaqen e marrëdhënieve ndërkombëtare apo prek dhe thelbin e tyre, është e shtrirë për të gjitha fushat që prekin relacionet ndërshtetërore apo ekziston vetëm për aspekte anësore të tyre.

Kjo analize në mënyrë të natyrshme të çon në pohimin e faktit të thjeshtë se përsëri ekzistojnë të njëjtat shtete si më përpara. Por, nëqoftëse më përpara i ndante ideologjia dhe organizimi politik, tani këto barriera janë zhdukur, ideologjia është e njejte dhe organizimi politik i njëjtë. Duhet thënë se vertet ajo që Regani e quante "perandori e së keqes", pra, komunizmi, u zhduk. Por ai nuk u përmbys me dhunë, për eliminimin e tij nuk u përdorën armët. Siç thotë Jaçek Kuroni, "ne nuk e përmbysëm komunizmin, por ai u shemb në kokat tona". Si konkluzion duhet pohuar se, përderisa ekzistenca e komunizmit ishte shkak i ftohjes dhe acarimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, logjikisht me përmbysjen e komunizmit marrëdhëniet ndërkombëtare duhet të jenë plotësisht harmonike, plotësisht vëllazërore dhe plotësisht shoqërore, pa asnjë diskordancë dhe veçanërisht pa asnjë shënjë armiqësie. Logjika e këtij arsytimi përgjithësisht qëndron edhe në konkluzionet teorike të analistëve të shumtë të sistemit socialist, por dhe në vetë realitetin e sendeve dhe fenomeneve, të veshtruara si nocione politike.

Për 50 vjet bota ishte ndarë në dy blloqe që luftonin kundër njeri-tjetrit, për shkak të ideologjive të kundërta. Pa dashur të kundërshtojmë këtë fakt, le të na lejohet të bëjmë një kundërshtim në formën e pyetjes: Kush i ka ftohur dhe acaruar marrëdhëniet ndërkombëtare historikisht? Vetëm komunizmi? Përgjigjja e kësaj pyetjeje nuk ka për qëllim vetëm historizmin, mbrojtje e ndonjë ideologjie. Në të kundërtën, qëllimi i saj është thjesht lehtësia

metodologjike për një analizë të plotë të dukurive dhe fenomeneve ndërkombëtare, si një pikënisje për një profilaksi të plotë në të ardhmen të dukurive dhe konflikteve ndërkombëtare. Përgjigja e pyetjes së mësipërme është e lidhur me përgjigjet e disa pyetjeve të mëtejme: Lufta e parë botërore filloi si luftë midis dy sistemeve politike apo si luftë brenda një sistemi; si luftë e frymëzuar nga ideologjia komuniste apo si luftë shtetesh kapitaliste ideologjikisht pa ndryshime, por me diferenca të dukshme ekonomike?

Historia shpjegon qartë se kjo luftë nisi si konflikt brenda bllokut kapitalist dhe kishte për qëllim rindarjen e zonave të influencës që ekzistonin deri atëherë. Në kohën e atentatit në Sarajevë dhe për tre vjet me radhe që vazhduan me lufte socializmi nuk ekzistonte.

Bashkimi Sovjetik u formua vertet nepermjet revolucionit, por ai që produkt i krizës së botës kapitaliste tashmë të zhytur në lufte. Ndërsa lufta e dytë botërore, ndonëse u zhvillua si luftë midis dy sistemeve, pati karakterin e një kasaphane globale të një lloji të vecantë. Ajo shpretheu dhe u permbyll si konflikt midis antifashistëve, të cilët ekzistonin si në sistemin kapitalist ashtu dhe në atë socialist, dhe fashistëve, që duke e pasur qendrën në disa shtete kapitaliste donin të sundonin gjithë botën. Historia pohon se aleanca e famshme anglo-sovjeto-amerikane ishte aleancë shtetesh me ideologji antagonistë, kundër fashizmit italo-gjerman, që ishte varianti më i vrazhde i ideologjisë kapitaliste.

Shumë dukuri dhe fenomene të marrëdhënies ndërkombëtare të së kaluarës e mbështesin kunderarsyetimin që nisem. Në vijim do të merremi gjërësisht me të. Vërtet momenti aktual, veçanërisht ai i vendeve evropiane, dëshmon për triumfin e një sistemi të vetëm, të sistemit kapitalist. Por kjo është vetëm çfarë duket në sipërfaqe dhe që trumbetohet nga propaganda. Marrëdhëniet ndërkombëtare ndërtohen prej shteteve, të cilët janë po ata që ekzistonin në kohën e luftës së ftohtë dhe të konfrontimit ideologjik, politik dhe ushtarak, me përjashtim të disa shteteve të rinj që dolën nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Klasat politike të shteteve të sotme

kapitaliste, qe predikojnë marredhënie demokratike dhe partneritet, janë po ato që deri në vitet 1990 ndaj vendeve ish-socialiste flisnin me një gjuhë tjetër, i konsideroin ato si vende armike. Me kete mendesi eshte krijuar dhe rrënjosur edukata dhe psikologjia e kësaj klase. Ky mentalitet nuk eshte njëvjeçar apo disavjeçar. Ai u farkëtua për gati 50 vjet, nëpërmjet një lufte të egër politike, ekonomike dhe ushtarake, me pak detante dhe shume acarime, duke arritur në periudha të caktuara në pragun kritik te shpërthimit të luftës bërthamore. Eshtë kjo arsyeja që ai ka nje peshe te dukshme edhe mbi mentalitetin e ri të periudhës midis viteve 1990-1995.

Edhe në vendet ish-socialiste problemi është pak a shume i njëjtë. Klasat politike që drejtojnë jetën politike dhe ekonomike të këtyre vëndeve, me ndonje perjashtim, janë ose vazhdim drejtevizor i klasës politike komuniste, ose rrjedhim i saj. Ajo eshte e formuar me njerëz të lindur, të rritur dhe edukuar në psikologjinë dhe mentalitetin 50-vjeçar të socializmit. Ndonese në një kahje tjetër, problemi është i njëjtë. Sipas mentalitetit te trashëguar, i cili nuk mund te ekzorcohet si nje enderr e keqe, kapitalizmi shikohej si produkt i të gjitha të këqijave dhe vendet kapitaliste si armike. Nuk duhet lene jashte vemendjes edhe fakti se njerëzit, si subjekte politike, janë po ata, si në vendet kapitaliste klasike, dhe në vendet ish-socialiste që po ndërtojnë tani kapitalizmin. Por ajo që ka me shumë rëndësi eshte se të gjitha arsenalet ushtarake, gati të gjitha armët e fabrikua deri dje, më destinacion për t'u përdorur per shfarosjen e nje kampi nga tjetri, ekzistojnë akoma në magazinat dhe depot e shteteve të ndryshme. Madje rrezikshmeria e tyre eshte shumefishuar. Nëqoftëse deri dje ato ishin nën kontrollin e rreptë të shtetit, sot, nën petkun e marredhënieve demokratike dhe nen pushtetin e etjes për fitim, veçanërisht në ish-shtetet socialiste, ato kanë filluar të shiten në masë, duke rënë në mjaft raste në duar të organizatave apo sekteve terroriste, që mund t'i përdorin pa ndonjë shkak të rendit politik, duke shkaktuar tragjedi të vërteta njerëzore. Mjaftojnë dy shembuj per te perforcuar mbeshtjeten e kësaj teze. Rasti i sektit te vetevrasesve te rinj, "kakimadze-ve" te



koheve moderne te Japonise, që shkaktoi tragjedinë e njohur në metronë e Tokios, e dëshmon qarte rrezikun e përhapjes se armeve ne duar gjithëfaqeshe. Udhëheqja e këtij sektit, siç doli nga hetimet e policisë japoneze, kishte marrëdhënie tregëtare me Rusinë për blerjen e teknologjisë së sofistikuar ushtarake, të cilën Rusia e ka me bollëk. Analogjik është dhe skandali i bisedimeve midis Iranit dhe Ruisë. Në përgatitjet e tij për të prodhuar armët bërthamore, Irani ishte i gatshëm të blente nga Rusia të gjitha pajisjet e duhura teknologjike. Deri në fund të viti 1995 këtë e pengoi ndërhyrja personale e presidentit të Amerikës Bill Klinton.

Keto dukuri nuk mund të mos ndikojnë në marrëdhëniet aktuale ndërkombëtare, te cilat, në një formë apo në një tjetër, reflektojnë te njejtin thelb dis'harmonie dhe konfliktesh.

Propaganda dhe publicistika e sotme po flet me një eufori të papare për ato që quhen tashme mardhëniet vëllazërore dhe shoqërore midis shteteve, veçanërisht midis shteteve të vogla e të mëdha, midis shteteve të pasura dhe shteteve në zhvillim e për te tjera slogane roze si këto. Nuk mungon që kjo propagandë të sjellë në favor të tezave të veta dhe dukuri, fenomene të "ringjalljes demokratike".

Gjatë periudhës 1990-1995 stacionet televizive evropiane u kanë bere jehonë të madhe ndihmave humanitare që njerezit, shoqatat apo organizata të tjera, deri dhe shtetet e Perëndimit, kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për disa nga vendet ish-socialiste. Brenda kësaj propagande ose në kuader të saj nuk është kujtuar kush të thotë se zhvillimi ekonomik i një vendi nuk bëhet me ndihma humanitare, me asistence ushqimore, por me kredi dhe investime të rëndësishme.

Askush nuk është kujtuar, madje, të thotë se në mjaft raste realiteti i disa vendeve është paraqitur shumë i zi dhe përbuzës, duke kaluar nga kritika e sistemit në fyerjen dhe përçmimin kombëtar. Për me teper, shtypi perendimor nuk është thelluar te shohe në varferine e vendeve ish-socialiste jo vetem një plage të sistemit, por edhe një shprehje të padrejtesive të pergjithshme mbi te cilat funksionon bota e sotme dhe ajo e djeshme, bota e dikurshme dhe ajo që është në ndertim e siper.

Vizitat e ndërsjellta dhe takimet shumë të shpeshta të presidentëve, kryeministrave apo ministrave të shteteve të ndryshme dhe shkëlqimi i veçante që u jepet atyre në mjetet e medias krijojnë tek masat e popujve idenë e një ndryshimi vërtet themelor në marrëdhëniet ndërkombëtare. Deri në vitet 1989 ishin të rralla takimet që mbaronin me buzëqeshje. Ndërsa në vitet 1990-1995 pothuaj çdo takim mbaron me të qeshura dhe shtërngime duarsh. Opinioni ndërkombëtar në tetor 1995 u mor për shumë ditë me të qeshurën e pambarim të Klintonit në takimin me Jelcinin, duke i dhënë asaj një përmbajtje që ndoshta nuk e kishte aspak. Deri në vitin 1989 në bllokun perëndimor fushatat elektorale përgjithësisht bëheshin zyrtare (në vendet ish-socialiste dihet se ato zhvilloheshin sipas një rituali të caktuar dhe tepër të rreptë). Ndërsa në periudhën prej vitit 1990 e më vonë, jo vetëm në bllokun perëndimor, por dhe në atë lindor, kandidatët për deputete apo për presidente gjatë fushatës elektorale mbajnë fjalime, por dhe u bien veglave muzikore, siç bëri Klintoni në prag të marrjes së detyrës. Në vendet ish-socialiste po ndiqet e njëjta praktikë. Borgjezi i ri polak, ish-komunisti Kvasnjanski, gjatë fushatës elektorale, jo vetëm që mbajti fjalime, por kërcëu dhe rock para rinisë së vendit. Ndërsa në ceremoninë e parakalimit të ushtrisë ruse me rastin e largimit nga Gjermania Lindore, Jelcini filloi të këndonte "Kalinkën", deri sa iu ngjir zëri.

Forma të tilla kanë për synim të krijojnë përfytyrimin e një tipi të ri udhëheqësi, ashtu siç është e re epoka e pas përmbyesjes së socializmit. Megjithatë duhet nënvizuar se opinioni ndërkombëtar nuk po ndeshet për herë të parë me një dukuri të tillë. Gjithmonë ka pasur scoop-e politikanësh. Fundi i viteve '50-të dhe fillimi i viteve '60-të nxori në skenën politike të komunizmit një model udhëheqësi si Nikita Hrushovi. Dhe ai në kohën e tij për të krijuar tipin e një lloji të ri politikani në botën komuniste filloi të praktikonte metoda dhe sjellje të panjohura më parë nga bota. E tillë ishte nxjerrja e këpucës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, gjoja për të shprehur zemërimin e tij. Koha tregoi se veprime të tilla bënin pjesë në të famshmet

zbulime të propagandës së atëhershme sovjetike, për të fshehur thelbin real, shndërrimin total të Bashkimit Sovjetik në një superfuqi botërore. Pra, nuk ka ndonjë dallim me rëndësi "këpuca" e Nikita Hrushovit nga "saksofoni" i Bill Klintonit, nga "kënga" e Boris Jelcinit apo "rock-u" i Kvashnjevskit. Ato si sende janë të ndryshëm. I njëjtë është thelbi i tyre.

Sot po projektohet dhe flitet shumë për rendin e ri botëror, apo për Evropën e bashkuar. Unioni Evropian, që paraqet bërthamën e Evropës së Bashkuar, ka kaluar dhe po kalon në veprime konkrete, siç ishte ai në fundin e vitit 1995, për krijimin e monedhës europiane si monedhe aktive, jo simbolike, sic ishte deri atëherë. Por në shtete dhe vende të ndryshme të Evropës përmbyssa e socializmit ka krijuar mjaft probleme të mprehta ekonomike, politike dhe nacionale, ka thelluar diferencat ekonomike në rajon, si dhe njëfarë mosdurimi të njeri-tjetrit. Edhe gjermanet kanë filluar të ankohen nga bashkimi Ka, në tërësinë e këtyre problemeve, qëndrime të drejta dhe normale të vendeve dhe shteteve të ndryshëm, ashtu siç ka dhe qëndrime ekspansioniste apo shovinizem nga disa shtete të tjerë. Në mënyrë të natyrshme këto probleme janë pasqyruar dhe vazhdojnë të pasqyrohen dhe në marrëdhëniet ndërshtetërore, duke i ndërlikuar ato. Bashkësia ndërkombëtare, e ndeshur me probleme të tilla, ka ndërhyrë në mjaft raste për t'i zgjidhur ato, për të mos i lejuar të acarohen me tej. Brenda kësaj tabloje të marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare, brenda problemeve të ndryshme që ekzistojnë sot midis shteteve, na lind e drejta për të pyetur:

Si po zgjidhen në përgjithësi mosmarrëveshjet ndërshtetërore sot, si po zgjidhen problemet e ndryshme konkrete që kanë shtetet me njeri-tjetrin apo problemet që kanë brenda vetes? Po zgjidhen në mënyrë demokratike apo për zgjidhjen e tyre ka nevojë për teorinë e NJESHIT, që nuk është gjë tjetër veçse dukuri e paster e totalitarizmit? Lidhur me këto problem, ka nevojë të evidentojmë se në cilat sfera të marrëdhënieve ndërshtetërore sot veprojnë marrëdhëniet demokratike dhe në cilat sfera lind e nevojshme ushtrimi i teorisë së NJESHIT?

## Kriza boshnjake, marredhëniet demokratike dhe roli i NJESHIT

Le ta konkretizojmë problemin me një shembull të freskët të marredhënieve ndërkombëtare të periudhës 1990-1995. Shembulli ka të bëjë me ngjarjet në Bosnjë. Lufta në Bosnjë filloi pas njohje së saj nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si shtet i pavarur. Në këtë periudhë serbët e Bosnjës, të ndihmuar fuqimisht nga Serbia, nisën luftën kundër qeverisë boshnjake. Më vonë në këtë luftë kundër boshnjakëve për të fituar territore hynë dhe kroatët e Bosnjës, të ndihmuar nga Kroacia. Të gjithë stacionet televizive, të gjitha gazetat, analistët apo politologë të ndryshëm, kanë komentuar, shkruar dhe folur se ngjarjet e Bosnjës i kanë komprometuar rëndë marredhëniet ndërkombëtare të periudhës pas përmbyesjes së socializmit. Megjithatë duhej të kalonin tre vjet luftë dhe masakra të përgjakshme që problemi të fillonte të hynte në rrugën e zgjidhjes.

Brenda Evropës demokratike ngjarjet e dhimbshme në Bosnjë në periudhën 1992-1995 u zhvilluan nën parullën "Rroftë vdekja". Origjina e kësaj parulle është viti 1936 në Spanjë. Gjatë një ceremonie në amfitetatrin e universitetit të Salamankës, gjenerali frankist Milan Astraj, në mbarim të fjalimit të tij u përshëndet nga turma falangiste me parullën: "Viva la muerte", (Rroftë vdekja). Fatkeqësisht njerëzit pandehën se nuk ekziston më kjo parullë, por ata e panë atë të materializuar në masakrën boshnjake. Megjithese kohët kanë ndryshuar, ka ndodhur kalimi nga diktatura në demokraci, parulla ka mbetur po ajo e diktaturës.

Eshtë me interes për problemin që po analizojmë të sqarojmë se me cilën rrugë po zgjidhet tragjedia e Bosnjës në marredhëniet ndërkombëtare? Me anë të rrugës demokratike apo me anë të teorisë së NJESHIT? Problemi boshnjak ishte një problem ndërkombëtar. Organizata e Kombeve të Bashkuara, disa kohë pas shpalljes së pavaresisë nga qeveria boshnjake e kishte njohur shtetin boshnjak. Në gjuhën e marredhënieve ndërkombëtare, agresioni kundër Bosnjës ishte

në të njëjtën kohë cënim i parimeve të OKB-së dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të reja që po krijoheshin. Si i tillë, vetë OKB-ja duhej ta zgjidhte këtë problem. Trupat e OKB-së në fakt u dërguan në Bosnjë. Por cili ishte misioni i tyre. Shumë ironik. Ato kishin për detyrë të ruanin paqen në një vend ku bëhej luftë e tmerrshme. Për dy vjet që qëndruan, ato jo vetëm që nuk e zgjidhën krizën, jo vetëm që nuk luftuan, por për më tepër e diskredituan organizatën së cilës i përkisnin. Megjithatë anetarë të kësaj organizate janë Amerika, Rusia, Franca, Gjermania, Anglia, Kina etj, megjithatë të gjithë ishin dakord për zgjidhjen e krizës me anë të OKB-së, më shumë u morën me fjalë se sa me zgjidhje konkrete.

Kur u pa se dështoi zgjidhja e kësaj vatre të rrezikshme në marrëdhëniet ndërkombëtare me një formë demokratike siç ishte ajo nepermjet kontrollit të OKB-se, u vu përsëri në veprim një formë e re demokratike për zgjidhjen e krizës. U krijua i ashtuquajtur i Grupi i Kontaktit me përfaqësues të Amerikës, Rusisë, Gjermanisë, Francës dhe Anglisë, që në esencën e tij përfaqësonte një formë demokratike. Por dhe kjo formë demokratike dështoi. Anetarët e Grupit të Kontaktit nuk u morën dot vesh me njeri-tjetrin për ta zgjidhur krizën; hapur apo fshehur ata mbronin këtë apo atë palë në konflikt. Le të kujtojmë se antarët i këtij grupi bëjnë pjesë në vendet më të fuqishme të botës, në gjirin e së cilës me dhjetëra mendimtarë kanë shkruar me mijëra faqe mbi raportin midis demokracisë dhe totalitarizmit, me mijëra faqe mbi të këqijat e totalitarizmit dhe kampet e përqëndrimit në ish-vendet socialiste. Por çuditërisht në periudhën pas viteve '90-të, për kampet e përqëndrimit në Bosnjë dhe për shkaktarët e vërtetë të tragjedise se këtij populli nuk thanë asnjë fjalë.

Pas tre vjetësh, të gjithë e pranuan se me anë të mjeteve demokratike kriza e Bosnjës nuk mund të zgjidhej. Autorët e konfliktit nuk ishin të përgatitur për një zgjidhje të tillë. Por as ata që u ngarkuan për ta zgjidhur, organizmat demokratike, evropiane apo botërore qofshin, nuk ishin dhe nuk janë të përgatitur për zgjidhjen e krizës me mjete demokratike. Po një gjë duhet nënvizuar. Të gjithë kanë pohuar dhe

pohojnë se konflikti boshnjak është konflikti më i përgjakshëm qysh nga përfundimi i luftës së dytë botërore. Ky konflikt nuk ndodhi në periudhën e ekzistencës së dy blloqeve, por në periudhën ekzistencës vetëm të bllokut kapitalist. Pra, fuqitë e mëdha të botës u ndodhën para një dileme të madhe. Duhej shpetuar nderi dhe dinjiteti i atyre që predikuan një etapë të re pas përmbysjes së socializmit në marredhëniet ndërkombëtare, si dhe duhej ndaluar me çdo kusht përhapja e konfliktit boshnjak në rajone të tjera.

Pikërisht pas këtij momenti u vu në veprim teoria e NJESHIT. Atë që nuk e zgjidhi demokracia duhej ta zgjidhte dhe e zgjidhi forca, totalitarizmi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosën t'i japin fund këtij konflikti me anë të forcës. Brenda një periudhe të shkurtër, me anë të një udhëtimi maratonik të Parry-t dhe Holbrukut nëpër vendet më të mëdha të Evropës, jo vetëm që i njohën këto vende me planin e tyre, por arritën të marrin plotësisht mendimin dhe aprovimin e tyre. Përsëri brenda një kohe shumë të shkurtër, me të mirë, por dhe me kërcënime, jo vetëm që arritën t'i mbledhin në Dejton palët ndërluftuese, por i detyruan të nënshkruajnë planin që ata kishin hartuar. Nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por, përsëri me anë të forcës, arritën të bindin dhe të tjerët që paqen në Bosnjë ta ruajnë me forcën e armëve dhe të 70 mijë ushtarëve të armatosur deri në dhëmbë, të gatshëm që të ndërhyjnë ndaj kujtdo që shkel planin e hartuar prej tyre e të firmosur prej serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve.

Pra, ky konflikt në marredhëniet ndërkombëtare të pas vitit '90-të nuk u zgjidh me mjete demokratike, po me anë të forcës. Paqe me dhunë. Konkluzioni i kësaj ngjarjeje nga më të rëndësishmet e marredhënieve ndërkombëtare është i qartë: Organizma të tilla si OKB-ja, OSBE-ja, Grupi i Kontaktit, Konferenca e Londrës, si pasqyra të marredhënieve demokratike etj janë të paaftë të zgjidhin mosmarrveshjet kryesore ndërkombëtare në situatën e sotme. Ato e treguan veten plotësisht të pafuqishme për t'i zgjidhur fërkimet që kanë lindur gjatë kësaj periudhe, jo vetëm në Bosnjë, por dhe në pika të tjera të botës. Ende e vetmja mundësi dhe forcë e tyre janë rezolutat, paralajmërimet. Asgjë

tjetër. Ato nuk kanë mundur të sjellin në një mendje të gjithë anëtarët e tyre, jo më kur bëhet fjalë për 150 shtete, por kur bëhet fjalë dhe për katër apo pesë shtete. Për më tepër, atyre u ka munguar gjëja më kryesore, forca, forca e armëve, e ushtrisë etj. Dalim këtu në një dukuri tjetër që vetëm sa do ta përmendim. Periudha 1990-1995, megjithese periudhë me një bote që ka një sistem dhe ideologji sunduese, paska nevojë për përdorimin e dhunës në marrëdhëniet ndërshtetërore, duke rënë në kundërshtim me thelbin e propagandës së kësaj periudhe, se tanimë nuk ka më armiqësi dhe armiq, por vetëm kontradikta që zgjidhen me anë bisedimesh. Mbi bazë e realitetit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe problematikës së tij gjatë periudhës 1990-1995, si dhe të rolit të institucioneve ndërkombëtare, kemi të drejtë të pohojmë dhe të konkludojmë:

Thënë figurativisht, organizatat ndërkombëtare evropiane dhe botërore, nuk janë gjë tjetër veçse dekor i mardhënieve ndërkombëtare. Në thelb, ngjarjet më të rëndësishme ndërshtetërore të periudhës 1990-1995, janë zgjidhur dhe kanë marrë rrugën e zgjidhjes, vetëm atëherë kur kanë ndërhyrë seriozisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Domethënë kur ka ndërhyrë NJESHI. Në të gjitha këto raste fjalët dhe vendimet e NJESHIT, me hir apo pahir, kanë qenë të detyruar t'i pranojnë të gjitha shtetet e tjera të mëdha, po të pafuqishme për t'u matur me NJESHIN. Megjithatë, për të ruajtur sadopak imazhin e zgjidhjes demokratike, janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen manovrimet e ndryshme. Duhet që njerezit të besojnë se në botën e sotme të gjitha problemet, sado të ndërlikuara qofshin, janë zgjidhur e do të zgjidhen me konsensus dhe me mjete demokratike. Por ato kanë qenë dhe janë vetëm për propagandë. Le ta ilustrojmë me një shembull të afert. Është shumë sinjifikative që, megjithese ishin ShBA-të ato që i detyruan serbët, kroatët, boshnjakët të nënshkruanin marrëveshjen e Dejtonit, për t'u bërë qejfin dhe të tjerëve, ata ishin dakord dhe dhanë pëlqimin e tyre që ceremonia dhe fishekzjarret e kësaj marrëveshjeje, pra, ana formale, të zhvillohej në Londër dhe Paris. Në këtë mënyrë përpara opinionit botëror krijohej ideja se në çështjen bosnjake bashkësia

ndërkombëtare kishte pasur një mendim të përbashkët. Çdo gjë ishte zgjidhur me konsensus.

Çfarë është dhe çfarë do të thotë kjo praktikë e freskët e marrëdhënieve ndërkombëtare, në thelbin e saj dhe jo në mënyrën sesi u paraqit, cila është përmbajtja e saj reale? Në thelb një praktikë e tillë e marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare siç ishte praktika që u ndoq që nga marrëveshja reale e Dejtonit deri tek nënshkrimi formal i Parisit apo Londrës, nuk është gjë tjetër veçse një ngjashmëri interesante me të kaluarën e vendeve socialiste, që aq mirë e kanë analizuar Lëfor, Sartor etj. Kushdo që e njih zbatimin e teorisë së NJESHIT në vendet ish-socialiste, e ka të qartë se disa praktika të tanishme të zgjidhjes së konflikteve në marrëdhëniet ndërkombëtare të kujtojnë vendimet e byrove politike në ish-vendet socialiste, të cilat formalisht dhe në mënyrë ceremoniale, vendoseshin edhe në presidiumet e kuvendeve popullore apo të parlamenteve të tyre për t'u dhënë ngjyrën e formave demokratike.

***Raporti midis të drejtës dhe forcës në marrëdhëniet ndërshtetërore. Gjithë politika e jashtme ka qenë, gjer në epokën tonë, politika e fuqisë, forcës, sado të ndryshme që të kenë qenë modalitetet e bashkimeve dhe marrëdhëniet midis këtyre bashkimeve.***  
***Maks Veber***

Le të vimë tani tek një çështje tjetër: a është i domosdoshëm roli i NJESHIT në marrëdhëniet ndërkombëtare të periudhës së pas përmbysjes së socializmit? Nga njera anë, mendimtarë dhe politologë të ndryshëm teorinë e NJESHIT e konsiderojnë një ndër tiparet themelore të totalitarizmit. Nga një anë tjetër, koha e sotme karakterizohet si periudhë e ndërtimit të rendit të ri demokratik. Mos kemi të bëjmë me një kontradiksion? Apo për ndërtimin e rendit të ri botëror dhe vendosjen e marrëdhënieve demokratike ndërshtetërore, roli i NJESHIT, pra, totalitarizmi, është i domosdoshëm? Para se të kalojmë në analizën më konkrete të problemit të shtruar, le



t'i referohemi një mendimi të Aleksis Tukëvillit, njërit prej mendimtarëve më të mëdhenj të botës. Ja pohimi i tij: "Bashkëkohësit e mi dhe unë, ne ecim përditë e më shumë në rrugë aq të ndryshme, nganjëherë aq të kundërta, që ne nuk mund pothuajse kurrë të takohemi në të njëjtat sentimente dhe në të njëjtat probleme." (Aleksis Tukëvil, cituar nga J.P.Majer, faqe 33) Ja dhe pohimi i një politologu dhe sociologu të madh, Raimond Aron: Ai thotë: "Brenda kombeve, ashtu si midis kombeve, marrëdhëniet shoqërore përbëjnë një element konflikti që varion sipas rastit, konkurrencës, rivalitetit, luftës. Shkaqet e konflikteve janë të shumta dhe nganjëherë nderi i fituesit është vetëm rikompensimi. Një botë pa konflikte është plotësisht e pamundur."

(Aron, Etapat e sociologjisë, faqe 651)

Ja dhe konkluzioni i njerit prej antimarksisteve më të mëdhenj, por njëkohësisht dhe njerit prej mendimtarëve të mëdhenj, Maks Veber, në formën e dialogut të tij me Ludendorfin, ministër gjerman i luftës në përfundimin e luftës së parë botërore:

"Veber: Besoni ju se unë do të marr një ndyrësi, që ne e kemi tani për demokraci?"

Ludendorf: Nëqoftëse ju flisni kështu, ne do të mundemi ndoshta të biem dakord.

Veber: Po ndyrësia e parë nuk ishte jo më monarki.

Ludendorf: Çfarë prisni ju nga demokracia?

Veber: Në demokraci, populli zgjedh një shef (Führer), tek i cili ai vë besimin e tij. Pastaj ky që është zgjedhur thotë: Tani mbylleni gojën dhe binduni. Populli dhe partitë nuk kanë më të drejtë veçse të binden.

Ludendorf: Një demokraci e tillë do të më pelqente"

(Mariane Veber: Max Weber, ein Lebensbild, faqe 664-665. Cituar nga Aron në Etapat e mendimit sociologjik, faqe 581)

Vleresimi i Tukëvilit është se njerezit ecin në rrugë aq të ndryshme, sa nuk mund të takohen kurrë. Ndërsa Aroni pohon se botë pa konflikte nuk mund të ketë kurrë. Veberi është më i hapur. Ai kërkon që të gjithë t'i binden vetëm një njeriu. Nëqoftëse apriori do t'i marrim këto tre pohime si të vërteta universale, atëherë në mënyrë të natyrshme

mund të konkludojmë se dhe në periudhën e sotme bota do të ketë konflikte si ai i Bosnjës. Këto konflikte nuk mund të zgjidhen në mënyrë demokratike. Bosnja e vërtetoi qartë një gjë të tillë. Prandaj për të vendosur, edhe në periudhën e tanishme të ekzistencës së një sistemi, një lloj harmonie dhe rregulli në marrëdhëniet ndërkombëtare, është plotësisht i nevojshëm dhe domosdoshëm roli i NJESHIT.

Qysh me krijimin e tyre, shtetet e ndryshme kanë hyrë në marrëdhënie me njeri-tjetrin. Këto marrëdhënie kanë qenë dje, janë dhe sot të shumanshme, politike, protokollare, ekonomike, ushtarake, kulturore, sportive, shkencore etj. Marrëdhënie të tilla, ashtu siç kanë qenë ura afrimi dhe bashkëjetese midis shteteve dhe popujve, shpesh kanë përbërë dhe bazën e problemeve që kanë lindur në kohë dhe etapa të ndryshme midis shteteve, të cilat janë zgjidhur herë me mjete paqësore dhe herë me mjete dhune. Brenda këtij kuadri marrëdhëniesh dhe problemesh që kanë shoqëruar shtetet e ndryshme dhe evolucionit të tij, u krijua dhe ajo që quhet teoria dhe praktika e marrëdhëniesh ndërkombëtare, e cila ka evoluar nga koha në kohë, deri sa ka ardhur e plotë dhe tërësore në ditët tona.

Brenda marrëdhëniesh ndërkombëtare ka pasur dhe ka mjaft probleme dukuri dhe fenomene. Por një ndër më kryesorët ka qenë dhe është teoria e së drejtës së popujve dhe shteteve dhe forcës së tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo teori i ka shoqëruar marrëdhëniet ndërshtetërore qysh nga pikënisja e tyre, më lindjen dhe zhvillimin e kapitalizmit, lindjen dhe zhvillimin e socializmit e deri në ditët tona. Në kohë dhe etapa të ndryshme ajo ka pësuar ndryshime dhe ka evoluar, por asnjëherë nuk ka pushuar së qeni prezent në marrëdhëniet ndërkombëtare. Lidhur më të dhe për të maskuar realitetin real të saj, janë hartuar me dhjetëra vepra dhe traktate teorike nga mendimtarë dhe sociologë të ndryshëm. Si e tillë teoria e forcës dhe së drejtës është e pranishme dhe në periudhën e pas viteve '90-të në marrëdhëniet midis shteteve të ndryshme. Pavarësisht nga çfarë thuhet dhe propagandohet, pas krijimit të një sistemi të vetëm, pas vendosjes së marrëdhëniesh demokratike në praktikën ndërkombëtare, përsëri raporti

midis së drejtës dhe forcës vazhdon të peshojë mbi këto mardhënie. Para se të analizojmë se në çfarë raporti janë sot e drejta dhe forca, le të bëjmë një vështrim të shkurtër rreth këtij problemi në të kaluarën e afërt të shteteve dhe marrëdhënieve midis tyre. Cila ka qenë teoria dhe praktika e të drejtës dhe forcës në marrëdhëniet e mëparshme ndërkombëtare? Do të marrim dhe analizojmë dy anë, dokumentet dhe teorinë dhe nga ana tjetër praktikën dhe realitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo do të na ndihmojë për ta bërë më të qartë problemin dhe për ta ç' manipuluar atë. Në dokumentet e organizmave ndërkombëtare, veçanërisht duke filluar qysh nga viti 1922, kur u krijua për herë të parë Lidhja e Kombeve, gjithmonë është theksuar se çdo shtet ka të drejtën dhe sovranitetin e tij për të qenë i lirë dhe i pavarur, jo vetëm brenda vendit të tij, por dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka të drejtë të thotë dhe të shprehë mendimin e tij për probleme të ndryshme pavarësisht nga zhvillimi ekonomiko-shoqëror dhe madhësia e territorit.

Ndërsa praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare në të kaluarën ka treguar të kundërtën. Në të kaluarën thelbi i të drejtës dhe forcës ka qenë: Një shtet apo komb, megjithëse ka patur të drejtë, megjithatë, kur nuk ka patur forcë për ta fituar të drejtën apo për ta ruajtur atë, atëherë e drejta e tij ka mbetur në letër. Domethënë, në mënyrë më konkrete, të drejtë pa forcë nuk ka. Është forca politike, ekonomike dhe ushtarake ajo që ka materializuar të drejtën. Kjo është edhe në rregullin zyrtar të funksionimit të bashkësisë ndërkombëtare. Mund të pohohet në mënyrë të argumentuar fakti se totalitarizem nuk ka vetëm në jetën e brendshme politike të një shteti, por edhe në marrëdhëniet midis tyre, sidomos në marrëdhëniet midis të pasurve dhe të varferve, midis metropoleve dhe margjinave, midis të medhenjve dhe të vegjelve, midis peseshes së perhershme të Keshillit të Sigurimit dhe gjithë të tjerëve. Sa kohe ka veto për pesë dhe votë për 150, totalitarizmi është me status juridik.

Me i drejtpeshuar do të ishte parashtrimi në formë alternative i rolit të

SHBA: garant i paqes apo i interesave te veta. Por me ngjan se teperohet pak kur pohohet se Evropa me KSBE-ne dhe NATO-n ka deshtuar. Interesant eshte trajtimi i raporteve te vendeve ish-komuniste me traktatin e NATO-s. Zbulohet mire paradoksi se kujt i duhet garanti kur nuk ka me armiq. Se paku te marrim vesh se nga vjen rreziku, ne mos na vjen nga alien-etj.

Disa shembuj dhe dukuri nga e kaluara jane te mjaftueshme per te saktësuar dhe argumentuar tezën e mësipërme. Si u nda Evropa e pas luftës së dytë botërore? Te gjithë e dinë se në Teheran, Jaltë apo Potsdam, Evropa u nda jo mbi kriterin e së drejtës së çdo kombi apo shteti, por mbi bazën e forcës së tre të mëdhenjve, Amerikës, Ruisisë dhe Anglisë. Forca pas luftës ishte në këto tre fuqi. Aty ishte dhe e drejta. Prandaj për 50 vjet shtetet e ndryshme të Evropës mbetën ashtu siç u ndanë gjatë luftës së dytë botërore. Për 50 vjet e drejta e mjaft kombeve dhe shteteve mbeti një e drejtë në letër, fiktive, e mjaftueshme vetëm në dokumenteet e organizmave ndërkombëtare dhe fjalimet e politikanëve të shteteve të fuqishme. Në 1956, Hungaria kishte të drejtë të vendoste për fatin e saj si shtet dhe si komb, por, meqë nuk kishte forcë, e drejta reale u takoi tankeve dhe ushtrisë sovjetike. Bota pranoi të drejtën e forcës dhe jo të drejtën reale. Në 1968 Çekosllavakia kishte të drejtë të dilte nga Traktati i Varshavës, por përsëri, meqë nuk pati forcë, e drejta i takoi ushtrisë së Traktatit të Varshavës dhe teorisë së sovranitetit të kufizuar të Brezhnjevit. Në 1956 Egjipti kishte të drejtë të vendoste sovranitetin mbi kanalin e Suezit, por duke mos patur forcë të përballonte ushtrinë anglo-franceze u detyrua të pranonte forcën e tyre dhe konceptin e tyre mbi të drejtën. Në 1973, populli kilian kishte të drejtë të zgjidhte formën e tij të qeverisjes dhe politikën e jashtme që do të ndiqte duke patur në krye Salvador Alenden, por duke mos patur forcë për ta mbrojtur këtë të drejtë, u detyrua të pranojë atë të drejtë që i dhanë amerikanët, diktaturën gjakatare të Pinoçetit. Në 1981 populli shqiptar në Kosovë kishte të drejtë të kërkonte statusin e republikës, por duke mos patur

forcë, u detyrua të pranonte me anë të dhunës, aq të drejtë sa i dhanë tanket dhe ushtria jugosllave.

Çfarë tregojnë shembujt e mësipërm? Ato flasin qartë se në të kaluarën e drejta kur ka qenë pa forcë, është zëvendësuar me të drejtën e forcës. Të drejtën nuk e ka përcaktuar analiza dhe dialogu i problemit, por atë e ka përcaktuar sasia e tankeve dhe teritorit apo aleancat ushtarake.

Mbi këtë bazë kemi të drejtë të themi se definicionet mbi të drejtën në programet e organizmave nderkombëtare, nuk kanë qënë gjë tjetër veçse një mashtrim i madh mbi popujt dhe shtetet e ndryshëm.

Megjithatë, do të pranojmë për një çast se në kushtet e ekzistencës së dy blloqeve dhe të dy sistemeve plotësisht të kundërta, për të ruajtur ekuilibrin botëror në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka qenë e domosdoshme të përdorej forca për të vendosur të drejtën e forcës.

Duke pranuar një pohim të tillë si të vërtetë, na duhet të shtrojmë pyetjen dhe të analizojmë periudhën e re të marrëdhënieve ndërkombëtare, atë të pas viteve 1990, kur blloqet nuk ekzistojnë më dhe kur sistemi komunist nuk ekziston më. Periudha 1990-1995, është e mjaftueshme jo vetëm për të pyetur, por dhe për të analizuar dhe arritur në konkluzione, qoftë dhe të pjesshme. Si qendron problemi sot: E drejta e një kombi apo shteti materializohet si e tillë pavaresisht nga forca që ka ky shtet apo ky komb, pavaresisht nga zhvillimi i tij ekonomik dhe madhësia e territorit, apo veprohet ndryshe. Cili është ndryshimi i këtij problemi sot në raport me të kaluarën?

Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje do të çojë në konkluzionin se periudha e sotme është vërtet e re në zgjidhjen e problemeve që lindin në gjirin e marrëdhënieve ndërkombëtare apo ajo hiqet si e tillë, dhe në fakt ka mbetur ajo e para. Po para se të analizojmë problemin do të bëjmë dhe një sqarim të rëndësishëm. Kur flasim sot për realizimin e të drejtës së çdo kombi apo çdo vendi në marrëdhëniet ndërkombëtare, nuk kemi parasysh probleme anësore që lindin gjatë procesit të këtyre marrëdhënieve, nuk kemi parasysh probleme të sferës sportive, kulturore, shkencore etj. Çështja qëndron në probleme të qënësishme të një kombi apo shteti, probleme që përcaktojnë fizionominë e tij,

probleme që kanë të bëjnë me të drejtën e konsolidimit dhe bashkimit të tij, të sovranitetit dhe pavaresisë së tij, dhe të barazisë në marrëdhëniet ndërkombëtare pavaresisht nga fuqia ekonomike dhe madhësia e territorit. Për ta bërë më konkrete analizën na duhet të shikojmë qëndrimin e marrëdhënies ndërkombëtare në konfliktet dhe acarimet që mund të kenë ndodhur midis shteteve dhe popujve të ndryshëm.

Gjatë periudhës 1990-1995 marrëdhëniet ndërkombëtare janë ndeshur me disa probleme dhe konflikte të rëndësishme që kanë kërkuar ndërhyrjen e tyre për t'i zgjidhur. Në këto probleme dhe konflikte, është përzier e drejta dhe forca bashkë, prandaj është dashur përgjigjja e organizmave ndërkombëtare se kush ka të drejtën me vete dhe kush ka forcën me anë të cilës kërkon që padrejtësinë ta paraqesë si drejtësi. Le të qëndrojmë brenda Evropës. Gjatë kësaj periudhe Evropa u ndesh me konfliktin boshnjak, midis boshnjakëve, serbëve dhe kroatëve, me konfliktin e pashpallur serbo-shqiptar, me konfliktin ruso-çeqen dhe konfliktin turko-kurd. Në të katër këto konflikte kemi një tablo të tillë. Çeqenët kërkojnë të jenë të pavarur nga Rusia, por Rusia nuk ua jep këtë të drejtë. Boshnjakët kërkonin të ishin shtet i pavarur pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe kjo është një e drejtë e tyre qënësore. Shqiptarët në ish-Jugosllavi kërkojnë të jenë të pavarur nga serbët dhe kjo është një e drejtë e tyre. Kurdët janë një popull prej 24 milionësh dhe kërkojnë të jenë të pavarur, dhe kjo është një e drejtë e tyre.

Këto të drejta të këtyre kombeve janë pranuar dhe nga dokumentet e organizmave të ndryshme ndërkombëtare. Ashtu siç janë pranuar në takime dypalëshe dhe shumë palëshe dhe nga shumica e shteteve të fuqishëm të botës. Kombet e mësipërme, megjithese kanë të drejtë, nuk e kanë realizuar akoma atë sepse u mungon forca. Forca ka qenë tek padrejtësia. Prandaj në mënyrë të natyrshme, ata kanë kërkuar ndihmën dhe përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, duke shpresuar dhe qenë të bindur se periudha e tanishme është cilësisht e re nga ajo e para si dhe duke qenë të bindur se ka qënë ideologjia dhe sistemi

komunist që nuk i ka lënë të realizojnë të drejtën e tyre. Për ilustrim le të kujtojmë se shumë intelektuale dhe politikanë shqiptarë në Kosovë gjatë viteve 1989-1990, bënë presion mbi qeverinë e Shqipërisë, për të ndryshuar sistemin. Sipas tyre kishte qënë komunizmi si ideologji dhe sistem, shkak kryesor i ndarjes dhe coptimit të kombit shqiptar. Prandaj për pasojë me ndryshimin e regjimit në Shqipëri, do të realizohej endërra e shqiptarëve për bashkimin kombëtar. Në çfarë mënyre bashkësia ndërkombëtare i ndihmoi këto kombe të fitonin të drejtën e tyre të ligjshme, cili ishte qëndrimi i saj ndaj të drejtës së këtyre vendeve dhe ndaj forcës së vendeve të tjera. Kush fitoi në konfliktet e periudhës 1990-1995, e drejta apo forca?

Në Bosnjë të gjithë e dinë se fitoi forca, bile një forcë e egër e denjë për t'u barazuar me egërsinë hitleriane. Po kështu në Kosovë përsëri fitoi forca. Faktori ndërkombëtar, të drejtën e shqiptarëve për pavaresi e reduktoi në të drejta dhe liri njerëzore, brenda kufijve të ish-Jugosllavisë. Dëshirës dhe të drejtës së ligjshme të shqiptarëve për të qënë të pavarur, iu kundërvu stabiliteti i Ballkanit dhe hapësirat demokratike. Në Çeçeni përsëri fitoi forca e tankeve ruse përballë të drejtës së popullit çeçen për të qënë i pavarur. Në Kurdistan përsëri fitoi forca e ushtrisë dhe dhunës turke përballë të drejtës së popullit kurd për të qënë i pavarur. Në mënyrë të përmbledhur ky është konkluzioni i përfundimit të këtyre konflikteve në marredhëniet e sotme ndërkombëtare. Në arritjen e këtij konkluzioni, faktori ndërkombëtar dhe organizmat e tij të shumta, patën rolin kryesor. Përballë të drejtës dhe në raport me të fitoi përsëri forca.

Është kjo arsyeja që popujt, të cilët kishin shpresuar se me përmbysjen e komunizmit dhe me vendosjen e demokracisë, do të fitonte e drejta e tyre, janë më të zhgënjyer se më përpara. Ata deri tani i kanë provuar të gjitha, provuan dhe mardhëniet demokratike, por përsëri asgjë. Prandaj atyre tani u ka mbetur një gjë, ngushëllimi. Këta popuj ka patur parasysh Sartori kur shkruante se demokracia të zhgënjën, por nuk të tradhton (Sartori, Mbi teorinë e demokracisë, faqe...)

Megjithatë, në praktikën e marredhënieve të sotme ndërkombëtare, ky

konkluzion nuk shfaqet hapur. Në të kundërtën. Ai është mbuluar dhe justifikuar me domosdonë e forcimit të marrëdhënieve demokratike dhe konsensusit evropian dhe botëror. Mohimi i së drejtës së këtyre kombeve nuk paraqitet si refleks i forcës por si sakrificë e konsolidimit të demokracisë.

Në çështjen boshnjake, si tragjedia, ashtu dhe përfundimi i arritur, u justifikua me nevojën e gjetjes së konsensusit midis fuqive të mëdha. Duke qënë aleat i rusëve, Francës dhe Anglisë, Serbia arriti të realizojë pas një masakre të përgjakshme, krijimin e republikës së sërbeve të Bosnjës. Në çështjen shqiptare, mohimi i të drejtës së tyre u justifikua dhe po justifikohet që për hir të paqes në Ballkan dhe në Evropë, për të mos filluar një luftë me përmasa evropiane, shqiptarët duhet të heqin dorë nga kërkesat maksimaliste. (Megjithese republika e Kosovës është një kërkesë minimaliste e shqiptareve). Pra, në çështjen shqiptare forca e të madhit frikëson dhe bën kurban të interesave të saj të drejtën e të voglit. Në çështjen e popullit çeçen, heshtja dhe mosveprimi i faktorit ndërkombëtar u justifikua me nevojën e mosacarimit të marrëdhënieve me Rusinë, që është akoma një superfuqi e madhe ushtarake. Ndërsa në çështjen kurde, mohimi i të drejtës u justifikua me nevojën e interesave strategjike të bllokut perëndimor, për të ruajtur marrëdhënie të mira me Turqinë, e cila është një ndër aleatet më të ngushtë të tyre në Lindjen e Mesme.

Në ndihmë të këtij justifikimi teorik ka vepruar dhe propaganda televizive dhe gazetareske, apo ajo e organizatave ndërkombëtare. Shumë komente dhe artikuj gazetareskë e televizivë, me dhjetëra rezoluta dhe deklarata të organizmave ndërkombëtare dhe politikanëve të ndryshëm, kanë marrë në mbrojtje të drejtat e këtyre popujve dhe kanë dënuar forcën. Por vetëm në teori, në praktikë forca ka fituar, megjithese është mbuluar nga justifikimi demokratik. Është interesante të theksojmë se spekulime dhe justifikime të tilla të mohimit të së drejtës dhe përdorimit të forcës, në marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare nuk janë të reja, në thelbin e tyre. Dhe në periudhën e luftës së ftohtë, gjithmonë përdorimi i forcës mbi të drejtën,



justifikohej dhe mbulohej me lloj-lloj pretekstesh dhe arsyesimesh. Le të kujtojmë se pushtimi i Çekoslovakisë nga ushtria sovjetike dhe aleatet e saj u justifikua për hir të zbatimit të teorisë së sovranitetit të kufizuar të shpikur nga Brezhnjevi. Apo ndërhyrja e ambasadës amerikane në grushtshtetin e Kilit, u justifikua me arsyetimin e mospërhapjes së ndikimit komunist në Amerikën Latine. Ish-drejtori i CIA-s amerikane Rixhard Helms e pohon qartë këtë ndërhyrje. Ja pohimi i tij:

"Qe presidenti Nikson ai që donte të rrëzonte zotin Aljende, jo CIA. Ajo nuk ka funksion hartimin e politikës. Gjithcka që kreu CIA u drejtua dhe u mbështet nga qeveria e Shteteve të Bashkuara"( Gabriel Partos, Bota që erdhi prej të ftohtit, faqe 197)

Duhet thënë se vepime të tilla janë konsideruar nga politologë dhe mendimtarë të ndryshëm si veprime totalitare në marredhëniet ndërkombëtare. Por neqoftëse kjo është e vërtetë për ngjarje të djeshme, duhet të jetë e tillë dhe sot. Thelbi është i njëjtë si sot ashtu dhe dje. Forca fiton dhe mposht të drejtën. Ndryshojnë vetëm justifikimet teorike. Dje, për të ruajtur unitetin e kampit socialist apo për të penguar përhapjen e ndikimit komunist, ndërsa sot për hir të interesave jetike dhe strategjike, për të ruajtur paqen e për të konsoliduar demokracinë dhe rendin e ri botëror. Dje u shpik sovraniteti i kufizuar, sot po shpiken hapesirat demokratike.

Tabloja e sotme e marredhënieve ndërkombëtare me konfliktet dhe zgjidhjet e tyre, me gjithë justifikimet që jepen, vërteton plotësisht pohimin filozofit spanjoll, Miguel del Unamuno, në përgjigjen që i dha gjeneralit frankist Milan Astraj, duke i thënë: "Ju do të fitoni se keni me vete forcën brutale. Mirepo nuk do të bindni askënd. për këtë duhet të keni atë që ju mungon, arsyen dhe të drejtën, që nuk janë në anën tuaj"(Cituar nga Agim Vinca, Populli i Pandalur, faqe 217). Maks Weber, i cituar nga Aron, pohon se "historia nuk evoluon drejt një qëllimi final ,që do të jetë pajtimi i njerëzimit, por u bindet cikleve të vartësisë së dyanshme" (Aron, Etapat e mendimit sociologjik, faqe 595)

Veprimin e forcës mbi të drejtën edhe sot e pranojnë shumë shtete dhe popuj të ndryshëm. Në mënyrë të veçantë disa nga popujt e vendeve ish-socialiste. Tek këta popuj dhe klasat e tyre politike, ka një përpjekje të ethëshme dhe të vazhdueshme për tu lidhur me këtë apo atë fuqi të madhe evropiane dhe botërore. Njerezit dhe sot nuk besojnë se e drejta mund të realizohet dhe materializohet pa ndihmën e forcës. Duke mos e pasur vetë këtë forcë njeriu gjithmonë është i prirur ta kërkojë atë jashtë. Sa herë që në organizmat e ndryshme ndërkombëtare diskutohen probleme të rëndësishme politike apo ekonomike, njerëzit, nuk thonë: "të presim se çfarë do të thotë OKB-ja, apo OSBE-ja", por "çfarë do të thotë Amerika, Gjermania, Rusia apo Franca". Pra, çfarë do të thotë forca e më të madhit dhe më të fuqishmit për të drejtën e këtij apo atij populli dhe jo çfarë do të thotë ky apo ai organizëm demokratik. Kjo është një psikologji që nuk mund të zhduket me parulla dhe me propagandë. Në mbështetje të saj janë zgjidhjet që jepen në marrëdhëniet ndërkombëtare, për konflikte të ndryshme që lindin.

## **Pse është i domosdoshëm totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare**

Analiza e deritanishme e ngjarjeve dhe dukurive të ndryshme në gjirin e marrëdhënieve ndërkombëtare, veçanërisht në raportin midis të drejtës dhe forcës, na lejojnë të përfundojmë se në periudhën pas viteve 90-të, për këtë çështje kaq të rëndësishme ka pak ndryshim me praktikën e periudhës së luftës së ftohtë, me periudhën e ekzistencës së dy sistemeve apo të dy blloqeve. Së këndejmi kemi të drejtë të pohojmë se nuk ka qenë komunizmi shkak kryesor i totalitarizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Teoria e NJESHIT, e predikuar nga mendimtarë të ndryshëm si një ndër tiparet themelore të totalitarizmit në vendet ish-socialiste, vazhdon të ekzistojë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe pas përmbysjes së komunizmit. Siç duket ajo është një domosdoshmëri për ruajtjen e rregullit dhe harmonisë në

marrëdhëniet ndërkombëtare sot, por dhe për shumë kohë në të ardhmen. A është i drejtë ky pohim. A mund të flitet për domosdoshmerinë e ekzistencës së një tipari themelor të totalitarizmit në kushtet e marrëdhënieve të reja demokratike. Siç duket duhet dhe mund të flitet. Janë disa arsye shumë të thella që e bëjnë të domosdoshme një gjë të tillë. Le t'i analizojmë ato më konkretisht. Së pari: Përmbysja e socializmit u shoqërua me lindjen e elementëve të rinj jo vetëm brenda vendeve ish-socialiste, por më shumë në arenën ndërkombëtare. Shumë fenomene që deri dje justifikoheshin me pamundësinë e zgjidhjes për shkak të komunizmit, tani dolën fare hapur. Demokracia, aq sa kultivon lirinë e mendimit dhe të shprehjes, aq sa krijon marrëdhënie të reja midis njerëzve, po aq krijon dhe marrëdhënie të reja dhe midis shteteve. Por në këtë çështje fuqitë perëndimore duke kërkuar demokratizimin e marrëdhënieve brenda shteteve ish-socialiste, harruan që këtë kërkesë t'ia kërkojnë dhe vetes së tyre për demokratizim e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ashtu si dje, edhe sot, organizmat ndërkombëtare, kanë vetëm çelesat e kashtës në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme ndërkombëtare. Së dyti: Demokracia i hapi gojët e shteteve dhe popujve të ndryshëm. Ajo kërkon në praktikë parimin e barazisë dhe partneritetit, pavaresisht nga forca ekonomike dhe ushtarake. Në këtë çështje fuqitë e mëdha të botës dhe Evropës, gjatë periudhës 1990-1995, treguan se akoma nuk janë përparuar për një ndryshim të madh. Deri në vitin 1989, me propagandën e tyre, vendet e Evropës Perëndimore u thoshnin vendeve ish-socialiste se në kampin e tyre socialist ekziston shtypja nacionale dhe pabarazia ekonomike dhe ushtarake, ekziston ndarja ndërkombëtare e punës, që nuk lejon barazinë reale të shteteve. Por kaluan 5 vjet nga kjo propagandë. Socializmi u përmbys, në vendet e Evropës qëndrore dhe lindore erdhën në fuqi forca jokomuniste, bile dhe partitë ish-komuniste u shndërruan në parti social-demokrate të ngjashme me ato të Perëndimit. Ironia është se benda harkut të pesë vjetëve që janë konvertuar në shtete kapitaliste, këto vende po shikojnë dhe vërejnë me hidhërim se dhe në gjirin e sistemit kapitalist

ekzistojnë përgjithësisht po të njëjtat rregulla. Në një formë më të zbutur, natyrisht, po megjithatë ekzistojnë. Kjo shpjegohet sepse akoma fuqitë e mëdha të Perëndimit, vazhdojnë të vuajnë nga sfera e zonave të influencës dhe të ndikimit politik dhe ekonomik.

Shtetet ish-socialiste kaluan në sistemin kapitalist, po ky kalim nuk është i njëjtë dhe i barabartë për të gjithë. Shtëpia e përbashkët që predikonte Gorbaçovi nuk ishte gjë tjetër veçse shtëpia e kësaj apo asaj fuqie të madhe perëndimore. Nëqoftëse deri dje ato kishin qenë nën influencën sovjetike, sot ka ndryshuar vetëm sfera e influencës, por jo influenca. Sot mund të flitet për influencë gjermane, amerikane, franceze, ruse etj, por më pak për partneritet dhe barazi reale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kriza ballkanike e vërtetoi qartë një gjë të tillë. Gjermania mbështeti dhe përkrahu Slloveninë dhe Kroacinë për të fituar pavaresinë. Franca, Anglia dhe Rusia, mbështetën dhe përkrahën Serbinë dhe Malin e Zi. Mbi këtë bazë fuqitë e mëdha nuk i presin mirë kërkesat dhe praktikat e popujve dhe vendeve të vegjël që kërkojnë barazi reale në emër të demokracisë. Franca, në mënyrë të vendosur, hodhi poshtë kandidaturën e ministrit të jashtëm danez për sekretar të përgjithshëm të NATO-s, për faktin se Danimarka kishte votuar pro një rezolute që dënonte vazhdimin e provave bërthamore.

Së treti: Megjithëse aktualisht sistemi është i ndryshëm nga më parë, megjithëse zyrtarisht ekziston vetëm një sistem, ai kapitalist, dhe shumë gjëra kanë ndryshuar në raportet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, përsëri mentaliteti në psikologjinë e njerëzve, klasave politike dhe shteteve të ndryshëm, ka mbetur në një masë të konsiderueshme po ai i pari. Qoftë në shtetet klasike kapitaliste, qoftë në shtetet që po ndërtojnë kapitalizmin, për 50 vjet me anë të një propagande shumë të fuqishme ishte rrënjësuar mentaliteti i armiqësisë, ftohtësisë dhe përbuzjes ndaj njeri-tjetrit. Konfrontimet, acarimet, lumi i librave dhe mijërat e artikujve dhe emisioneve të ndërsjellta kundër njëri-tjetrit, përbënin thelbin e psikologjisë së njerëzve në të dy blloqet. Ndryshimet në psikologji dhe mentalitet, nuk bëhen aq shpejt sa ndryshimet e qeverive, partive apo të ministrave etj. Ato duan kohë

të rinovohen. Shpejtësia apo ngadalësia e tyre, varet nga predispozicioni dhe vendosmëria e organizmave ndërkombëtare për të zgjidhur me drejtësi problemet dhe konfliktet që lindin në marrëdhëniet ndërshtetërore. Kur shqiptarët, që prisnin se me përmbysjen e komunizmit ata do të unifikoheshin si komb, shikojnë se tani në çështjen kombëtare janë me keq se më përpara, ata me të drejtë do të vazhdojnë të ruajnë mentalitetin e vjetër ndaj fuqive të mëdha. Është pikërisht reminishenca e mentalitetit të vjetër që vazhdon të peshojë dhe sot mbi klasat politike të vendeve të ndryshme, një nder shkaqet kryesore të krijimit të ftohtësive në marrëdhëniet ndërkombëtare, apo të mosbesimit ndaj njeri-tjetrit.

Së katërti: Rigjallërimi i nacionalizmave të ndryshme në mjaft vende dhe shtete, ka marrë një hov të madh në periudhën 1990-1995. Aq i madh dhe i përhapur është ky problem sa që është bërë e vështirë të dallosh në shumë raste se ku qendron atdhetarizmi dhe ku shovinizmi, ku padrejtësia historike dhe ku falsifikimi historik. Duke e parë me shqetësim këtë dukuri, Lëfor pohon me të drejtë se "kohën e totalitarizmit e zëvendëson koha e copëzimit. Natyrisht synimet kah pavaresia kur u takojnë kombeve të nënshtruara një fuqie të huaj, janë legjitime dhe mund të lidhen me aspirata demokratike. Përkundrazi, është vdekjeprurës nacionalizmi që shoqërohet me ksenofobi dhe me racizëm e aq më keq kur është në shërbim të një ekspansioni, qoftë të shtypjes, qoftë të zhdukjes së pakicave" (Lëfor: Demokracia dhe totalitarizmi, botim shqip, 1993, faqe 26) Kur këto nacionalizma në mënyrë të hapur apo të fshehur kanë dhe përkrahjen e klasave politike që janë në pushtet apo të fuqive të mëdha evropiane, atëherë ato e ndërlikojnë shumë atmosferën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet midis shteteve të ndryshme. Fshehur pas demokracisë ky nacionalizëm që është sa lindor aq dhe perëndimor, predikon vetëm forcën kundër dialogut dhe të drejtës.

Së pesti: Në të kaluarën roli i organizmave të ndryshme ndërkombëtare ka qenë plotësisht formal. Ato nuk kanë qenë asgjë tjetër veçse mbulesa ku ligjin e bënin më të mëdhenjtë. Pas viteve '90-të,

organizmat ndërkombëtarë janë shtuar në sasi, por ato kanë mbetur po ato që kanë qenë në cilësi. Dhe sot ato në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme ndërkombëtare nuk kanë gjë tjetër veçse çelesat e kashtës. Pafuqia dhe formaliteti i tyre sot përballë atmosferës demokratike që predikohet përbën një kontradiktë që ka nevojë për shumë kohë të kapërcehet. Kalimi i fuqisë nga disa shtete të fuqishme siç ka qenë deri dje në duart e organizmave ndërkombëtare nuk është vetëm një problem organizativ. Në radhë të parë ai është koncepti i mprehtë politik dhe psikologjik.

Dukuritë dhe fenomenet e mësipërme vështirë se mund të kapërcehen me mjete demokratike dhe dialog, me konsensus dhe barazi shtetesh dhe kombesh, veçanërisht kur është fjala midis shteteve të mëdha dhe të vogla, shteteve të zhvilluara dhe atyre të pazhvilluara, apo kur është fjala për probleme që çenojnë interesat e fuqve të mëdha apo të sferave dhe zonave të tyre të influencës.

## **Përse Amerika është NJESHI i marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare?**

*Kjo robëri e rregulluar, e butë dhe e qetë, tablonë e së cilës sapo e bëra, do të mund të kombinohej më mirë se çmund të merrej me mend me disa nga format e jashtme të lirisë dhe s'do ta kishte të pamundur të vendoset në vetë hijen e vullnetit të popullit  
Tukëvil, Demokracia në Amerikë, vëll. 2, faqe 325)*

Dukuritë dhe fenomenet e ndodhura gjatë këtyre 5 vjetëve në zona të ndryshme të botës dhe Evropës provuan se mjetet demokratike janë të pafuqishme t'i përballojnë dhe zgjidhin këto konflikte në mënyrë përafërsisht të drejtë. Në të gjitha këto raste në mënyrë të natyrshme është e nevojshme autoriteti dhe detyrimi jo demokratik, por i domosdoshëm i NJESHIT. Ky rol në momentet ne te cilat ndodhen sot marrëdhëniet ndërshtetërore dhe problematika midis tyre, është i

ngjashëm me rolin e prokurorit që merr vendimin duke i detyruar të gjithë palët në konflikt të binden. Kur nuk binden me anë të dialogut vihet në veprim forca. Pra, roli i NJESHIT, në kushtet e sotme, nuk është një dëshirë subjektive, atë teorikisht mund ta emërtosh si të duash, mund ta quash autoritarizëm, totalitarizëm etj. Në ekuilibrin e marrëdhënieve ndërkombëtare këto nuk kanë fare rëndësi. Rëndësi ka se ky rol është i domosdoshëm dhe do të jetë i tillë për aq kohë sa do të ekzistojnë konfliktet, zonat e influencës, nacionalizmi, përderisa sa organizmat ndërkombëtare nuk do të jenë më si deri më sot vend rezolutash dhe fjalësh, pa asnjë mjet detyrimi. Mbi këtë bazë NJESHI, si rregullator i marrëdhënieve ndërkombëtare, është e natyrshme që duhet të ketë më shumë forcë për të realizuar bindjen ndaj vendimeve të tij.

Nga të gjitha këto që thamë, këtë rol sot në marrëdhëniet ndërkombëtare ka filluar ta luajë Amerika. Kjo nuk është rastësi. Janë disa faktorë që ja kanë dhënë Amerikës këtë rol në marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare.

Së pari: Fuqia ekonomike teknologjike, shkencore dhe ushtarake, e kanë shndërruar sot Amerikën në superfuqinë e vetme në botë.

Deri në vitin 1990 në botë ekzistonin dy shtete, të cilët, përkatësisht, në kampet që bënin pjesë, ishin në kuptimin figurativ NJESHI i tyre.

Këto ishin Amerika dhe Bashkimi Sovjetik. Me përmbysjen e socializmit jo vetëm që u shpërbë kampi socialist, por u shpërbë dhe Bashkimi Sovjetik, nga gjiri i të cilit dolën shumë shtete, më i fuqishmi prej të cilave mbeti Rusia. Edhe sot Rusia në fushën ushtarake është një superfuqi, por është e dobët ekonomikisht dhe po kalon vështirësi të mëdha të stabilizimit politik dhe shoqëror.

Ekzistenca e dhjetëra partive politike në Rusi pasqyron në mënyrë të qartë këtë mungesë të stabilizimit të saj politik dhe shoqëror. Mbi këtë bazë Amerika mbeti vetëm si superfuqi botërore.

Së dyti: Amerika është një komb dhe shtet i ri në krahasim me shtetet e tjera të Evropës. Ajo u krijua si e tillë nga vetë evropianët me emigrimet e tyre gjatë shekujve të fundit. Për më tepër, ajo u krijua jo

nga një komb i vetëm, por nga disa kombe evropiane, të cilat, me vajtjen në Amerikë, u transformuan në amerikanë.

Së treti: Në ndryshim nga shumë vende dhe shtete të ndryshme të evropës, qofshin dhe të fuqishme, si Franca, Gjermania, Anglia, Italia, Japonia, apo Kina, Amerika, si gjeografikisht, ashtu dhe historikisht, është më e privilegjuar. Për çfarë arsye? Amerika nuk kufizohet nga vende dhe shtete që kanë qenë apo janë armiq të saj, nga vende që kanë qenë apo janë në konflikt me të. Të dy vendet që kufizohen me të, Kanadaja dhe Meksika, jo vetëm që janë më të pazhvilluara nga ajo, por kanë interes të mbajnë marrëdhënie të mira me të. Është një pozicion i privilegjuar i saj në raport me të tjerët. Kina ka pasur me shumicë probleme me Japoninë, ka bërë dhe luftë me të në të kaluarën. Japonia ka arritur ta pushtojë Kinën më 1934-ën. Nga ana tjetër, Japonia ka pasur dhe ka fërkime me Rusinë. Ne mes te sherrit është jo vetëm kujtimi i luftës ruso-japoneze të vitit 1904, por akoma dhe sot ekziston çështja e ishujve Kurile. Po kështu, Kina ka pasur probleme dhe fërkime të mprehta me Bashkimin Sovjetik, veçanërisht për probleme territoriale, duke arritur në vitet '60-të dhe në konflikt të armatosur midis tyre. Në të njëjtën mënyrë Gjermania ka patur shumë probleme me Francën, apo Franca me Gjermaninë, deri në konflikte të armatosura. Çështja e Alsas-Lorenës për dekada të tëra ka qenë pika kryesore e konfliktit midis tyre. Po kështu, Gjermania, nga ana e saj, ka qenë për shumë kohë në armiqësi me Rusinë, të paktën qysh nga lufta e parë botërore.

Përmendëm vetëm disa probleme që kanë qenë burim konfliktesh midis fuqive të mëdha të botës. Të gjitha këto probleme të shteteve të fuqishme të Evropës dhe të Azisë në momente të caktuara janë thelluar aq shumë sa kanë çuar në konflikte të përgjakshme, siç ka qenë lufta e parë dhe lufta e dytë botërore. Në të kundërtën, Amerika nuk vuan nga plagë të tilla. Për më tepër që përreth saj ka sunduar një paqe e gjatë. Prandaj historikisht dhe gjeografikisht pozicioni i saj është i privilegjuar. Këtë dukuri e ka vënë re mirë Tukëvili, i cili, megjithëse francez, shkruan në librin e tij "Demokracia në Amerikë" se "pa fqinjë,



pra, pa armiq, shteti amerikan u ka shpëtuar vargonjve të diplomacisë dhe të luftës, ai ka konservuar frymën e pionierëve, në të njëjtën mënyrë si atë të te ardhurve të parë, të puritanëve. Popujt ndiejnë gjithmonë origjinën e tyre. Rrethanat që kanë shoqëruar lindjen dhe që i kanë shërbyer zhvillimit të tyre, influencojnë mbi gjithë karrierën e tyre" (Tukëvil, Cituar nga Aron, në Etapat e sociologjisë moderne, faqe 635)

Veçoritë e mësipërme i kanë dhënë Amerikës privilegjin mbi shtetet e tjera të fuqishme. Në vitet e pas përmbyesjes së socializmit Amerika në disa raste ka treguar se e ka marrë përsipër rolin e rregullatorit të marredhënieve ndërkombëtare, pra, rolin e NJESHIT. Le të përmendim disa prej tyre.

Kriza izraelito-palestineze-jordaneze dhe siriane po zgjidhet me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të saj.

Kriza në Irlandën e Veriut ka filluar të zgjidhet me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të saj.

Kriza në Haiti u zgjidh me ndërhyrjen ushtarake të saj.

Kriza në Bosnjë ka filluar të zgjidhet me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të saj politike dhe ushtarake.

Mjaftojnë këto dukuri në favor të tezës tonë mbi rolin përcaktues dhe detyrues të saj në marredhëniet ndërkombëtare dhe problemet që lindin në procesin e zhvillimit të këtyre marredhënieve. Këtë rol të Amerikës, si rregullator i marredhënieve ndërkombëtare, si NJESHI i këtyre marredhënieve, në pamjen e parë dhe në sipërfaqe të marredhënieve ndërshtetërore, duket se po e pranojnë të gjithë. Megjithatë, dukuria nuk ta jep të plotë realitetin, i cili në rastin konkret përbëhet prej dy anësh esenciale. E para janë shtetet dhe vendet e pazhvilluara të vogla, të cilët kanë akoma probleme qenësore të tyre për të zgjidhur, ekonomike, shoqërore dhe nacionale. Veçanërisht problemet nacionale këto shtete i kanë me shtete më të fuqishëm se ato, prandaj dhe kërkojnë mbështetje për t'i zgjidhur.

Tek këto vende dhe popuj, adhurimi ndaj Amerikës është shumë i madh. Dallohen shqiptarët në këtë drejtim. Faqet e shtypit shqiptar,

komentet dhe deklaratat e klasës politike shqiptare, janë të mbushura me një glorifikim të pashëbullt ndaj Amerikës. Presidentet, sekretarët e shtetit, senatorët dhe kongresistët amerikanë, janë ndër njerëzit më të njohur në hapsirën e kombit shqiptar. Në hapsirën e kombit shqiptar në ish-Jugosllavi, ky adhurim ka qenë dhe është i lidhur me shpresën se Amerika do t'i ndihmojë shqiptarët të shkëputen nga Serbia. Ndërsa tek pjesa e kombit shqiptar që jeton në Shqipëri, ky adhurim ka qenë i lidhur me shpresën se Amerika do t'i derdhë dollarët lumë për të rimëkëmbur Shqipërinë. Në mjaft raste, siç ka ndodhur me vizitën e Bejkerit në Shqipëri apo me vizitën e Dolit, Lantoshit, Dioguardit në Kosovë, ky adhurim ka kaluar deri në absurd. Me të drejtë Rexhep Qosja e ka konstatuar këtë dukuri. Ja sesi na e jep ai këtë psikologji ne një nga shkrimet e tij me nëntitull: Kush na e solli pavaresinë:

"Kur është zgjedhur Bill Klintoni kryetar i SHBA-ve, gëzimi ynë ishte i papërmbajtur. Ai është demokrat dhe ne jemi demokrat dhe demokraci bën çmos për demokracinë! Çështja e Kosovës do të bëhet çështje e dorës së parë në politikën e jashtme amerikane. Kosovës filloi t'i buzëqeshë pavaresia. Kryetari i deritanishëm amerikan e ka zbritur çështjen e Kosovës për disa shkallë në politikën amerikane. Në letrën e tij dërguar bashkëkryetarëve të komitetit për çështjen shqiptare, ai thotë shkoqur se megjithse nuk e përkrahin pavarsinë e Kosovës, SHBA-të, janë të vendosura për rikthimin e të drejtave njerëzore dhe politike të popullit të Kosovës. Ndryshe prej ish-kryetarit Xhorxh Bush, kryetari Klinton nuk e shqipton togfjalëshin autonomi e lartë. Domethënë: Shpresat tona ishin të kota. Kur kanë ardhur ushtarët amerikanë në Maqedoni, ne kemi thënë dhe kemi shkruar: kanë ardhur në radhë të parë për shkak tonin. Dhe vetëm për shkak tonin. Dëshira jonë vetëmashtruse ishte aq kokëfortë sa që disa njerëz nuk kanë ngurruar dhe mundësinë zhylvërniane të krijimit të Konfederatës së Kosovës me Maqedoninë". (Rexhep Qosja, Zëri i Kosovës, nr. 3, shkurt 1995).

Pa hyrë në konceptin e kozmopolitizmit, pasi atë do ta trajtojmë më

vete, duhet thënë se ky adhurim ka një bazë logjike. Shqiptarët janë kombi i vetëm i paunifikuar i Evropës dhe vendi më i varfër i saj. Duke njohur potencialin e Amerikës, ata shpresojnë në fuqinë e saj. Shtetet e fuqishme të Evropës ata i kanë provuar, duke e ditur se kanë qenë këto shtete shkaku kryesor i copetimit të tyre. Mosmarreveshjet e këtyre shteteve në ndarjen e zonave të influencës veçanërisht në Ballkan, gjithmonë janë sheshuar duke bërë kurban shqiptarët. Prandaj shpresat i kanë varur tek NJESHI i botës. Ata e dinë se organizmat ndërkombëtare, janë dhe sot formale. Ato janë sa për të mbushur dhe plotësuar dekorin demokratik të botës. Është tjetër çështje që Amerika, siç do ta shikojmë më poshtë, nuk mund të angazhohet në përkrahje të shqiptareve ashtu siç duan shqiptarët.

Nëqoftëse sot vendet e vogla dhe të pazhvilluara, e kërkojnë dhe pranojnë Amerikën në rolin e NJESHIT të marredhënieve ndërkombëtare, vendet e mëdha dhe të fuqishme që kanë potencialin dhe forcën e tyre, këtë e pranojnë me vështirësi. Ja një fakt i freskët. Në prag të nënshkrimit të paqes që do të bëhej në Paris, midis fuqive ndërluftuese në Bosnjë, lindi një problem i mprehtë diplomatik. Marrëveshja reale e paqes realisht u nënshkrua në Dejton, nën kërcënimin e përditshëm të amerikanëve. Parisi dhe Londra u zgjodhën për t'i dhënë kësaj ngjarje dekorin demokratik Megjithatë, francezët ngulën këmbë që Parisi të konsiderohej si vendi ku do nënshkruhej paqja. Siç duket, francezët interesohen me shume që paqja boshnjake të ngelet e lidhur me Parisin në historinë e së ardhmes, jo aq se si është realiteti i sotëm. Për të eliminuar konfliktin, për të mos prishur dekorin demokratik, u gjet një zgjidhje kompromisi.

Dukuri të tilla ka shumë në marredhëniet e sotme ndërkombëtare në raportet e Amerikës me shtetet e tjera të fuqishme të Evropës. Secila nga këto vende jo vetëm që kërkon të jetë i pavarur në marredhëniet ndërkombëtare nga NJESHI amerikan, por njëkohësisht punojnë dhe kërkojnë të jenë dhe vetë NJESHI; në mos në tërë botën, se atë nuk e arrijnë dot, të paktën në zona të caktuara të botës dhe të Evropës. Në këtë mënyrë veprojnë francezët, anglezët, gjermanët, rusët etj. Janë të

njohura përpjekjet e francezëve për të qenë NJESHI i botës së ashtuquajtur frankofone, jo vetëm në grumbullin e shteteve të Afrikës, që flasin frëngjisht, por dhe deri në Kanada, në zonën frankofone të Kebekut. Është i njohur fjalimi i De Golit në Kebek në vitin 1967 para popullit që përfundoi me fjalët: J'aime Que-beque, mais j'aime Que-bekue libre (Unë e dua Kebekun, por unë dua Kebekun e lirë).

Në zgjedhjet e para pluraliste në ish-vendet socialiste dolën fituese ish-partitë komuniste, të cilat kishin akoma në dorë një potencial të madh organizativ, propagandistik dhe material. Ishte kjo arsyeja që në shumicën e këtyre vendeve zgjedhjet u ribënë të parakohshme për të ardhur në fuqi partitë e opozitës. Ndaj vendeve socialiste të gjitha shtetet e fuqishme kapitaliste ishin unike në qendrim, me përjashtim të Francës në qendrimin ndaj Rumanisë. Pas përmbysjes së Çausheikut në Rumani erdhi në fuqi Fronti i Shpëtimit Kombëtar, i kryesuar nga Ion Iliesku, ish-sekretar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Rumune, por i shkarkuar nga Çausheiku. Megjithatë në Rumani, pavaresisht nga propaganda, ndryshuan pak gjëra dhe propaganda e mjaft partive të opozitës ishte e pakënaqur me zgjedhjet që ofroi Iliesku dhe qeveria e Petre Romanit për problemet e trashëguara, qendrimi i Francës ishte ndryshe. Ajo pak u interesua se kush ishte në pushtet. Më shumë i interesoi që Rumania u kthye përsëri në influencën e saj. Prandaj në ndihmë të Ilieskut të lëkundur nga sulmet e opozitës shkoi ish-presidenti i Francës Mitteran, për ta përkrahur dhe për t'i dhënë kurajo. Duke e njohur këtë rast në skenën dhe prapaskenën e tij, Fransua Fejto shkruan dhe konstaton në librin e tij: "Kështu, Rumania e re kishte një fytyrë të dyfishtë; një që lejonte opinionin publik përëndimor dhe në veçanti francez të kënaqej përpara "tokës frankofone" të vëllezërve latinë të rigjetur, dhe tjetra, që aplikonte ligjin e sëpatës e të thikës me ndoshta po aq ashpërsi dhe sigurisht më me hipokrizi se sa Çausheiku vetë" (Fejto, Fundi i demokracive popullore, faqe 326).

Të tilla përpjekje janë vënë dhe vazhdojnë të vihen re dhe në zona të tjera të Evropës, nga të tjera fuqi të mëdha kapitaliste. Pas përmbysjes

se socializmit, në vendet e Evropës qëndrore ka filluar të vihet re një dukuri e tillë. Në sferën e influencës mbi këto vende, rolin e Bashkimit Sovjetik ka filluar ta zërë Gjermania. Në këtë fushë nga Gjermania po shfrytëzohen disa specifika të këtyre vendeve. Nga njëra anë janë nevojat dhe kërkesat e këtyre vendeve për kredi dhe investime ekonomike, që të përshpejtojnë zhvillimin e tyre. Nga ana tjetër janë lidhjet dhe traditat historike. Disa prej tyre janë të traditës së vendeve teutone. Disa lidhje të tjera janë ato të shteteve që kanë dalë nga perandoria e Habsburgëve, e kryesuar nga Austria. Por aktualisht, Austria është e pafuqishme ta luajë rolin që ka pasur perandoria e saj para rreth 100 vjetësh. Për shkak të fuqisë së madhe ekonomike, teknologjike dhe ushtarake, këtë rol e ka marrë përsipër Gjermania. Vende të tilla si Çekia, Sllovakia, Hungaria, Lituania, Letonia, Estonia, gradualisht po hyjnë plotësisht nën influencën gjermane. Një predispozicion i tillë i këtyre vendeve dhe nevojat e tyre ekonomike dhe ushtarake duket se po i interesojnë shumë dhe Gjermanisë. Duke ndenjur për arsye të njohura të pas luftës së dytë botërore, rreth 50 vjet në periferinë e zhvillimeve dhe ndikimeve botërore, ajo duket se tani kërkon të kompensojë kohën e humbur dhe të dalë plotësisht në arenën evropiane dhe botërore me tërë peshën e potencialit të saj ekonomik dhe ushtarak.

Përsëritja shpesh e sloganit të njohur se politika e Gjermanisë nuk është për një Evropë gjermane, por për një Gjermani evropiane, duket se tregon në praktikë, të kundërtën e saj. Sinjifikative në këtë çështje është një dukuri e tillë. Në muajin tetor 1995 në Gjermani shkoi për vizitë kryeministri i Hungarisë Gjyly Horn, për të kërkuar mbështetjen gjermane me kredi dhe investime. Në përgjigje të kërkesës së Hornit, Hungarisë iu akorduan një miliard marka: 500 milione do të jepeshin nga buxheti federal dhe 500 milione të tjera nga buxheti i dy landeve. Dy muaj më pas në Gjermani shkoi për vizitë dhe një udhëheqës tjetër i një vendi ish-socialist, presidenti i Shqipërisë Sali Berisha, i cili gjithashtu kërkoi ndihmë financiare për vendin e tij, që realisht ka shumë më tepër nevojë se Hungaria. Por Berishës iu akorduan vetëm

64 milione marka. Ndërsa në dallim nga Horni iu rezervuan më shumë vizita në vende turistike dhe historike të Gjermanisë.

Ndryshimi është i qartë. Ai flet më shumë se propaganda. Qarqe nacionaliste në Rusi që kujtojnë vitet kur Bashkimi Sovjetik ishte të paktën NJESHI i Lindjes, kërkojnë që përsëri Rusia ta luajë këtë rol. Platforma e partisë ultranacionaliste të Zhirinovskit ka për qëllim pikërisht realizimin e një qellimi të tillë. Përpyetje të tilla të vendeve të mëdha dhe të fuqishme sot janë reale dhe duken hapur. Duke qenë të pamundura për të qenë NJESHI i botës, ato luftojnë të jenë se paku NJESHI i kësaj apo asaj zone të Evropës apo botës.

Në marrëdhëniet aktuale ndërkombëtare të periudhës së sotme midis fuqive të mëdha, vecanërisht atyre europiane, vihet re një preokupim dhe përpjekje për të spostuar Amerikën nga roli i NJESHIT të botës. Në pamundësi që ta realizojnë në mënyrë individuale një gjë të tillë, përpjekjet e tyre synojnë ta realizojnë këtë nëpërmjet NJESHIT kolektiv. Fryt i kësaj janë përpjekjet për bashkimin e Evropës, boshti i së cilës sot për sot është aleanca franko-gjermane dhe krijimi i Unionit Evropian, i cili ka filuar të dalë si partner i pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare. Deri tani në Unionin Evropian bëjnë pjesë 16-shtete, nga rreth 54 shtete që ka gjithësejt Evropa. Megjithatë përpjekjet në këtë drejtim janë të mëdha përsëri në rrugën drejt bashkimit të Evropës do të ketë probleme të shumta politike, ekonomike dhe nacionale, të cilat në kushte ideale, do të duan dekada të tëra për t'u realizuar. Deri atëhere, dhe vetë vendet e mëdha të Evropës do të jenë të detyruara, ta pranojnë kundër dëshirës së tyre rolin kryesor të Amerikës si rregullator i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Le të vimë tani tek një problem tjetër.

Nëqoftëse realiteti objektiv i marrëdhënieve ndërkombëtare ia ka dhënë këtë rol Amerikës, po vetë Amerika a është e përgatitur për një rol të tillë? Më thjesht:

Forca e Amerikës a mund të jetë shpresë për të drejtën e popujve?

Përgjigjja e kësaj pyetje do të ndriçojë jo vetëm realitetin e sotëm, por dhe perspektivën e të nesërme. Në mënyrë të natyrshme para viteve

'90-të psikologjia dhe mentaliteti i klasës politike amerikane ishte i drejtuar në thelb në ruajtjen dhe konsolidimin e asaj që ishte arritur dhe në përpjekjet për eliminimin e komunizmit, neutralizimin e Bashkimit Sovjetik si rivali kryesor i saj. Njëkohësisht, një numer vendesh që ndodheshin nën sferën e ndikimit socialist, ishin jashtë vëmendjes së Amerikës. Për më tepër dhe ndaj tyre qendrimi i saj ishte i ftohtë dhe në disa raste armiqësor. Periudha e pas viteve 90-të krijoi një situatë të re dhe për klasën politike amerikane. Duhet thënë që në terësi klasa politike amerikane nuk ka qënë dhe nuk është akoma e përgatitur psikologjikisht, politikisht dhe organizativisht, për ta përballuar rolin që ka në sferën e marrredhënieve ndërkombëtare. Kjo mungesë përgatitje, ka arsyet e saj objektive dhe subjektive, të cilat aktualisht përbëjnë një pengesë për Amerikën në luajtjen e rolit të NJESHIT në marrredhëniet ndërkombëtare.

Le t'i marrim me radhë këto pengesa:

Së pari: Qysh më përpara Amerika ka bërë dhe bën pjesë në disa organizma që deri dje quheshin të kampit kapitalist. Në këto organizma, ajo në mënyrë të natyrshme ka pasur një rol themelor. ka qënë në mënyrë figurative lidërshtipi i këtyre organizmave, ka ndërnuar dhe vazhdon të ndërtojë marrredhenie të shumellojshme me mjaft nga këto vende. Përfshirja e mjaft shteteve të tjer ish-socialiste në kampin kapitalist, krijoi një situatë të re. Nga njëra anë kërkohet që sa më parë këto shtete të ndërtonin strukturat kapitaliste, ndërsa nga ana tjetër ndihmat për këto shtete, ishin shumë të pakta. Teoria e amerikanëve në këtë çështje ka qënë dhe është: Amerika nuk u jep njerëzve peshk, por i mëson të zënë peshk. Nga ana tjetër, futja e shteteve të ndryshme ish-socialiste në kampin kapitalist ka krijuar probleme të shumta midis shteteve të ndryshme. Në të gjitha këto raste është kërkuar qendrimi i Amerikës në zgjidhjen e këtyre konflikteve. Duhet thënë se në raste të tilla, Amerika ka mbajtur qendrim jo të drejtë. Le të japim një shembull.

Midis Shqipërisë dhe Greqisë, në vitin 1994-1995, u krijuar një konflikt ndërshtetëror si pasojë e arrestimit nga ana e Shqipërisë e pesë

shtetasve shqiptarë me kombësi greke për kryerjen e krimit të spiunazhit. Ky konflikt që i kaloi përmasat midis dy shteteve me ndërhyrjen e Amerikës u zgjidh në favor të Greqisë. Arsyeja është e thjeshtë. Greqia është mike e vjetër e Amerikës, është antare e NATO-s. Konkluzioni është i qartë: Në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme që ndodhin sot në botë Amerika më shumë ka mbajtur dhe mban anën e shteteve që kanë qenë anetare të organizmave ku ka bërë dhe bën pjesë dhe Amerika.

Së dyti: Ekzistenca e lobeve të ndryshme në Amerikë dhe ndikimi i tyre në politikën amerikane. Është një fakt i njohur dhe i ditur nga të gjithë se kombi amerikan, është komb i ri, që është formuar në shumicën e tij nga evropianë të emigruar nga vende të ndryshme të Evropës. Me gjithë kohën e madhe që ka kaluar dhe nderrimin e gjeneratave, shumë prej tyre nuk e kanë harruar origjinën e vjetër kombëtare dhe kanë krijuar dhe lobe të ndryshme në Amerikë mbi bazën e këtyre origjinave kombëtare. Për nga vendi që zënë në administratën shtetërore dhe në fushën e pasurisë, varet dhe ndikimi i këtyre lobeve në politikën e jashtme të Amerikës, në raport me shtete dhe vende të ndryshëm dhe konfliktet midis tyre. Ndër më të fuqishmet nga këto lobe janë lobi hebraik, grek, irlandez, serb etj. Jo vetëm përvoja e kaluar, por dhe përvoja e periudhës 1990-1995, dëshmon se ndikimi i këtyre lobeve është i fuqishëm në qendrimin e politikës së jashtme amerikane.

Disa dukuri të kësaj periudhe na e bëjnë më konkret dhe të dukshëm pohimin e mësipërm. Hapat e ndërmara nga qeveria amerikane, në fillimin e procesit të paqes në Irlandën e Veriut, për zgjidhjen e konfliktit 16-vjeçar dhe pranimin e krahut politik të IRA-s irlandeze në bisedimet për paqe si të barabartë me palët e tjera, veç të tjerave është dhe ndikimi i fuqishëm i lobit irlandez në politikën e jashtme amerikane. Ndërhyrja e departamentit amerikan të shtetit pranë qeverisë shqiptare për lirimin nga burgu të pesë spiunëve grekë veç të tjerash është dhe ndikimi i lobit të fuqishëm grek në politikën e jashtme të Amerikës. Në marrëdhëniet dhe konfliktin Greqi-Shqipëri,



shefi i Shtëpisë së Bardhë, amerikani me origjinë greke Xhorxh Stefanopullos dhe lobi greko-amerikan i fuqishëm, natyrisht që do të mbështeste politikën e Greqisë, duke ndikuar dhe në administratën amerikane.

Në vitet e para të krizës ballkanike Amerika mbështeti Serbinë, me gjithse Serbia hapur luftonte për krijimin e Serbisë së madhe. Në këtë mbështetje kishte influencën e tij dhe lobi serb në Amerikë. Serbo-amerikani, Milan Paniç, që u bë për disa kohë kryeministër i Jugosllavisë ishte një nga njerezit me të pasur në Kaliforni dhe pjesetar i lobit serb në Amerikë.

Së treti: Politika pragmatiste boshti i politikës së jashtme amerikane. Filozofia e pragmatizmit jo vetëm që ka lindur në Amerikë, por ajo ka gjetur aplikimin e saj më të saktë dhe më të plotë në politikën e jashtme amerikane. Pragmatizmi përbën sot një nga tiparet më themelore të politikës së jashtme amerikane. Me gjithë mbulesat që kërkojnë t'i vishen, ky pragmatizëm është përsëri shumë i dukshëm. Ai komprometon rëndë rolin e Amerikës si NJESHI i botës në mosmarreveshjet dhe konfliktet e ndryshme që kanë shtetet me njeri-tjetrin. Zbërthyer në nje gjuhë te thjeshtë dhe të kuptueshme ky pragmatizëm do të thotë: Unë ndërhyj dhe përkrah atje ku kam interes të drejtpërdrejtë, atje ku interes lidhet me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të Amerikës. Le të japim disa shembuj.

Në fillimin e viteve '80-të filloi lufta midis Iranit dhe Irakut. Amerika në këtë luftë mbështeti fuqimisht Irakun me armatime dhe logjistikë. Kjo ishte rrjedhim i pragmatizmit të politikës amerikane. Irani pas përmbysjes së shahut filloi të ndiqte një politikë të pavaresisë nacionale duke u përpjekur që këtë politikë ta infiltronte dhe në shtetet e tjera arabe, të cilat dihen që janë eksportuesit kryesorë të naftës. Frika nga revolucioni islamik iranian, që nuk është gjë tjetër veçse një nacionalizëm i kulluar arab, e detyroi Amerikën të mbështesë Irakun. Ndërsa pas 10 vjetësh, kur Iraku sulmoi dhe pushtoi Kuvaitin, ishte përsëri Amerika që sulmoi Irakun dhe e detyroi atë ta lëshojë Kuvaitin. Arsyeja përsëri qendron tek pragmatizmi dhe interesat jetike të

Amerikës.

Le të vimë në Ballkan. E thamë më lart se në fillim qëndrimi i Amerikës ishte prosërb. Pas njohjes që i bëri Kroacisë dhe Sllovenisë, Gjermania u ndodh nën sulmet e Amerikës dhe Francës. Grigori Peroshe, në librin e tij "Historia e Kroacisë dhe kombeve të tjerë sllavë të jugut", thotë se "kur Gjermania vendosi të njohë Kroacinë dhe Slloveninë, kundër mendimit të Francës dhe Amerikës, mori mbi vete insinuatat e këtyre dy fuqive të mëdha, nën pretekstin se ajo, Gjermania, kërkon të imponojë serishmi hegjemoninë e saj në Evropë". Ndërsa pas viteve 1993 filloi të dukej një ndryshim në qëndrimin e saj. Duke mos i hedhur poshtë serbët, Amerika filloi të përkrahte dhe ekzistencën e shtetit boshnjak. Përsëri në këtë qëndrim të ri kryesor ka qenë dhe është pragmatizmi dhe interesat jetike të Amerikës.

Dihet se në mbështetje të boshnjakëve dolën shumë shtete muslimane, shumica e të cilave janë aleate të Amerikës, të cilat filluan të bëjnë presion mbi Amerikën. Ndër shtetet që përkahën Bosnjën ishte dhe armiku kryesor i Amerikës në botën arabe, Irani, ashtu siç ishte dhe aleati i saj më i ngushtë, Turqia. Ministri i jashtëm iranian Ali Akbar Velajeti, në vizitën që bëri në Bosnjë, gjatë takimit me Izetbegoviçin, i premtoi atij një ndihmë të gjithanshme. Pikërisht në këtë moment pragmatizmi amerikan u shfaq në formën e tij më të plotë. Pa keqësuar marrëdhëniet me Serbinë, Washingtoni përkrahu ekzistencën e shtetit boshnjak, në formën e federatës kroato-boshnjake, duke ndërhyre me forcë dhe me politikë për t'i dhënë fund tragjedisë boshnjake. Perosh e sqaron mirë edhe këtë moment kur thotë se "ky demarsh i Amerikës mund të shpjegohet me miqësinë me Turqinë, që mbron pavaresinë e Bosnjës e Maqedonisë (kundër Greqisë) dhe që është në gjendje të bëhet një fuqi politike në Azinë qendrore, si dhe, duke pasur mbështetjen e SHBA-ve, të kundërshtojë influencën e Iranit në republikat islamike të ish-BRSS-së" (Perosh, po aty, faqe 486). Së katërti: Interesat jetike të Amerikës dhe marrëdhëniet demokratike në politikën ndërkombëtare. Politika e jashtme amerikane, si në të

gjitha kohët, por dhe tani, para së gjithash, ka mbajtur dhe mban parasysh interesat e vetë Amerikës, të popullit amerikan dhe sigurisë amerikane. Në funksion të kësaj strategjie janë dhe të gjitha hapat e tjerë politikë dhe diplomatikë të saj, mardhëniet me shtete të ndryshme dhe qëndrimi ndaj mosmarrëveshjeve të ndryshme apo konflikteve që ndodhin në botë dhe Evropë. Kjo lidhet me ato që quhen interesa jetike të Amerikës. Përvoja e ish-vendeve socialiste e periudhës së viteve 1990-1995 është konfirmimi i tezës së mësipërme. Interesat e këtyre shteteve përballë intresit të Amerikës për marredhënie të mira me Rusinë nuk vlejnjë shumë. Në rastin konkret marrin fuqi ato që quhen interesa jetike të Amerikës. As Shqipëria, as Sllovakia, as Bullgaria, as Lituania, nuk mund ta kërcënojnë Amerikën dhe popullin amerikan, ndërsa Rusia po. Potenciali i saj ushtarak vazhdon të jetë përsëri shumë i fuqishëm dhe rrezik potencial për Amerikën. Marredhëniet me Rusinë bëjnë pjesë në ato që quhen interesa jetike për Amerikën. Ndërsa marredhëniet me shtetet e tjera të përmendura më lart bëjnë pjesë në ato që quhen marredhënie demokratike. Por interesat jetike janë gjithmonë më të fuqishme se interesat demokratike. Dukuritë e mësipërme flasin për atë se dhe vetë Amerika akoma nuk është e përgatitur për të luajtur në mënyrë objektive rolin e NJESHIT në marredhëniet ndërkombëtare, në mënyrë vendosur dhe të pavarur. Pra, në mënyrë demokratike. Sa kohë që konfliktet dhe mosmarrëveshjet e ndryshme janë brenda sferës së pragmatizmit apo interesave jetike të Amerikës, aq kohë interesimi i saj është në shkallën më të lartë për zgjidhjen e konfliktit dhe sheshimin e mosmarrëveshjeve, aq kohë nuk zgjidhen mjetet që përdoren për zgjidhjen e tyre. Sa kohë që ky konflikt nuk i prek interesat jetike të saj, ajo përgjithësisht ose tregohet indiferente ose kalon në plan të dytë duke ua lënë vëndin organizmave ndërkombëtare. Shembulli i Ruandës gjatë vitit 1994-1995 e dëshmon më së miri një gjë të tillë. Askush prej shteteve të fuqishme të Evropës dhe botës nuk kishte interesa jetike në Ruandë, as Amerika. Është kjo arsyeja që zgjidhja e krizës në Ruandë iu la në dorë Organizatës së Kombeve të

Bashkuara dhe organizmave humanitare. Rezultati dihet nga shumica e opinionit: rreth një milion të vrarë dhe të masakruar. Nëqoftëse u bë një luftë e madhe gati 50-vjecare për të arritur në demokratizmin e të gjitha shteteve të Evropës, për demokratizmin e marredhënieve ndërkombëtare siç duket do të duhet një luftë akoma më e madhe. Për të arritur këtë duhet të demokratizohen vetë fuqitë e mëdha, veçanërisht vetë Amerika. Ky demokratizmi i saj në raportet e marredhënieve ndërkombëtare, është një kusht i domosdoshëm për të eliminuar totalitarizmin që vihet re në këto marredhënie. Pra, duhen eliminuar ato pengesa, që sot Amerikës i japin një kahje negative në rolin e NJESHIT të botës. A do të arrijë klasa politike amerikane ta realizojë një gjë të tillë? Nuk i dihet. Të dyja variantet janë në lojën aktuale të marredhënieve ndërkombëtare.

Trajtimi i mësipërm i problemit na lejon të arrijmë në një deduksion. Nga një anë kemi shpresat e popujve dhe vendeve të ndryshëm të cilët besojnë në krijimin e rendit të ri botëror dhe në vendosjen e marredhënieve demokratike në politikën ndërkombëtare. Njëkohësisht kemi interesat jetike dhe pragmatiste të Amerikës, kemi interesat e Kinës për t'u bërë superfuqi, kemi interesat e Gjermanisë për t'u bërë NJESHI i Evropës, kemi interesat e Francës për të vazhduar të lozë një rol të rëndësishëm në politikën ndërkombëtare, kemi interesat e Ruisë për t'u rikthyer e fuqishme në politikën botërore, kemi interesat e botës arabe që nëpërmjet integralizmit islamik të krijojnë një fuqi të re botërore me peshë në politikën ndërkombëtare. Nga ana tjetër kemi epokën e passocializmit, të mbushur me konflikte dhe mosmarrëveshje nga më të ndryshmet, kemi nacionalizmat e sotëm lindorë dhe perëndimorë, ashtu siç kemi dhe një propagandë marramendëse për marredhënie cilësisht të reja ndërkombëtare.

Brenda kësaj tabloje është shumë aktuale pyetja e mendimtarit amerikan Glen Tinder kur thotë: "A mund të thuhet se urrejtja dhe dhuna e shekullit të 20-të, janë thjesht shëmbëlltje të thelbit tonë të pashmangshëm? Po qe se kjo nuk është e vërtetë, atëherë si spiegohen fatkeqësitë që kanë pllakosur sot botën dhe si mund të krijojmë një

koncept më të thellë dhe të aplikueshëm? Çfarë aftësish kemi për ta realizuar këtë? A është e mjaftueshme forca njerëzore apo mos vallë?" (Glen Tinder, Mendimi politik, faqe 48). Është realiteti i së nesërme që do t'i japë përgjigje kësaj pyetjeje.

Demokratizmi i marredhënieve ndërkombëtare deri në atë masë sa e drejta të mos ketë nevojë për forcën për të qenë e tillë, por vetëm arsyen dhe logjikën, vetëm kjo do t'i japë përgjigje në kahje pozitive pohimit në formë pyetjeje të Tinderit. Ndërsa për realitetin e së sotmes, mjafton vetëm pohimi real se shumë popuj dhe vende të ndryshëm, të mesëm dhe të vegjël, vazhdojnë të jetojnë me frikë, për të sotmen dhe të nesërmen. Janë praktikatat dhe veprimet e sotme të të mëdhenjve të botës në marredhëniet ndërkombëtare që ua kanë futur këtë frikë. Por frika nuk është gjë tjetër veçse thelbi i totalitarizmit. Frika nuk ka nevojë për dhunë. Mjafton përfytyrimi i dhunës që ajo të ekzistojë.